



UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY

PUNIMI I MAGJISTRATURËS

TEMA: Ndikimi i terrorizmit në marrëdhëniet ndërkombëtare

KANDIDATI :

Berat Bajrami

TETOVË , 2019

MENTORI:

Prof.Dr.Bekim Nuhija

Përmbajtja:

Korniza metodologjike.....	6
Objekti i hulumtimit.....	6
Hipoteza dhe vërtetimi i tyre.....	7
Metodologjia e hulumtimit.....	7
Metodat dhe teknikat e kërkimit.....	8
Hyrja.....	9
KAPITULLI I – Teorria e terrorizmit.....	11
1. TRAJTIMI TEORIK I TERRORIZMIT	
1.1 Dallimi në mes terrorit dhe terrorizmit.....	12
1.2 Kuptimi i terrorit.....	13
1.3. Kuptimi i terrorizmit.....	14
1.4 Llojet e terrorizmit.....	15
1.5 Tipet dhe motivet e sulmeve terroriste.....	18
1.6 Kush janë terroristët në bazë të konventës ndërkombëtare.....	19
1.7 Kuptimi dhe zhvillimi i terrorizmit.....	19
1.7.1 Terrorizmi global.....	20
1.7.2 Rrjetet terroriste.....	21
1.7.3 Celulat terroriste.....	22
KAPITULLI II - NDIKIMI I RELIGJIONIT NË TERRORIZMIN NDËRKOMBËTAR	
2 Religjioni dhe terrorizmi	23

2.1 Feja.....	25
2.1.1 Shteti dhe feja.....	26
2.2 Feja te shqiptarët.....	27
2.3 Terrorizmi krishterë.....	28
2.3.1 Terrorizmi Hindus.....	28
2.3.2 Terrorizmi Judaik.....	29
2.3.3 Terrorizmi Islamik.....	30
2.4 Fundamentalizmi dhe radikalizmi islamik.....	31
2.4.1 Periudha e parë.....	32
2.4.2 Periudha e dytë.....	33
2.4.3 Periudha e tretë.....	33
2.4.4 Periudha e katërt.....	34
2.5 Rrënjët e radikalizmit islamik.....	37
2.5.1 Osama Bin Laden.....	39
2.6 Al-Qaeda.....	48
2.7 Kundër terrorizmi.....	49
2.8 Kidnapimet e aeroplanëve.....	50
KAPITULLI – III – Terrorizmi dhe sulmet e 11 shtatorit.....	52
3. Trendet e evoluimit të terrorizmit deri në sulmet e 11 shtatorit.....	53
3.1 Cka i parapriu sulmeve të 11 shtatorit.....	54
3.2 Sulmet terroriste të 11 shtatorit.....	56

3.3 Si u veprua pas sulmeve të 11 shtatorit.....	59
3.4 Masat dhe hetimet e ndërmarra pas sulmeve.....	60
3.4.1 Masat e ndërmarra.....	60
3.4.2 Hetimet e zhvilluara.....	61
3.4.3 Bashkpunimi ndërkombëtar kundër terrorizmit.....	62
3.4.4 Masat për forcimin e sigurisë globale.....	63
3.5 Shkaqet e sulmeve bashkëkohore terroriste.....	65
3.6 SHBA-të dhe lufta kundër terrorizmit.....	66
3.6.1 Organizatat terroriste.....	68
3.6.2 Terroristët më të kërkuar.....	68
3.6.3 Armatimi i terroristëve.....	70
3.7 Lufta kundër terrorizmit pas 11 shtatorit 2001.....	70
3.8 Aktet terroriste.....	73
3.8.1 Format e akteve terroriste.....	73
3.8.1a) Marrja dhe mbajtja e pengjëve.....	74
3.8.1b) Rrëmbimi i mjeteve të udhëtimit masiv.....	75
3.8.1c) Eksplozivet, shpërthimet dhe zjarret.....	76
3.8.1d) Sulmet vetëvrasëse.....	76
3.9 Shërbimet informative.....	77
3.9.1 CIA (central intelligence Agency).....	77
3.9.2 FBI (zyra federale e hetimeve).....	78

KAPITULLI – IV – Ndikimi i terrorizmit në politikat e shteteve të BE-së.....	79
4.1 Reflektimi i sulmeve të 11 shtatorit në politikat e BE-së.....	80
4.2 Strategjia e BE-së kundër terrorizmit.....	81
4.3 Bashkëpunimi SHBA-BE kundër terrorizmit.....	82
4.4 Interpoli dhe Europoli.....	83
4.4.1 Interpoli.....	83
4.4.2 Europoli.....	84
4.5 Shtetet dhe qeveritë që e përkrahin terrorizmin.....	84
4.6 Shtetet që janë cak i terrorizmit.....	85
4.7 Reflektimi i ngjarjeve të 11 shtatorit ne terrorizmin global.....	86
4.8 Qasjet e reja ndaj terrorizmit pas ngjarjeve të 11 shtatorit.....	89
5. Kapitulli i V – Metodologjia e hulumtimit të temës të magjistraturës.....	91
Përfundimi.....	111
Konkluzionet.....	112
Rekomandimet	113
Bibliografia.....	114

Korniza metodologjike

Arsyeshmëria e hulumtimit

Zakonisht hulumtimet e kësaj natyre bazohen në metodologjinë e kërkimeve kuantitative dhe kualitative që mund të bëhen nëpër institucione të njohura që merren me studimin dhe analizën e këtyre problemeve sic janë organizmat e shteteve më të fuqishme të botës që luftojnë terrorizmin. Mirëpo unë metodologjinë kërkimore e kam zhvilluar përmes metodave dhe objekteve kërkimore në të cilat kam pas qasje (sic janë sajtjet e FBI-se dhe CIA-s), pastaj kam shtjelluar detyrat e hulumtimit dhe në fund hipotezat e dhëna, si në vazhdim.

Objekti i hulumtimit

Hulumtimi merr përsiper të analizojë në mënyrë të thelluar çështje që kanë të bëjnë me terrorizmin. Me këtë punim shkencorë unë jam munduar të zbardh dhe të evidentoj çështjet kryesore të cilat janë shkaktare të veprave të ndryshme terroriste si dhe të shpjegojë qëllimin e këtyre akteve.

Teknika e studimit që kam përdorë në këtë temë janë konform studimeve që bëhen në vendet me përvojë të gjatë të studimit të këtyre fenomeneve, gjithënjë duke ju falenderuar informacioneve që kam marrë nga interneti dhe qasjes së lirë në sajtet që studiojnë këtë problematikë, poashtu edhe nga autorët e librave që i kam përmendur në bibliografi. Kontributi i vecantë i këtij punimi shkencorë qëndron në faktin se kam bërë:

- ✚ Pasqyrimin dhe analizimin e gjetjeve dhe të dhënave që kam marrë nga interneti dhe burimet nga literatura ;
- ✚ Në sugjerimet që kam dhënë dhe keshillat për bashkë – qytetarët tanë që të mos ndikohemi nga elementet destructive dhe terroriste të jashtëm;
- ✚ Rekomandimet që duhet të merren parasysh nëse duam të përmirësojmë sigurinë tonë shtetrorë, rajonale dhe globale nga terrorizmi.

Hipotezat dhe vërtetimi i tyre

Hipotezat që kam parashtruar në këtë punim dhe që synohet të vërtetohet përgjatë shtrirjes së këtij punimi kanë të bëjnë me njohjen e formave të ndryshme të terrorizmit dhe me ndikimin që kanë pas ngjarjet e “11 shtatorit“ në kryerjen e akteve të mëvonshme terroriste. Mirëpo zakonisht për të bërë një studim shkencor si ky që kemi para vetes, së pari duhet ti qasemi me seriozitet problemit, përmes hipotezave të cilat duhet të jenë të shtruarat me kujdes. Prandaj unë me këtë rast kam dhënë disa hipoteza të cilat konsistojnë në këto formulime:

- 1) **Hipoteza e parë:** Terrorizmi është problem rajonal;
- 2) **Hipoteza e dytë:** Terrorizmi është një fenomen i cili ka prapavije religjioze apo fetare;
- 3) **Hipoteza e tretë:** Terrorizmi nuk njihet kufij, nacional, religjioz, racor apo social;
- 4) **Hipoteza e katërt:** Terrorizmi është i lidhur ekskluzivisht me problemet ekonomike globale.

Gjatë studimit të problemit, unë erdha në përfundim dhe e vërtetova se **hipoteza e tretë, ishte ajo që plotesonte kërkesat e studimit tim**, i cili kishte të bënte kryesisht me terrorizmin që nuk njihet kufij, as nacional, as religjioz, as racor e as social. Pikerisht gjatë studimit të kateve të kryera terroriste, kuptova se ato në veprimet e tyre nuk kishin përzgjedhur asnjë prej këtyre caqeve me ndonjë prioritet, por kishin të vetmin qëllim, shkatërim, dëme dhe dhimbje sa më të mëdha për kundërshtarin.

Metodologjia e hulumtimit

Zakonisht hulumtimet e kësaj natyre bazohen në metodologjinë e kërkimeve kuantitative dhe kualitative që mund të behen nëpër institucione të njohura që merren me studimin dhe analizën e këtyre problemeve, sic janë organizmat e shteteve më të fuqishme të botës që luftojnë terrorizmin. Mirëpo unë metodologjinë kërkimore e kam zhvilluar përmes metodave dhe objekteve kërkimore në të cilat kam qasje (sic janë sajtet e FBI-së dhe CIA-s), pastaj kam shtelluar detyrat e hulumtimit dhe në fund hipotezat e dhëna si në vazhdim.

Metodat dhe teknikat e kërkimit

Metodat që mund ti përdorim për hulumtimin e dukurive të ndryshme janë metoda e analizës teorike, metoda përshkruese, statetike, metoda e shpjegimit etj. Në lidhje me temën e terrorizmit është dashur të mbildhen informacione nga terreni, mirëpo një gjë e tillë është e pamundur të bëhet në kushtet tona të studimit. Prandaj metodat kryesore që kam përdore janë, metoda e kondensimit të informacioneve të grumbulluara më parë si dhe në përmbledhjen e tyre para se ti vëndosja si material të tezës. Me kondensim të informacioneve unë kuptoj përmbledhjen e fakteve më të besueshme dhe me të pranueshme shkencore për studimin në fjalë.

Metoda që me shumë e kam përdorë në këtë studim është: analiza teorike e literaturës shkencore të kësaj fushe të cilën e kam përshkruar në bibliografinë e përdorur në fund të punimit, si dhe sajtet e përdorura në internet. Për realizimin e këtij hulumtimi jemi mbështetur më së shumti në studime, kërkime e punime të metodistëve të njohur ndërkombëtar në fushën e studimit të problematikës së terrorizmit ndërkombëtar.

Në kuadër të studimit të tezës së diplomes jam përpjekur të bëjë një analizë me kujdes dhe në hollësi burimet e informacionit sidomos ato burime për të cilat unë mendoja se janë me të besueshme. Ndërkaq cdo informacion të marrë e studioja në hollësi dhe e krahasoja me ndonjë informacion tjetër, për të ardhur me pastaj në një përfundim me shkecorë të problemit.

Metodë tjetër e kërkimit është nënvizimi i materialeve të cilat mendoja se janë relevante për ti paraqitur si material studimi. Ndërkohë gjatë leximit të artikujve të ndryshme kam bërë përmbledhjen e tyre, si dhe shpesh i kam rilexuar materialin, duke rishikuar se cili prej tyre është me adekuate për tu prezantuar si material studimor. Sic do të shohim kur të bëj prezantimin e temës, unë gjatë punimit të saj kam bërë disa tabela, grafiike, ndarje e nëndarje të parantezave, ashtu që tema është zbërthyer mjaft mirë dhe ka një strukturë që mendoj se i plotëson standardet.

Nocionet e përshkruara në këtë temë janë dhënë me një gjuhë të pastër dhe me kuptim të qartë. Për këtë do të marr një shembull, se si e kam bërë këtë, duke cituar personazhet e studimit dhe subjektet me deklaratat e tyre. Nocionet i kam paraqitur me kujdes, duke mos bërë përmirësime të thënieve apo të citimeve, por duke deklaruar autorin dhe autorsinë në fusnota.

HYRJE

Fjala terrorizëm është fjalë latine që dmth; “të bën të dridhesh“. Mirëpo termi terrorizëm është edhe më kompleks dhe merr kuptime të ndryshme, në varësi prej pikepamje të dikujt. Në fjalorin digjital të Enciklopedisë Botërore, shkruhet se: “*Terrorizmi është përdorimi i paligjshëm i frikësimit, kërcënimit dhe i dhunës, nga një njëri apo grup njerëzish të organizuar, për të realizuar qëllimet e tyre ideologjike apo politike*“.¹

Duhet të kemi parasysh se fjala terrorizëm nuk është identike me fjalën (frige, panik). Terrori është dhunë sistematike shtetërore ndaj qytetarëve të saj apo ndaj një pjesë të qytetarëve të saj, përderisa terrorizmi është zbatim i dhunës nga elemente jashtë-shtetërore me qëllim ndërrimin apo marrjen e pushtetit.² Prandaj mendoj se këtë temë duhet ta trajtojmë më shkencëtarisht për të provuar që ta ndajmë terrorizmin dhe topologjinë e akteve terroriste nga format tjera të dhunës njerzore.

Dostojevski në librin e tij “ Djalli “ , duke potretizuar klimën politike në Rusi në fund të shekullit 19-të, pati shkruar se “Terrori është mallkimi i njeriut“. Që nga ajo kohe e deri në dekadën e fundit të shekullit të kaluar, komunizmi përbënte terror për shumë grupe njerëzish të cilet u ekzekutuan pa mëshirë me urdhër të Stalinit.

Ndërkohë që Ariel Marari një shkenctarë i njohur i politikës e ka studiuar në hollësi këtë problem dhe ka dalë me pikëpamjet e tij se terrorizmi dallon tri elemente të përbashkëta nga përkufizimi i mësipërm, e ato janë:

1. Përdorimi i dhunës ;
2. Objektivat politike ; dhe
3. Tendenca për të mbjellë frikë në një popullatë të caktuar.

¹ Kolë Krasniqi, Terrorizmi Ndërkombëtar, Prishtinë, fq 22

² Ibidem, fq 23

Nëse fillojmë nga gjurmët më të hershme të terrorizmit, atë e gjejmë pikërisht në vendin ku edhe sot bëhen aktet më të rënda terroriste. Fjala është për një fis të vjetër Hebre, të quajtur Zealots (fanatiket), të cilët atë kohë ishin rebeluar kundër Perandorisë Romake.³

Më vonë, po aty një grup muslimanësh, terrorizuan kryqtarët evropian. Pikërisht kjo zanafillë e hershme e terrorizmit na pengon të analizojmë, terrorizmin vetëm si fenomen të kohës së fundit. Pra terrorizmi nuk është fenomen vetëm i kohës modern, por ai ka një histori të gjatë. Terrorizmi nuk ka lindur me datën 11 shtator, por ai ka ekzistuar si pjesë e shoqërisë njerzore me mijëra vjet. Sipas studimit të Chaliand dhe Blin⁴ terrorizmi ka tendencë që të shfaqet vale-vale. Valet terroriste janë shfaqur në periudha të ndryshme kohore, sic janë : fillimi i luftës së parë botërore e cila u bë për shkak të vrasjes së Franc Ferdinandit nga një organizatë nacionaliste serbe, pastaj vrasjet pa gjykim të miliona njerëzve nga Stalini në Rusi, vrasjet e mëvonshme nga organizata Baske dhe Ira-se etj. Terrorizmi u aplikua edhe nga pushtetarë të ndryshëm anembanë botës të cilët vranë me miliona njerëz, për shkak të ambicieve të tyre të sëmura. Pra, kuptuam se terrorizmi ka ekzistuar shumë kohë më parë se të paraqitet terrorizmi me i vrazhdë i kohës, apo radikalizmi islam që veprimet e veta terroriste po i realizon përmes organizatës (sot) më të dhunshme në botë, të quajtur Al-Qaeda.

Sipas shumë shkenctarëve dhe politikologeve, terrorizmi ka evoluar në përdorimin e mjeteve, më të sofistikuar për realizimin e akteve të tyre terroriste, duke filluar nga telefonat, armët e sofistikuar, e deri te dinamiti, I cili ka ndryshuar teknologjinë terroriste, duke I bërë veprimet edhe më shkateruese. Ndërsa sot, teknologjija modern në zotërim, armët nukleare, interneti dhe komunikimet satelitore etj, e kanë bërë terrorizmin edhe më kërcënues se më parë.

Duke thënë se veprimet më të organizuara antiterrorist janë bërë nga ish administratë e presidentit Bush, e cila o zotua se do të “zhdukte“ terrorizmin, por një gjë e tillë nuk ndodhi, perkunder veprimeve te gjera ushtarake qe u ndermoren pas 11 shtatorit. Kjo bëri që shumë organizata terroriste të orkestrojnë edhe më tepër përdorimin e dhunës, prandaj me këtë duam të thjeksojmë se jo gjithmonë qeveritë dinë të zgjidhin problemet me të cilat përballet njerëzimi. Sidoqoftë kjo është një temë e gjërë studimi dhe këtë fenomen ne do ta shqyrtojmë hollësisht në vazhdim.

³ The History of Terrorism, Gérard Chaliand and Arnaud Blin, London fq 15

⁴ “ The History of Terrorism “ from Antiquity to Al Qaeda – Gerard Chaliand and Arnaud Blin , London, fq 19

KAPITULLI – I

TEORIA E TERRORIZMIT

1. TRAJTIMI TEORIK I TERRORIZMIT

1.1 Dallimi në mes të Terrorit dhe Terrorizmit

Terrori dhe terrorizmi kanë dallim në kuptimin e tyre. David Forte thekson se dallimi në mes të terrorit dhe terrorizmit është se ndërkohë që terrori mund të jetë një e keqe neutral, sic është dhuna e shkaktuar nga grabitës të rastit, kriminel rrugë apo përdhunues apo ushtarë të papërgjegjshëm, terrorizmi në anën tjetër është ka një dimension më të gjërë politik, duke qenë përdorim i dhunës sistematike i bërë nga grupe të organizuara kundër objektivave civile, për të arritur një qëllim të caktuar politik.

Fjala terror është përdorë për herë të parë gjatë Revolucionit Borgjez Francez, dhe ka domethënie “frigë, panik“, ndërsa që nga ajo kohë fjala terror shërben si sinonim i gjendjes shpirtërore apo frikës individuale nga presioni politik apo nga ndonjë kërcënim përballë një rreziku të caktuar. Ndërsa me fjalën terrorizëm, kuptojmë veprat e ndryshme penale që drejtohen kundër shtetit, që kryhen nga individë apo grupe të ndryshme personash, në shtetin e vet apo në shtetin e huaj me qëllim të arritjes së një objekti politik apo ideologjik.⁵

Në vazhdim do të analizojmë në mënyrë shkencore, dallimin që ekziston në mes të këtyre dy termeve të ngjajshme gjuhësore. Së pari duhet të theksojmë se terrori dhe terrorizmi nuk kanë kuptim të njëjtë apo nuk janë identike, por ekziston një dallim mes tyre. Dallimi ka të bëjë me faktin se terrori është dhunë shtetërore e cila zbatohet me qëllim të ruajtjes ose të rivendosjes së

⁵ Kolë Krasniqi, “Terrorizmi Ndërkombëtar “Botimi i dytë, Prishtinë 2010, faqe 22

pushtetit shtetëror, ndërsa terrorizmi është zbatimi i dhunës politike nga aktorët e ndryshëm jashtë shtetëror me qëllim të ndërrimit ose marrjes së pushtetit.⁶ Ata që bëjnë terror apo terrorizëm, i fillojnë operacionet e tyre luftarake, jo me qëllim të luftimit të armikut të caktuar, por kundër qytetarëve të pafajshëm dhe të pambrojtur të tyre apo vendeve tjera ku kryejnë akte terroriste. Prandaj themi se: *terrori praktikon zhdukjen sistematike të qytetarëve dhe civilëve të pafajshëm, ndërsa terrorizmi praktikon rrëzimin e qeverisë dhe pushteteve me metoda terroriste për arritjen e qëllimeve politike.*

Pra, dallimi sic duket është mjaft i dukshëm, sepse terrori perpiqet të mbajë një regjim totalitar përmes këtyre metodave, gjërsa terrorizmi bën të kundërtën, dëshiron të rrëzojë qeveri dhe pushtet. Mirëpo rruga e dhunës është e njëjtë edhe pse terrori diktohet nga lart, pra aparati shtetëror, ndërsa terrorizmi nga poshtë apo nga grupe njerëzish apo terroristësh që janë jashtë institucioneve shtetërore të një shteti të caktuar.⁷

1.2 Kuptimi i terrorit

Në hyrje të këtij punimi thamë se fjala terror dmth, “frikë e madhë“ dhe është fjalë latine përkatësisht frenge. Terrori është një veprim i dhunshëm i presionit politik mbi njerëz dhe organizata që përfaqësojnë elemente apo grupe revolucionare mbrenda shtetit ose pozitën e cila do ta ndryshojë sistemin politik të shtetit. Ky term u përdorë për herë të parë nga Jakobinet, një klub i famshëm politik francez i cili zhvilloj Revolucionin Borgjez Francez. Si raste të terrorit modern kemi: terrorin e kuc dhe terrorin e bardhë. i pari paraqet kampanjën e arrestimeve dhe ekzekutimeve të bolshevikëve në Rusi, ndërsa terrori i bardhë konsiderohen levizjet e bëra kundër revolucionit francez.

Vlen të përmendet se terrori i kuc apo vrasjet massive në kohën e periudhës komuniste ishin aq të tmershme, sa që thuhet se numri i të vrarëve dhe të ekzekutuarve në kohën e komunizimit ka arritur shifrën e 100 milion viktimave. Këto ndryshime janë quajtur vrasje massive të njerëzve që mendonin ndryshe apo kërkonin ndryshimin e sistemit. Vrasjet më të mëdha i ka bërë Stalini në Rusi, Mao Zedong në Kinë, Khmer Rouge në Kamboxhia etj.

⁶ Kolë Krasniqi, “Terrorizmi Ndërkombëtar “Botimi i dytë, Prishtinë 2010, fq 23

⁷ Ibidem, faqe 24

Këto janë termet në vazhdim që janë përdorë për të përshkruar vrasjet në kohën e komunizmit: ‘Gjenocid’, ‘Krim kundër njerzimit’, ‘Terror’, ‘Vrasje massive’, ‘Holokaust komunist, etj. Terrori i bardhë ka të bëjë edhe me dhunën e trupave të bardha finlandeze gjatë luftës civile në fazën e krijimit të Shtetit të Pavarur Finlandez në vitin 1918.

1.3 Kuptimi i terrorizmit

Është e qartë se terrorizmit është një përdorim sistematik i dhunës apo i terrorit si mjet shtërngues për arritjen e qëllimeve politike të disa njerëzve apo grupeve të njerëzve mbrenda një shteti apo të ardhur nga jashtë shtetit me qëllim destabilizimin dhe rrëzimin e tij. Në aspektin global, terrorizmi nuk ka ndonjë detyrim ligjor, si dhe nuk respekton asnjë rregullorë apo ligj ndërkombtarë. Studimet kanë treguar se ekziston rreth 100 përkufizime për terrorizmin. Në disa raste i njëjti grup terrorist , për dikë përshkruhet si “ luftetarët e lirisë “ e për dikë tjetër si grupe terroriste. Kështu e quanin sërëbët UCK-në, ndërsa për në djemte e saj ishin luftetarë të lirisë.

Në rastin negativ të tij, terrorizmi nuk zgjedh mjete dhe metoda , ai mund të godas kudo, në qytete të medha apo të vogla si dhe ne vendbanime te cfarëdoshme. Terrorizmi i sotëm ka kaluar kufijte e përzgjedhjes së caqeve goditëse , prandaj cak i sulmeve zakonisht janë vendet dhe lokacionet që dëmtohen më së shumti. Terrorizmi njeh vetëm gjuhën e përdorimit të forcës dhe dhunës, so goditës apo edhe si i goditur, Sipas FBI-së, Byrosë Federale Amerikane për Investigime, terrorozmi mund të kategorizohet si njeri nga këto dy tipe të tij:

- ✚ Terrorizmi vendas apo i mbrendshëm, i cili ka për qëllim kryerjen e veprimtarisë terroriste Brenda territorit të shtetit të vetë, pa drejtimin e të huajve dhe;
- ✚ Terrorizmi ndërkombtarë, i cili është aktivitet terrorist i drejtuar nga të huaj apo nga bazat e tyre që sponsorizohen nga vende dhe organizata jashtë shtetit.

Përderisa grupet e brendshme terrorsite është më lehtë të identifkohen, nëse një shtet ka problem me grupet terrorsite ndërkombtare , atëherë kjo është një fatkeqësi e madhe për atë shtet apo popull. Trendet globale po tregojnë se sot është bërë mjaft vështirë të identifkohen grupet e huaja terroriste që po infiltrohen ne shtete të ndryshme me qëllim dhe ideologjike si dhe infiltrimet grupeve me orientime të forta fetare.⁸

⁸ Kriminalistika, Vesel Latifi “ Metodika e zbulimit të terrorizmit “ fq 309

Terroristët shpesh bëhen vetë “ kritikuesit “ kinse për pafuqine e tyre karshi akteve terroriste dhe si thotë populli “ edhe të vretë edhe të qanë “, duke krijuar kështu frikë dhe panic në mesin e popullatës civile dhe ngritur pakënaqësinë ndaj qeverisë që synojnë ti rrëzojnë me dhunë. Për arritjen e këtyre qëllimve terroristët përdorin armatime nga më të ndryshmet, duke filluar nga: *armët e thejshta, bomba, eksplozivat, flakëhedhësit, armët kimike, armët biologjike dhe reagjentëve bërthamore*, etj . , te cilët shkaktojnë viktima masive ndër popullatën civile.


Terrorizmi përfshinë edhe këto shkatërime në masë:

Bombat konvencionale,	Sulmet me armë të të gjitha llojeve,
Agjentët biologjike ,	Agroterrorizmi (helmimi I ushqimeve) ,
Agjentët kimike ,	Lirim të materialeve shkatëruese ,
Bombat nukleare ,	Shkatërrim të infrastrukturës ,
Argjentët radiologjike ,	Sulm të infrastrukturës ,
Sulmet arsonike (vënia e zjarrit)	Përhapje të viruseve me shtrirje të shpejtë etj.


Meqenëse terrorizmi është i paparashikueshëm, atëherë themi se ai nuk dihet se kur dhe ku godet. Prandaj sistemet shtetërore për sigurinë kombtare dhe shërbimet e fshehta, duhet të jenë në gjendje të parashikojnë se cilat vende janë më të rrezikuara dhe të shtojnë masat e sigurisë, duke paralajmëruar popullatën me anë disa kodeve “ me ngjyra “ për nivelin e rrezikut terrorist në vend. Këto ngjyra të spektrit të dritës , në shenjat e paralajmërimit fillojnë nga ngjyra e gjelbërt, e cila paraqet rrezik të vogël e deri të ngjyra e kuqe e cila paraqet rrezik të lartë nga sulmet terroriste dhe është paralajmërim për të gjitha institucionet kompetente dhe popullatën civile që të jenë sycelë ndaj cdo veprimi të dyshimtë në zonën e tyre.


1.4 Llojet e terrorizmit


Terrorizmi si dukuri negative e shoqërisë njerëzore shfaqet në forma të ndryshme, prandaj ne po japim disa lloje të paraqitjes së terrorizmit. Llojet kryesore të terrorizmit janë këto:

 **Terrorizmi shtetëror:** Terrorizmi shtetëror është përdorimi sistematik i dhunës nga një qeveri shtetërore, me qëllim që të mbajë nën kontroll popullatën e vetë, apo popullatën të cilën ai e konsideron si pakicë në territorin e vetë. Për të mos e ngatërruar këtë lloj terrorizmi me “terrorizmin e sponsorizuar nga shteti i përkrah grupet e ndryshme terroriste, këtu kemi të bëjmë me terrorizmin shtetëror për të mbaj nën kontroll popullin me dhunë.”⁹






Ky lloj terrorizmi fillon me Revolucionin Francez të vitit 1793, ku shteti kreu me mijëra ekzekutime në popullatën e vetë. Jemi dëshmitar të terrorizmit shtetëror që po kryhet ndaj popullatës së vetë në disa shtete arabe, si: Libia, Siria, Iraku, Sudani, etj. Raste ekstreme të këtij terrorizmi janë vrasjet e Kurdëve nga Sadam Huseini në Irak dhe lufta e cila akoma po vazhdon në Siri. Edhe Serbia kreu mbi shqiptaret e Kosovës “terrorizëm klasik shtetëror” duke vrarë dhe ekzekutuar me mijëra njerëz, me të vetmin qëllim për ti shtypur dhe mbajtur në robëri apo nën sundimin popullin e Kosovës.

 **Terrorizmi anarkist;** Ky lloj terrorizmi ka të bëjë me rebelimin njerëzve apo grupeve të njerëzve ndaj shtetit, institucioneve dhe autoriteteve të tij. Kete lloj terrorizmi poashtu mund ta hasim si “të freskët në luftën që po bëjnë formacione të ndryshme luftarake në Siri dhe disa vende arabe.

 **Terrorizmi i sponsorizuar nga shteti;** Disa shtete dhe qeveri shtetesh në botë janë përkrahës dhe sponsorizues të terrorizmit, sic janë: Irani, Kuba, Iraku, Koreja e Veriut, Sudani, Siria, deri vonë edhe Libia, Serbia dhe disa shtete afrikane. Për shembull organizata *Abu Nidal* dhe *Hezbollah*, janë shembuj të organizatave të sponsorizuara nga shtete përkatëse.

 **Terrorizmi i djathtë;** Këta terroriste janë më pak të dhunshëm dhe sulmojnë emigrantët e refugjatët të cilët kërkojnë azil në shtetet e tyre, shembull janë organizatat naziste në Gjermani, Austri, Poloni dhe vende tjera të Evropës.

⁹ Cituar sipas L. J. Macfarlane, *Political Disobedience*, London 1971, fq 12

-  **Terrorizmi majtist;** Punon në rrëzimin e qeverisë demokratike duke u përpjekur të vendosë regjime majtiste, socialiste ose komuniste në vendet e tyre, si prsh., grupi *Baader-Meinhof*, *Ushtria e kuce Japoneze*, *Brigadat e kuce*, etj.
-  **Terrorizmi religjioz;** Këto sulme terroriste e përdorin religjionin si arsyetim dhe strategji për veprimet e tyre terroriste. Motivi kryesor i këtyre terroristëve është imponimi ndaj tjerëve i parimeve bazë të fesë së tyre si dhe përhapja e fesë me dhunë. Shembuj të terrorizmit fetarë janë disa organizata famëkeqe si: *Hezbollah*, *Al-Qaeda*, *Hamas*, *Aum Shinrikyo* etj.
-  **Terrorizmi nacionalist;** Këta terroristë janë të sukseshëm në marrjen e simpatisë së popullit, sepse luftojnë për arritjen e lirisë dhe panvarsisë së popullit të tyre, por e përdorin dhunën dhe terrorin për të arritë qëllimin e tyre. Për shembull të tillë janë : “ *Ushtria Republikane Irlandeze* , “ *Atdheu i Baskeve* “ *Partia Puntore e Kurdistanit* “ etj. Lufta të cilën e bëri Ushtria Clirimtare e Kosovës, mund të konsiderohet në disa fragmente të saj si “ luftë nacionaliste “, për shkak të disa aksioneve ndaj formacioneve të armikut, Unë mendoj se lufta jonë clirimtare ishte më shumë separatiste.
-  **Narkoterrorizmi;** Ky lloj terrorizmi është paraqitur si rezultat i konsumimit të drogës, tregtimit të saj dhe përfitimit material të bandave nga shitja e saj. Disa organizata të tilla terroriste janë: Forcat e Armatosura Revolucionare të Kolumbisë, Tigrat Tamil, Forcat e Emirateve të Bashkuara, Forcat e Bashkuara Kolumbiane, Kartelët Meksikane të drogës dhe aramata e organizatave tjera që përdorin drogën për të siguruar financat e tyre.¹⁰
-  **Kiber-terrorizmi ;** Ky është terrorizmi kibernetike, që përdor kompjuterët dhe rrjetin kompjuterik për arritjen e qëllimeve terroriste. Këta njëjës përdorin njohuritë e tyre për të crregulluar kontrollin kompjuterik të jetës së përditshme, si trenat, tramvajt, avionet, sistemet bankare, komunikimet ushtarake, rrymën elektrike, mediat, etj. Pergjigja ndaj kësaj lufte është përdorimi individual i kompjuterëve dhe i mbrojtjes nga viruset e ndryshme. Terroristët e 11 shtatorit, ishin të përgatitur shkëlqyeshëm edhe në fushën e kibernetikës, sepse aksioni edhe pse i rëndë i kishte personazhet e trajnuara mirë në të gjitha fushat.

¹⁰ Politische Kriminalitat, Mayers Enzyklopadisches Lexikon, Band 14, Wien 1987, fq 24

Terrorizmi nacionalist të cilin e përmendëm më sipër, i cili nga disa shoqëri ndryshe quhet edhe *terrorizëm irredentist*, nënkupton përpjekjet e dhunshme të disa minoriteteve të cilat paraprakisht janë të diskriminuara që të arrijnë liritë e tyre të nevojshme, autonomitë e tyre adekuate politike, ndarjen territorial apo edhe pavarësitë e ndryshme nacionale të këtyre kombeve apo kombësive.

Zakonisht grupe të ndryshme nacionale – çlirimtare të cilat për shkak të pamundësive për të arrit qëllimet e tyre përmes operacioneve të armatosura luftarake në shkallë të gjërë, ata zgjedhin veprimet e terroristëve si metoda më të lehta për të ndikuar në ndryshimin e politikës ndaj tyre. Ka edhe lëvizje terroriste që bëhen në shtetet demokratike, por ato cilësohen si përpjekje të motivuara politikisht nga disa individë apo grupe të caktuara terroriste në drejtim të ndryshimit të sistemit aktual politik dhe instalimit të një sistemi tjetër të tipit komunist, hegjemonist, fundamentalist, ushtarak, apo regjimeve tjera diktatoriale. Këto forma të ndryshimit të pushteteve janë të pranishme edhe sot, të manifestuara në forma më të çuditshme të tyre, sidomos në disa vende arabe, posacërisht në Egjipt.

1.5 Tipet dhe motivet e sulmeve terroriste

Tani e kemi të qartë se terrorizmi është përdorim i paligjshëm i forcës dhe i dhunës ndaj personave ose vendeve të ndryshme me qëllim frikësimi për arritjen e objektivave të caktuara politike dhe sociale¹¹. Tipet kryesore të sulmeve terroriste konsiderojmë se janë:

- Eksplozimet dhe zjarret ;
- Pengjet dhe vrasjet e tyre ;
- Lirimi i agjentëve kimike dhe biologjike ;
- Armët nukleare dhe materialet bërthamore ;
- Terrorizmi ekonomik ;
- Terrorizmi kibernetike .

Motivi kryesorë që kanë organizatat terroriste për të kryer veprimet e tyre janë:

- Motivi religjioz ;
- Motive politik ;
- Motive racial ; dhe

¹¹ Sistemi i sigurisë – Nazmi Maliqi, Shkup 2010, fq 55

- Interest special.

Motivimi më i rrezikshëm konsiderohet se është religjioz, pasi që është motivim i bazuar në bindjen fanatike të terroristëve, në sakrificimin e plotë të tyre për kauzen fetare dhe bregat shumë të pakta për opinionin publik në lidhje me vlerësimin e akteve të tilla. Por edhe motivimi politik nuk është më pak i rrezikshëm, ndërsa motivimi racial ka të bëjë me mos tolerancë raciale e cila shpesh ka rezultuar me akte terroriste. Motivimi për shkak të interesave special ka të bëjë me dhunën në rritje për shkak të luftës kundër abortit, mbrojtjes së ambientit dhe mbrojtjen e shtazëve. Shënjestrat potenciale të grupeve terroriste janë në të shumtën e rasteve: ndërtesat, ngjarjet e ndryshme dhe organizatat, pastaj linjat e gazit, ujit, rrymës, telefonit, mandej sistemi i transportit ajror, hekurudhor, automobilistik, portal etj. Prandaj themi se dëmtimi sa më i madh i këtyre objekteve dhe fataliteti i civilëve që shfrytëzojnë këto, është motivë kryesorë i terroristëve dhe i tutorëve të tyre.

1.6 Kush janë terroristët sipas konventave ndërkombtarë?

Natyrisht se përpjekjet e popujve për liri dhe pavarësi, janë më të shumta në vende të ndryshme të botës dhe këto nuk mund të bëhen pa përdorimin e armëve, prandaj është e nevojshme të sqarojmë se cka është terroriste e cka jo, sipas konventave ndërkombtare. Sipas konventes numër IV të Hagës se vitit 1907 dhe konventës tjetër të ratifikuar në Gjenevë në vitin 1949, aktet e dhunës terroriste, mund të njihen si veprime luftarake të cilat nga komuniteti ndërkombëtarë konsiderohen si legjitime, nëse kryhen nga:

- Grupe personash të komanduar nga një udhëheqës i vetëm, i cili është përgjegjës edhe për veprimet e personave tjerë që gjenden nën komandën e tij.
- Nga grupe personash që bartin një simbol të ngjitur në uniformat e tyre (shenjë apo shkrim), që dallohet nga largësia dhe që simbolizon populllore me aspiratë të caktuara për liri apo pavarësi.
- Grup i personave që mbajnë hapur armët e tyre për një qëllim të caktuar.
- Grup i personave, të cilët gjatë aksioneve të tyre luftarake ju përmbahen rreptësisht rregullave ndërkombtare të luftës, robërve të luftës dhe sjelljes ndaj civilëve, etj.

Në shumë vende të botës terrorizmi është përdorë dhe po përdoret ende si alternative luftës së armatosur. Shtete të ndryshme nga pamundësia e tyre që të zhvillojnë luftë klasike

kundër një shteti tjetër rival, ose me qëllim të mënjanimin të rreziqeve të padëshiruara që do të sillte konfrontimi me këtë shtet (shtetet e vogla dhe të dobëta, me ato të mëdha dhe të fuqishme), e praktikojnë terrorizmin si formë të luftës special, apo si alternative të luftës standarde.

1.7 Kuptimi dhe zhvillimi i terrorizmit

Në kuptimin e tanishëm, termi terrorizëm është përdorë në Rusi në gjysmën e dyte të shekullit XIX-të. Që nga ajo kohë e deri më sot, cdo lloj dhunë e drejtuar kundër shtetit është cilësuar si veprim terrorist. Këtë nocion jemi mësuar ta dëgjojmë para, por edhe gjatë luftës së fundit në Kosovë, kur qeveria e Sërbisë i quante me këtë emër shqiptarët e Kosovës.

Terrorizmi është një veprim i papritur dhe i dhunshëm i njeriut ndaj objektivave të ndryshme. Grupe të njerëzve kryesisht me bindje të caktuara terroriste, mbledhen së bashku dhe trajnohet me qëllim të vrasjes së njerëzve të pafajshëm në mbarë botën. Arsyeja e veprimeve dhe e sulmeve të tilla është bindja e tyre urdhrave të atyre që i paguajnë terroristët, për të vepruar sipas urdhërave të tyre dhe për të realizuar qëllimet nga më të ndryshmet. Zakonisht për realizimin e këtyre veprimeve të dhunëshme, terroristët së pari pajisen me armatime të ndryshme të cilat i blejnë vetë ose i marrin nga qeveritë e tyre që i mbështesin ata për të bërë akte terroriste. Ndodhë që këta njerëz furnizohen me armatime që ka edhe armiku i tyre.

Gjatë shekujve të kaluar, terroristët dhe grupe terroriste në mbarë botën kanë kryer sulme dhe akte të shumta terroriste. Sulmet e tyre zakonisht janë rrëmbimet dhe vrasjet e pengjëve, rrëmbimet e anijeve apo aeroplanëve si mburoja në aktet terroriste, pastaj përdorimin e llojeve të makinave bombe dhe mjeteve e metodave tjera terroriste.

Gjatë gjithë kohës, qëllimi i vetëm i terroristëve është arsyeja e sa më shumë njerëzve në të njëjtën kohë edhe realizimi i qëllimeve tjera që zakonisht janë politike, ekonomike, religjioze, etj. Pikërisht në ditën e sotme po përballemi me një lloj terrorizmi i cili nuk është aplikuar me parë, së paku jo në këtë formë që po paraqitet sot. Tani jemi duke parë se si grupe të ndryshme terroriste që besojnë fuqishëm në një fe që quhet Islam, po bëjnë një luftë që klasifikohet si terroriste dhe ka për objektive gjithë ata që nuk besojnë në Islam. Dihet se islami është një fe e cila ka zanafillën e vetë në lindjen e mesme, por në thelb është fe e cila në asnjë mënyrë nuk predikon dhunën si mjet për zgjidhjen e problemeve. Por kjo fe është e përhapur në tërë botën dhe si e tillë njerëzit që predikojnë këtë fe, jetojnë në vende të ndryshme të botës. Shumica e

njerëzve që besojnë në islam, shumica gati absolutë e tyre, nuk janë njerëz të dhunshëm dhe nuk i përkrahin në asnjë mënyrë aktet terroriste që kryejnë disa grupe të ashtuquajtur “fundamentalist islamik “. Grupe të tilla e përdorin Kuranin (libërin e shenjtë të muslimanëve), dhe interpretojnë mësimet e tij për qëllime të veta të dhunshme. Mirëpo në e dimë se në Kuran nuk shkruan asgjë që e arsyeton një dhunë të tillë dhe akte të tilla terroriste, po e kundërta Islami në tërësi është një fe paqësore e cila nuk sulmon dhe nuk vret të tjerët.

Terroristët e sotëm islamik, kanë krijuar grupime të tilla në shumë vende të botës, por më shumë në vetë vendet arabe. Më së shumti ata përpiqen të kryejnë akte terroriste në vendet ku nuk ka qeveri të formuar islamike. Mirëpo ka disa vende që jo vetëm lejojnë grupe terroriste në vendet e tyre, por ato edhe e ndihmojnë strehimin e tyre dhe përkrahin veprimet e tyre në vendet tjera, duke i ndihmuar edhe financiarisht. Prandaj qeveritë e vendeve demokratike, duke parë rrezikun që kërcënohet nga grupe të tilla dhe duke parë se terrorizmi modern po bëhet gjithënjë e më shkatërues, jo vetëm që i ka shpallë luftë , por po bëjnë përpjekje politike për eliminimin e këtij rreziku në planin global. Për këtë shumë shtete tani më i kanë edhe listat e grupeve terroriste dhe sidomos të personave më të rrezikshëm të kërkuar nga shërbimet secrete të vendeve të botës. Lista më e përpiluar mendohet të jetë nga FBI dhe shërbimi amerikan i inteligjencës CIA, e cila ka shpërndarë në vendet jo-terroriste një liste, e cila do të ndihmojë këto vende në gjetjen dhe arrestimin e këtyre njerëzve të rrezikshëm.

1.7.1 Terrorizmi global

Terrorizmi ndërkombëtar vështrohet në kontestin e veprimeve apo pasojave të tij që mund të lënë këto sulme jo vetëm mbrenda një shteti por edhe jashtë kufijve të tij dhe më gjërë në nivel global. Prandaj është e nevojshme që të përcaktohen kriteret në bazë të së cilave një ngjarje apo një seri ngjarjesh cilësohen si terrorizëm ndërkombëtar.¹² Edhe në këtë rast duhet ti referohemi konventave ndërkombëtare me të cilat luftohet terrorizmi, të cilat janë ratifikuara në Organizatën e Kombeve të Bashkuara (OKB).

Në konventën e OKB-së të vitit 1997, terrorizmi ndërkombëtar emërohet si: “*vendi i veprimit, përkatësia shtetërore e autorit ose e viktimës, gjegjësisht e ndryshme shtetërore të autorit, vendit të ngjarjes dhe vendit të pasojave të saj, si dhe vendi i qëndrimit të autorëve para,*

¹² Haki Demolli “ Terrorizmi ” Prishtinë , fq 50

gjatë apo pas kryerjes së veprës terroriste, kanë elemente ndërkombetare. “ .¹³ Normalisht se egziston një dallim në mes të nocionit terrorizem global, terrorizëm transnacional dhe terrorizëm ndërkombtarë.¹⁴

Sipas të drejtës ndërkombëtare, nëse një ngjarje terroriste zhvillohet në mes të dy shteteve apo preken vetem dy shtete kjo ngjarje trajtohet si ndërkombëtare, mirëpo nëse kjo ngjarje përfshin më shumë shtete, ajo do të quhet transnacionale, përderisa ngjarja terroriste mund të cilësohet si e përmasave globale, nëse përfshin shumë shtete në të gjitha rajonet e botës apo përfshin disa popuj të botës, atëherë ky është terrorizëm global.¹⁵

Terroristët kanë një strategji të koordinuar mirë në kryerjen e akteve të tyre terroriste. Sulme terroriste janë kryer gati në të gjitha vendet e botës . Shpesh grupet terroriste kryejnë aktet e tyre në të njëjtën kohë në shumë vende , pra veprojnë në disa objektiva njëkohësisht . Pikërisht sulmet e “ 11 shtatorit “ të vitit 2001, ishin sulme terroriste të koordinuara në një mënyrë të re dhe të papritur deri në atë kohë. Konkretisht synimi i një grupi të rrezikshëm , por të njohur nga CIA, si quajtur Al-Qaeda, ishte të godiste fuqishëm Shtetet e Bashkuara dhe aleatët e saj , duke sulmuar në shumë vende njëkohësisht.

1.7.2 Rrjetet terroriste

Gjatë kryerjes së aksioneve terroriste, grupet e mëdha terroriste nga vende të ndryshme të botës, dërgojnë grupe më të vogla njerëzish, duke i shpërndarë ata dhe duke ju dhënë detyra për kryerjen e akteve të tyre mizore. Këto grupe të vogla terroriste, të quajtura “ celulatat e organizatës terroriste “, dergojnë në vende të ndryshme me detyra dhe qëllime të caktuara. Këto grupe janë të lidhura fort mes veti, duke formuar kështu një rrjet të gjërë terroristësh, të cilët janë në gjendje të godasin në cdo vend të botës. Grupe të tilla gjejnë përkrahës edhe mbrenda vendeve të cilat janë në targetin e tyre goditës, kryesisht njerëz me ideologji të njëjtë fetare ose politike dhe të atillë që janë në gjendje të sakrifikojnë për kauzat e kreut terrorist.

Rrjetet e vogla terroriste, kanë një udhëheqës më të lartë të rrjetit terrorist, i cili i merr vendimet për të gjitha aktivitetet e grupeve të vogla terroriste. Zakonisht pas mbarimit të akteve terroriste, udhëheqësi i grupit terrorist apo ndonjë zyrtar për informim, del me një deklaratë për

¹³ Raport i Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB), fq 74

¹⁴ Kolë Krasniqi, Terrorizmi Ndërkombëtar (botimi i dytë) fq 55

¹⁵ Ibidem, fq.57

opinionin public (për mediat e shkruara dhe elektronike), me të cilën deklaroi se qëndron pas akteve të tilla terroriste dhe se përgjegjësia është e tyre, duke treguar edhe qëllimin e realizimit të aktit të tillë.

1.7.3 Celulat terroriste

Terroristet nuk janë individë që punojnë vetëm, por ata bashkëpunojnë në grupe të vogla që i përkasin një grupi apo rrjeti të madh terrorist. Ndodhë që edhe organizatat e ndryshme terroriste nëpër vende të ndryshme të bashkëpunojnë mes veti, për të realizuar me “sukses“ aktet e tyre të shëmtuara. Ky bashkëpunim shpesh përfshin edhe fushën e ndihmës në armatim dhe ndihmën financiare. Terroristet janë njerëz të trajnuar mirë dhe këto stërvitje zakonisht bëhen në kampet që ngrihen nga këto organizata enkas për këto qëllime. Kampe të tilla ka në tërë globin dhe këto organizata bashkëpunojnë mirë edhe në planin e trimit dhe shkëmbimit të ekperiencës. Këto organizata bëjnë edhe rekrutimin e të rinjëve dhe vullnetarëve të tjerë, sidomos ekspertëve të fushave të ndryshme, përdoruesve të armëve, të eksploziveve, detonatorëve të ndryshëm dhe teknologjisë në përgjithësi. Angazhimi i këtyre njerëzve bëhet me vullnetin e tyre, por shpesh kjo bëhet edhe me dhunë dhe nën kërcënimin e antarëve të familjes së tyre. Sot shumë shtete që janë nën kërcënim të përhershëm terrorist, janë duke punuar së bashku për të zbuluar kudo në planet, ekzistencën e celulave kryesore të organizatave të tilla terroriste. Vlen të përmendim me këtë rast se terroristët që rrëmbyen avionet me 11 shtatorë dhe i përdoren ata për të vrarë gjithë ata njerëz, jetonin së bashku në një celulë të organizuar dhe të fshehur mirë të Al-Qaeda në Florida të SHBA-së. Normalisht që kjo celulë i merrte këshillat nga baza e rrjetit të saj kryesore në lindjen e mesme, por celula e saj funksiononte në Florida, e shpërndarë në grupet e vogla të saj në tërë shtetet e bashkuara.¹⁶

¹⁶ Brogan Patric, Die Unruhe der Welt, Darmstadt 1990, fq 633

KAPITULLI - II

NDIKIMI I RELIGJIONIT NE TERRORIZMIN NDËRKOMËBTAR

1.8 Religjioni dhe Terrorizmi

Ka mendime se shkaktari kryesorë i terrorizmit është religjioni, apo feja. Ndërkohë që ka edhe të atillë që mednojnë se terrorizmi nuk ka (apo nuk njih) religjion. Mirëpo pas akteve terroriste që ndodhën më 11 shtator në Nju Jork, disa figura publike në botën perendimore, si dhe disa institucione të njohura, dolën me mendimin e tyre se terrorizmi ka një religjion dhe ai është Islami. Prandaj bie pyetja se sa ka ndikim feja apo religjioni në organizimin dhe orkestrimin e akteve terroriste?

Duke ditur se deri më sot janë kryer shumë akte terroriste në mbarë botën dhe kjo është kryer nga grupe me religjion të kundërt me viktimën, atëherë kjo le të kuptojmë se në shumë raste, *“Feja është shkaktari kryesorë i kryerjes së akteve terroriste“*. Shumë terroristë sot përdorin shkrimet e shenjta të marrë nga librat e shenjtë, për të justifikuar veprimet e tyre terroriste. Në të shumtën e rasteve, terroristët përdorin fenë dhe librat e broshurat fetare për të fshehur pikëpamjet e tyre politike në rastin e arsytimit të akteve të kryera dhe për të siguruar mbështetjen popullore për këto veprime.

Në kohërat më të vjetra, feja është përdorë si arsyetim për të terrorizuar dhe vvarë njerëzit që e kanë kundërshtuar atë, si në botën e krishterë, ashtu edhe në atë muslimane. Edhe sot terroristët gjatë kryerjes së akteve të tyre, përdorin metodat e vjetra të ekzekutimeve të huazuara nga feja, sepse ata konsiderojnë se këto metoda janë më efikase . Konkretisht vrasja e viktimave apo e robërve nuk është e shkruar as në Kuran e as në Bibël, por ekstremistë të ndryshëm dhe

terroriste i përdorin këto libra për të vrarë njerëz.¹⁷ Është vërtetuar se mendja e terroristëve është e ndikuar nga feja. Ka dy grupe të terroristëve:

- Terroristë secular ; dhe
- Terroristë fetarë.

Këto dy grupe kanë mendime të ndryshme në lidhje me përdorimin e dhunës gjatë akteve terroriste. Terroristët laik, japin paralajmërime dhe përpiqen ti shmangen viktimave apo vdekjeve , ndërsa terroristët fetarë , nuk mërzhiten edhe nëse bëjnë vrasje massive se dhe krime kundër kujdo qoftë, vetëm që dëmi të jetë sa më masiv. Terroristët përdorin arsyetimin se: “*Armiku i mikut tim është edhe armiku im* “. Ky lloj arsyetimi nxit edhe më tej veprimet terroriste duke përfshirë edhe vendet që nuk përkrahin terrorizmin. Shembull për këtë kemi shtetin Izrailit dhe popullatën e tij e cila është e rrezikuar kudo në botë nga elemente ekstremiste muslimane, vetëm për shkak të kontestit të pazgjedhur që kanë ata me popullin Palestinez.

A ka ndonjë mënyrë se si mund e ndalohe apo së paku të reduktohet terrorizmi? Përgjigja në këtë pyetje është se bota sot po bën shumë përpjekje për të eliminuar këtë të keqe, por nuk po i zbaton metodat e duhura. Terrorizmi nuk mund të ndalet duke shtuar dhunën mbi elementet terroriste. Praktika ka dëshmuar se kur udhëheqësit e grupeve terroriste, apo komandantët e tyre janë burgosur ose janë vrarë, një ndjenjë zemërimi , mllëfi dhe urrejtje është krijuar në grupet e tilla, por edhe në vetë popullatën që i përkasin grupet terroriste. Shkak për këtë edhe vrasja e civilëve dhe njerëzve të pafajshëm , gjatë aksioneve për eliminimin e grupeve terroriste në territorin e tyre . Pastaj vrasja e qytetarëve të vendeve që janë të përfshira në terrorizëm apo në akte gjenocidi, nuk e zgjidhe problemin, por e bën situatën edhe më të rëndë.¹⁸

Vetëm një thënie ndihmon në këtë mes: “Ata që jetojnë me shpatë, do të vdesin nga shpata “. Prandaj sot mënyra më e mirë për të luftuar terrorizmin që vjen nga vendet e varfra, është ndihma ndaj tyre dhe përmirësimi i kushteve të jetës për popullatën e vendeve që janë burim permanent i terrorizmit. Shumë terrorist mendojnë se Shtetet e Bashkuara dhe Evropa, janë të forta dhe superior në ekonomi dhe duan të sundojnë botën . Prandaj duke i ndihmuar këto vende që të përmirësojnë cilësinë e jetës, ju japin sinjal atyre se ky arsyetim i tyre nuk qëndron,

¹⁷ Hezbollah: The changing Face of Terrorism, 7 October 2005, Leban fq 103

¹⁸ Ibidem, fq 104


por ata duhet të ndërrojnë mentalitetin, të përmirësojnë kulturën, të punojnë më shumë dhe të ecin në hap me kohën.

1.8.1 Feja

Feja është marrëdhina që vendosë mes një personi dhe një apo më shumë hyjnish ose fuqish mbinatyrore dhe mes njerëzve që ushtrojnë të njëjtin fe. Ndryshe feja konsiderohet si një besim i fuqishëm në një fuqi ose disa fuqi të mbinatyreshme që mbikeqyrin fatin njerëzorë. Thuhet se fillet e besimit janë të hershme. Ashtu si bashkësitë njerëzore edhe besimet kanë ndryshuar përmes një evolimi prej mijëra vitesh. Ato kanë kaluar në shkallë të ndryshme zhvillimi e ndryshimesh, si edhe religjionet e popujve të lashtë, politeiste. Përndryshe në botë ekzistojnë disa besime fetare.

Lista e feve kryesore botërore është kjo: Budizmi, Islamizmi, Krishterizmi, Hinduizmi dhe Jadaizmi. Statistika e numrit të besimtarëve nga rreth 7 miliardë njerëz sa vlersohet se ekzistojnë në Tokë, bëhet siaps kësaj ndarje fetare: (tabela + grafiku)

Grafika, Nr. 1



33 %	20 %	13 %	6 %	13 %	14 %
Krishtere	Musliman	Hindus	Budist	Tjere	Te pa fe

1.8.2 Shteti dhe Feja

Shteti dhe feja historikisht ndër shekuj ka pasur një lidhje jo fort të mirë. Për një kohë shteti dhe feja kanë qenë aleatë të ngushtë, një kohë tjetër kundërshtarë të ashpër, ndërsa në etapën e fundit deri diku të pavarur mes veti.

Sot në shumë vende të botës, ekziston një lidhje në mes të shtetit dhe fesë, por gjithnjë duke ruajtur pavarësinë e veprimit të njëra tjetrës. Në disa shtete ekziston një ndarje e prerë në mes të shtetit dhe fesë, sic janë shtetet e Evropës, Amerikës dhe disa vendeve tjera demokratike. Por në disa vende arabe, ekziston një lidhje e ngushtë në mes të shtetit dhe fesë dhe kjo lidhje në disa shtete është shumë ekstreme, bile edhe shteti funksionon sipas rregullave të fesë. Në disa shtete ekziston liria e vetëm një feje dhe jo e të gjitha feve tjera që mund të aplikoj dikush kur jeton aty ose e viziton atë vend. Pra liria e ndonjë feje tjetër për minoritetet në këto vende është problematike. Në shumë shtete, shërbyesit fetare janë të liruar nga detyrimi për të dëshmuar para autoriteteve publike ose gjyqësore në lidhje me çfarëdo fakti në lidhje me zbatimin e fesë. Prandaj kjo është një dëshmi se feja dhe shteti nuk kanë lidhje që mund të pengojë veprimtarinë e njëra tjetrës.

1.8.3 Feja te Shqiptarët

Populli ynë nuk është fetar dhe nuk njih fenë sa duhet , prandaj edhe është tolerant. Të huajt janë munduar që nëpërmjet fesë të na përcajnë, por nuk ia kanë arritur, sepse për ne shqiptarët feja është vetëm besim shpirtëror dhe se në prioritet kemi kombin e jo fenë. Duhet të përmendim se feja te shqiptarët është përhapur që nga kohërat e hershme. Që nga fillimi kur në trojet e Ballkanit feja katolike e zëvendësoi besimin e mëparshëm e deri në kohërat e sotme , në këto territore ka pas disa drejtime të feve të ndryshme . Unë jam i mendimit se shqiptarët i kanë përfaqësuar fetë e tyre shpeshherë jo me vullnetin e vetë, por sidoqoftë kjo është një kaptinë e mbaruar.¹⁹Sot në shqiptarët në trojet tona etnike jetojmë në harmoni duke kultivuar tri besimet fetare: Islamin, Krishterizmin katolik dhe Ortodoks.

¹⁹ Haki Demolli "Terrorizmi" Prishtinë, fq 72

1.8.2 Terrorizmi krishterë

Terrorizmi i krishterë përfshinë aktet e ndryshme terroriste që kryejnë individe apo grupe njerëzish, duke përdorur qëllimet apo motivet e krishterë për realizimin e veprimeve të tyre terroriste. Terroristët e krishterë mbështetën në interpretimin e Biblës dhe citatet e Dhiatës së vjetër dhe të Dhiatës së re .

Në disa vende të Evropës dhe të Amerikës janë shfaqur disa grupe terroriste që janë të motivuara me ideologji të tilla të krishterë. Një sulm i tillë terrorist është bërë në vitin 1995 në Oklahoma, nga grupi “Patriotët e Krishterë“ të cilët vranë 168 njerëz. Organizata të tilla terroriste të krishtera janë: “ National Liberation Front of Tripuna “ në Indi, “ Iron Guard “ në Rumani, “Lords Resistance Army“ në Ugrande, “Army of God“ dhe “ Christian Patriot Movenment “ në SHBA, etj. Edhe rasti i Anders Breivik në Norvegji i cili akt terrorist u krye me 22 gusht 2011, i përshkruhet Breivikut si veprim terrorist i krishterë , për shkak se targeti i tij ishin pikërisht të huajt musliman që po popullonin Norvegjinë. Në këtë sulm u vranë 91 njerëz të pafajshëm . Berivik pranoj fajësinë dhe qëllimin që kishte pasur për të neutralizuar këto grupe njerëzish. Sidoqoftë ky ishte një akt i izoluar dhe nuk i përkrah nga askush në botën perendimore.²⁰

Terroristët e krishterë zakonisht i sulmojnë grupet e njerëzve që masovikisht popullojnë vendbanimet e tyre. Sulmojnë edhe personat të cilet i kundërshtojnë hapur parimet krishterë, pastaj sulmojnë mjekët dhe klinikat e abortit, pastaj prostitutat dhe personat homoseksual të cilët dalin dhe protestojnë për të drejtat e tyre që të martohen me të njëjtën gjini, etj.

1.8.3 Terrorizmi Hindus

Terrorizmi hindus thuhet se ka lindur si kundërpërgjigje e organizatave të shumta terroriste islamike që veprojnë në Indi, për shkak të një territori të diskutueshëm të Kashmirit të banuar me popullatë muslimane. Dihet se Indianët dhe Pakistanezet janë një popull, por me dy fe të ndryshme. Ndoshta ky është vendi më fatkeq në botë, ku feja me ndihmën e kolonizatorëve britanike arriti të thyeje unitetin e popullit të bashkuar Indian për një shtet të përbashkët.

²⁰ Hezbollah: The Changing Face of Terrorism Paperback – October 7, 2005

Thuhet se Mahatma Gandhi (që udhëhoqi një politike të famshme paqësore për clirimin e Indisë nga pushteti britanik), kishte qenë shumë i dëshpëruar dhe kishte vdekur me zemërim të madhë për shkak të ndarjes së Indisë në dy shtete. Por që nga ndarja e Pakistanit, dhuna në mes të këtyre dy shteteve nuk ka reshtur së pushuari për shkak të veprimeve terroriste sidomos nga ana Pakistaneze. Prandaj terrorizmi hindus nuk është shumë i shprehur në krahasim me terrorizmat tjerë global, për shkak të natyrës më të butë të Indianëve si popull.

1.8.4 Terrorizmi Judaik

Judaizmi është feja e popullit hebraik me rreth 15 milion besimtarë. Kjo është feja e parë monoteiste në planetin tonë dhe njëra prej feve më të vjetra. Vlerat kulturore të trashëguara nga populli hebrenj janë vlera të cilat kanë vënë themelin e dy feve tjera si: Krishterizmi dhe Islami. Mirëpo ndër shekuj lindën problem, sidomos në mes të fesë Judaike dhe asaj Islamike, për shkaqe terroriste të cilat u trashëguan deri më sot. Këto mosmarrveshje sollën deri te luftrat e shumta në mes arabëve dhe hebrenjëve në Palestinë.

Terrorizmi fetar cifut është një terrorizëm i kryer nga ekstremistët jevrej dhe i motivuar më shumë në aspektin fetar se sa etnik apo kombëtar. Edhe doktorinat e hershme judaike lidhen me dhunën dhe eliminimin e së keqes dhe këto janë të shkruara në traditën hebraike, sikundër që ka edhe shumë doktorina paqësore. Përkundër vuajtjeve që kishin pësuar hebrenjtë gjatë luftës e dytë botërore, vetë formimi i shtetit Izrailit në Palestinë, bëri që edhe vetë jevrenjtë të kryejnë akte terroriste ndaj popullatës Palestineze, duke i dëbuar nga shtëpitë e tyre, duke i vrarë dhe duke i përsekutuar. Në kuadër të veprimeve terroristë të kryera nga Jevrenjtë, duhet përmendur dhunën e politikës sioniste e cila i referohet akteve terroriste të kryera nga sionistët . Sioniste janë disa grupe paramilitare si grupi: Irgun, Lehi, Hanganah, Palmah, Gush Emunim, Brit Hakanaim, Keshtët etj.

1.8.5 Terrorizmi Islamik

Njëra prej formave të terrorizmit religjioz, është edhe terrorizmi islamik i cili ka për qëllim arritjen e qëllimeve politike në emër të fesë. Sot terrorizmi islamik ka një shtrirje globale, duke përfshirë lindjen e mesme, Evropë, Afrikën, Amerikën jugore dhe veriore, Azinë jugore dhe juglindore, Kaukazin, Rusinë dhe vendet e Paqësorit, etj.

Sipas rezultateve të shërbimeve të ndryshme antiterrorist , organizatat terroriste islamike janë në toplistën e krimeve me të mëdha terroriste në mbarë globin. Vlen të përmendim se taktikat e tyre të veprimit përfshijnë: sulmet vetëvrasëse, bombardimet, rrëmbimet, kidnapimet dhe format tjera të aksioneve terroriste. Studiues të ndryshme kanë debatuar në lidhje me faktin se, *“a është islami fe e dhunës , e paqes , apo kombinim i të dyjave “* . Sipas mësimave të Kuranit , del se Islami është fe e paqes dhe jo e dhunës, sikurse që në Kuran shkruan se: “nuk ka asnjë detyrim në fe“ . Mirëpo askush sdi sit e arsyejoje veprimet e disa organizatave terroriste, të cilat duan që “përmes shpatës“ të zgjerojnë ndikimin e tyre në disa vende muslimane dhe më tej në suaza global.

Në fakt një studiues perendimore i quajtur Robert Pape, ka argumentuar mendimin e tij se aksionet të cilësuar si “terroriste dhe vetëvrasëse“ që po i bëjnë disa eksponente islamik, nuk janë të shtyrë feja, por nga një objektiv I qartë strategjik, për ti detyruar shtetet e demokracive perendimore që të tërheqin trupat ushtarake nga territoret që ata i shohin si atdheu i tyre.²¹

Ish analisti i CIA-së Michael Scheuer, thotë se: *“Sulmet terroriste në vecanti ato të Al-Qaeda në Amerikë, nuk janë të motivuara aspak nga urrejtja fetare ndaj Amerikës, por nga besimi se politika e jashtme amerikane, ka shtypur, vrarë, dhe përsekutuar popullin muslimanë në Lindjen e mesme“*. Përvec kësaj, shkak tjetër sipas tij është edhe përkrahja e amerikanëve për Izraelin, mbështetja e shteteve që po luftojnë grupet islamike, si India, Filipinet dhe përkrahja e pavarësisë së Timorit Lindor, që dikur i përkiste Indonezisë, një vend me shumicë muslimane në Azinë Juglindore. Sipas mendimit tim dhe praktikës sonë rajonale, Shtetet e Bashkuara nuk futën në konflikte për qëllime religjioze por këtë e bëjnë për të mbrojtur të drejtat dhe mos lejuar eskalim të dhunës në rajonet përkatëse. Shembull për këtë është edhe lufta rajonale në ish-Jugosllavi, ku SHBA-ja, doli në mbrojtje të popullatës muslimane në Bosnjë, e cila po

²¹ Islam and Terrorisem (Revised and Updated Edition) M.Gabriel, fq 68

terrorizohej nga Sërbia. Të njëjtën gjë SHBA-ja e bëri edhe me ndërhyrjen në Kosovë e cila edhe pse me një popullatë absolute muslimane ishte objekt i intervenimit amerikan në çlirimin e saj nga Sërbia. Këtë që bëri Amerika për popullatën e Kosovës, është një dhuratë që ne se morëm nga asnjë shtet islamik. Po të mos ishte Amerika dhe Britania e Madhe dhe disa shtete që u kyçen më pas në aksion, sot kushedi se çfarë fati do të kishte vendi yne. Pra kjo dëshmon se amerikanët kanë disa objektiva dhe qëllime përtej interesave fetare dhe religjioze.

1.9 Fundamentalizmi dhe radikalizmi islam

Fundamentalizmi islamik është i bazuar në ideologjinë islamik dhe është një kthim në bazat e islamit, në Kuran dhe Synet. Sipas një studiuesi të pavarur Benjamin Schett, fundamentalizmi islamik është përhapur në rajon me ndihmën e fuqive perendimore për të realizuar disa agjenda politike në rajonin arabik. Figurat më të rëndësishme fundamentalist islamike janë: Sajid Qutb, Ayatollah Khomeini, Abul Mawdudi, Israr Ahmadi dhe me vonë Osama Bin Ladeni.

Sipas studiuesit më të madh amerikan të islamit, John Esposito ²²një nga tiparet më kryesore të fundamentalizmit islam, është besimi në rihapjen e portave të “Ixhtihadit“. Forma më ekstreme e fundamentalizmit islamik është radikalizmi islamik. Ky ka shërbyer si ideologji e një vargu organizatash politike ekstremiste dhe lëvizjes terroriste, të cilat kanë ardhur duke e zgjeruar dhe intensifikuar veprimtarinë e tyre, vecanarisht në këto 15-20 vitet e fundit. Fundamentalizmi islamik dhe terrorizmi i kryer nga organizatat radikale islamike janë zhvilluar në disa periudha dhe kanë vecoritë e veta.

1.9.2 Periudha e parë

Terrorizmi islamik i ka rrënjët e tij qysh në shekullin e XIX-të, kur levizja Qahhabi, një levizje arabe fundamentalist, e cila ishte formuar në shekullin e XVIII-te, filloi të mbledhte rreth saj një numer të konsiderueshëm pasuesish dhe gradualisht frymëzoi levizje të tjera fundamentalist në shekullin e XX-të. Organizatat ekstremiste më të njohura dhe më active në periudhën e parë të zhvillimit të islamizmit radikal kanë qenë Ikhwan al Myslimin në Egjipt dhe Fadayian e Islam e krijuar në Iran. Këto dy organizata kishin disa tipare të tyre të përbashkëta:

²² Qendra Izraelite për Studime Antiterroriste, <http://www.ict.org.il>

1. *Ato u krijuan në vendet muslimane më të populluara të botës arabe ;*
2. *Objektivi i tyre i përbashkët ishte ribashkimi i botës muslimane nën një qeveri dhe nën një flamur të përbashkët ;*
3. *Arritjen e këtij synimi ato e shihnin tek rrëzimi, qoftë edhe me dhunë, i qeverive “ të korruptuara “, të cilat padrejtësisht ishin vënë në krye të vendeve muslimane.*

\\ Pavarësisht këtyre tipareve themelore të përbashkëta, këto dy organizata kishin edhe dallime midis tyre. Ikwani ishte një organizatë sunite, ndërsa Fadayain një organizatë Shiite. Sidoqoftë, krahasuar me qëllimet e tyre themelore ky është një dallim jo esencial. Dallimi më esencial mes tyre kishte të bënte me metodat e tyre organizative.

Organizata Ikhwan kishte krijuar në Egjipt një rrjet të gjërë që shtrihej në fusha të tilla si arsimit, propaganda dhe investimet financiare. Ajo që e forcoi shumë këtë organizatë ishte infiltrimi në të gjitha shtresat e popullsisë dhe marrja e mbështetjes popullore.

Organizata Fadayain, aktivitetet e saj i kishte shumë të kufizuara, kryesisht në fushën e propagandës dhe të veprimtarisë terroriste. Fillimisht aktet terroriste të kësaj organizate drejtoheshin teresisht kundër muslimanëve. Në periudhën e hershme të zhvillimit të tij terrorizmi islamik nuk kishte për synim të përhapte terror por kryesisht të eliminonte kundërshtarët e vet politikë.

Më 1948, terroristët islamik vranë kryeministrin e Egjiptit, Nuqras Pasha dhe më 1981 presidentin egjiptian Anwar el Sadat. Në vitet 1949, 1951 dhe 1965, tre kryeministra të Iranit: Hossein Hajir, Haj Ali Razmara dhe Hassan Mansour, pësuan të njëjtën fat. Kishte pas edhe shumë atentate të dështuara, njëri prej të cilave është atentati kundër presidentit Naser të Egjiptit. Pra në periudhën e parë, veprimet terroriste nuk drejtoheshin kundër popullsisë civile. Viktimat e akteve terroriste, ishin figura politike të hierarkisë së lartë shtetërore.

1.9.3 Periudha e dytë

Periudha e dytë e terrorizmit islamik filloi me revolucionin islamik në Irak, në vitin 1979 dhe kjo ishte hera e parë në shekullin e XX-të që islamikët radikal morrën pushtetin në një vend musliman. Historiani i njohur amerikan Bernard Lewis thekson se revolucioni islamik, i frymëzuar nga idetë dhe udhëheqja karizmatike e Ajatollah Khomeinit dhe i drejtuar nga mullahët e Iranit, ka qenë përpjekja me efektive e lëvizjes radikale islamike. Si e tillë, kjo ngjarje

ka pasur një ndikim shumë të madh në botën arabe. Ajo u pasua nga një varg zhvillimesh të rëndësishme, si lufta e përgjakshme midis Iranit dhe Irakut sovjetik i Afganistanit dhe pushtimi i Kuvajtit nga Iraku. Objektivi i Khomeinit ishte ta shtrinte revolucionin e tij në vende të tjera arabe me popullsi Shiite, por edhe radhët e popullsive sunit. Për këtë arsye ai nuk e propagandoi karakterin shiit të revolucionit të tij, por doli me emër të projektit islamik.

Në periudhën e dytë, terrorizmi islamik i ndrishi natyrën dhe metodat e tij, duke filluar përdorimin e metodave të dhunshme në realizimin e objektivave të tyre. Menjëherë filluan të ndjehen pasojat tragjike jo vetëm në rajonin e Lindjes së Mesme, por edhe në shakllë botërore, si në Liban, në Paris, Nju Jork, Uashington, Bali, Moskë, Riad, Madrid, Londër, Kairo etj. Një tjetër tipar i ri i terrorizmit islamik në këtë periudhë u bë pengmarrja e shtetasve të huaj. Kjo filloi në Iran, kur një grup studentësh të “ Vijeve të Imamit “ pushtuan Ambasadën e Shteteve të Bashkuara në Teheran dhe mbajtën peng një numër të madh diplomatësh amerikanë për 444 ditë. Kjo ngjarje shërbeu më vonë si model për zënien e pengjeve në Liban dhe vende tjera.

1.9.4 Periudha e tretë

Periudha e tretë e terrorizmit islamik karakterizohet nga terrorizmi vetëvrasës. Deri nga mesi i viteve 1980 praktika e terroristëve islamik ishte e tillë, ndërsa kryenin aktet terroriste, ata nuk rrezikonin jetën e tyre. Sulmi i parë terrorist vetëvrasës ka ndodhur në Bejrut, më 1983, nga organizata terroriste Hezbollah e Libanit, kur kamionë të ngarkuar me lëndë eksplozive gotidën kazermat e ushtarëve amerikanë, anglez dhe francez duke vrarë qindra ushtarë dhe oficerë perendimor.

Të frymëzuar dhe të inkurajuar nga pushtimi islamik i Iranit, në shumë vende arabe, u krijuan një numër grupesh dhe organizatash terroriste islamike të sektit shiit dhe sunit. Sidoqoftë, gjatë viteve 1980 terrorizmi islamik në radhët e shiitëve radikalë ishte më dominues. Shkaku kryesorë i aktiviteteve terroriste të grupit islamik shiit për atë kohë ishin dy ngjarje të mëdha: lufta midis Irakut dhe Iranit (1980 – 1988), dhe pushtimi i Libanit të Jugut nga Izraeli në vitet (1982-2000).

Terrorizmi islamik në rradhët e sektit sunit ka qenë aktiv dhe i egër, vecanarisht në Egjipt, ku deri më sot kanë predominuar dy levizje, apo dy organizata terroriste: “Shoqata Islamike “(*Gama’at al – Islamiyya*) dhe “Lufta e Shenjtë Islamike“(Al – Jihad al Islam). Të dyja

këto organizata, të dala nga levizja Ikhwan al Muslimin, e cila kishte udhëheqës Sheikun Umar Abd al-Rahman-in, i cili ishte organizatori i aktit terrorist në *World Trade Center në Nju York* në vitin 1993. Sidoqoftë, në fazën e tretë të zhvillimit të radikalizmit islamik, filluan të përhapen metodat terroriste vrasëse dhe vetëvrasëse.

1.9.4 Periudha e katërt

Kjo periudhë fillon me sulmet terroriste të 11 shtatorit 2001 në Manhattan dhe në Pentagon, të cilat deshmojnë për tiparet dhe dimensionet e reja që ka marrë terrorizmi islamik në ditët tona. Përvec fitores së revolucionit islamik në Iran më 1979, sociologu Mozafari, përmend tre faktorë të tjerë të cilët ndihmojnë në shpjegimin e kësaj dukurie:

- ❖ Fitorja e muxhahedinëve në Afganistan, kundër pushtimit nga Bashkimi Sovjetik;
- ❖ Vendosja e trupave ushtarake Amerikane në Arabinë Saudite më 199; dhe
- ❖ Marveshja e Oslos, e cila u zyrtarizua në Uashington më 13 shtator 1993, në mes të presidentit Izraelit, Jitcak Rabin, Bill Klinton (si ndërmjetësues) dhe presidenti Palestinez Jaser Arafat.²³

Në vitin 1979, Afganistani u pushtua nga Bashkimi Sovjetik, Ky pushtim ndeshi menjëherë në një rezistencë të vendosur të:

- ❖ Vetë popullsisë muslimane afgane ;
- ❖ Të muslimanëve arabe të ardhur nga vende të ndryshme ; dhe
- ❖ Të shërbimeve të fshehta Amerikane, Pakistaneze dhe të Arabisë Saudite.²⁴

Gjatë luftës që zgjati dhjetë vjet, populli afgan do të vuaj shumë, duke humbur më shumë se 1 milion njerëz, shumica prej tyre “ *muxhahedin* “ (*luftetarë*), ndërsa rusët në radhët e tyre 13.310 të vrarë dhe mbi 35.000 të plagosur. Për shkak të kthimit masiv nga Afganistani të muxhahedinëve që kishin luftuar atje, në disa vende arabe, si në Egjipt dhe në Algjeri, u vu ree një ringjallërim dhe shtim i veprimtarisë terroriste. Nga shkurti i vitit 1993 deri në nëntorë 1997,

²³ Martin A. Miller – The Foundations of Modern Terrorism, 2013 fq 112

²⁴ Ibidem , fq 115

pra para formimit të lëvizjes Al-Qaeda, organizata Egjiptiane Al-Gamaa kreu 13 akte terroriste, kryesisht në Egjipt, në Islamabad, në Addis Ababa, etj.

Në prill të vitit 1990, në Egjipt u mbyll gjyqi për një çështje antiterrorist më të mëdha dhe më spektakulare në dekadën e fundit të shekullit të XX-të. Mbi 100 islamike fundamentalist, 63 prej të cileve u dënuan në mungesë, për aktivitetet e tyre terroriste. Një ndër ata që u dënuan me vdekje nga gjykata egjiptiane ishte edhe *Ayman Al-Zawahir*, i cili u bashkua me Osama Bin Laden në organizatën Al-Qaeda në Afganistan. Nuk ishte rastësisht që Osama Bin Laden, doli në krye të lëvizjes islamike kundër pranisë amerikane në tokat arabe si shtetas saudit, sepse ky ishte bërë i njohur si udhëheqës i muxhahedinëve që luftuan dhe mposhtën Bashkimin Sovjetik, në atë kohë superfuqi botërore.

Në vitin 1998, terrorizmi islamik, figurë qendrore udhëheqëse kishte bërë Osama Bin Ladenin, i cili bashkoi rreth vetes disa organizata dhe grupe më të njohura terroriste në drejtimin e tij. Organizata e re që formoj u quajt “Fronti Islamik Botëror“, e cila më vonë u njoh me emrin Al-Qaeda. Ajo bashkoi në një të vetme tri organizata terroriste më të njohura në atë kohë:

- 🚩 Al – Jihad dhe Ahmad Taha në Egjipt ;
- 🚩 Gama’a Al – Ulama në Pakistan ; dhe
- 🚩 Lëvizjet Saeikh Mir Hamza dhe Fazul Rahman’s Jihad në Bangladesh.

Deklarata e përbashkët (Fatwa) e këtyre organizatave terroriste, më 23 shkurt 1998 me të cilën ato zyrtarizuan unifikimin e tyre me Al – Qaeda, i referohet gjerësisht Kuranin dhe thekson se muslimanët, kudo që ndodhen në territoret e tyre janë bërë viktima të një agresioni të egër nga Amerika dhe Izraeli. Ky dokument përmend shprehimisht pushtimin nga Shtetet e Bashkuara të territoreve muslimane në vendet më të shenjta të gadishullit arabik, cka u bë një justifikim për xhihadin kundër Amerikës, ku shkruan:

Teksti i kësaj deklarate thotë më tej, citojmë:

“ Në përmbushje të urdhërit të Zotit, ne u bëjmë thitje të gjithë muslimanëve se: vrasja e Amerikanëve dhe e aleatëve të tyre, civile dhe ushtarake është detyre e cdo muslimani që mund ta bëjë këtë në cdo vend që kjo është e mundur të realizohet “ .

Me krijimin e Al – Qaidas, lëvizja terroriste arabe u zgjerua dhe u radikalizua si asnjëherë më parë. Kjo është hera e parë në historinë 1400–vjeçare të fesë islame që një grup muslimanesh lejonte vrasjen e qytetarëve të krishterë dhe cifut, kudo në botë. Vrasja e tyre konsiderohej jo vetëm e legjitimuar por edhe një obligim moral për çdo musliman. Vetëm pak muaj pas formimit të saj më 7 gusht 1998, Al-Qaida organizoi dy sulme të njëkohshme terroriste kundër ambasadave amerikane në Kenia dhe në Tanzania, si rezultat i të cilave humbën jetën 224 njerëz (12 amerikane), dhe u plagosen mbi 4,000 të tjerë pastaj sulmi ndaj anijes ushtarake amerikane USS në Aden, duke shkaktuar vdekjen e 17 marinsave amerikane. Pas një viti Al-Qaeda goditi në New York dhe në Pentagon, pastaj në Bali të Indonezisë, në Moskë, në Raid, në Madrid, në Londër, në Sharm el-Sheikh etj. Ndërkohë, Iraku i çliruar nga regjimi i Saddam Husseinit dhe Afganistani u çlirua nga regjimi mesjetar i Talibanëve edhe sot e kësaj dite, akoma kemi skena të aksioneve terroriste të frymëzuara nga ideologjia vrasëse e Al-Qaedas dhe pasuesve fanatike të saj.

1.10. Rrënjët e radikalizmit islam

Islami është ideologji dhe besim, atdheu dhe kombësia, doktorina dhe shteti, shpirti dhe veprimi, libri dhe shpata (Hassan al-Banna, 1934)²⁵ Të ndihmuar nga ai që na mundësoj të mbijetojmë dhe të mposhtim Bashkimin Sovjetik , mund të na ndihmojë prapë që të mposhtim edhe Shtetet e Bashkuara, në të njëjtin territor dhe me të njëjtat metoda, sepse i tillë është vullneti i Allahut. Prandaj ne besojmë se me vullnetin e Allahut mund të mposhtim Amerikën dhe këtë do ta bëjmë më lehtë se me Perandorinë Ruse. (Osama Bin Laden 2001)²⁶

Pas sulmeve të 11 shtatorit, janë bërë me qindra shkrime të studiuesve, të gazetareve dhe të analistëve e shkrimeve të ndryshëm, të cilët e argumentojnë zemërimin e disa vendeve islamike ndaj perendimit si produkt të shtypjes së muslimanëve nga vendet perendimore. Mirëpo revista “Times“, shpalli një artikull ku shkruante se terrorizmi është një “vajtim i hidhur i të viktimizuarit“.²⁷ Por sipas tyre, këta terroriste të viktimizuar, në mënyrë të ndryshme po e drejtojnë zemërimin e tyre kundër botës perendimore, për shkak të rritjes së mbështetjes perendimore ndaj Izraelit dhe asgjësimit të Perandorisë Osmane që dikur kishte këmbët në Evropë.

²⁵ The History of Terrorism from Antiquity to Al-Qaeda, Gerard Chaliand and Arnaud Blin . Fq 124

²⁶ Ibidem, fq 125

²⁷ The Roots of Islamic Radicalism, Philippe Migaux, fq 208

Shumë analistë dhe shkrimtarë perendimorë, shkaqet e terrorizmit i lidhin me problemin e Palestinezëve dhe Izraelitëve, disa tjerë e shohin varfërinë në shumë vende arabe si shkak të terrorizmit, ndërsa disa tjerë thonë se regjimet në këto vende janë fajtorë për përfshirjen e njerëzve dhe organizatave arabe në aktet terroriste globale. Mirëpo sipas disa studiuesve tjerë, 15 nga 19 terroristët që kryen aktet terroriste të “11 shtatorit“ ishin nga Arabia Saudite dhe këta terroriste nuk kishin problem sociale, pasi që ky shtet qëndron mirë ekonomikisht për shkak të rezervave të shumta të naftës që posedon. Duhet theksuar se shumica prej terroristëve që rrëmbyen avionet civile, ishin pjeswtar të forcave të armatosura të Arabisë Saudite, pilotë ushtarakë apo civilë, por disa prej tyre ishin edhe studentë dhe imamë të xhamive në AS.

Shumë analiste të disa vendeve muslimanë në botë, nuk ngurrojnë të shprehin mendimin e tyre se shkak i pakënaqësive të grumbulluara në botën islame ndaj perendimit është pikërisht rënia e Perandorisë Osmane dhe zhvendosja e saj jashtë Evropës. Në fakt problemet e qytetërimit dhe civilizimit islam përfshijnë rreth 200 vjet të dominimit nga vendet e huaja, kryesisht perendimorë, të cilat që nga viti 1750 e deri në vitin 1950 sunduan tokat arabe dhe vendet muslimane.

Britania e Madhe, Franca, Spanja, Portugalia, Italia, Rusia, bile edhe Sërbia, mbanin në sundimin e tyre shumë vende muslimane. Mirëpo Britania e Madhe, ishte shteti që ndoshta muslimanët përfituan më së shumti prej tij, ngase ishin britanikët ata që krijuan një shtet të ri nga India e bashkuar dhe ky ishte Pakistani, që në fakt është popull Indian por me fe islame. Britania ishte ajo që vuri në binarë strukturat shtetërore ekonomike e kulturore të shumë vendeve arabe, duke respektuar me rigorozitet traditat dhe fenë islame, ndërsa sot është më e sulmuar nga këto vende.²⁸ Duhet të themi se ideologjia e lëvizjes radikale islame apo lëvizjes muxhahedinëve është lëvizje e cila shpesh quhet “*xhihadi islamik*“, i cili na lë të kuptojmë se “*xhihadi*“ është tregues i mendimit radikal islam që përdorë udhëzimet e Kuranit, si “*parajsë nën hijen e shpatave*“. Por sidoqoftë islami nuk është një fe që predikon dhunë dhe këtë e dëshmon edhe lufta e fundit në Bosnjë dhe Hecergovinë, ku me qindra e mijëra muslimanë boshnjakë u masakruan në një gjenocid i paparë nga sërëbët, të cilët përveç që vranë, dhunuan dhe dogjën rreth 2000 xhami të muslimanëve, këta të fundit nuk dogjën asnjë kishë apo “sinagogw “ hebraike në zonat që ata kontrollonin.

²⁸ The Roots of Islamic Radicalism, Philippe Migaux, fq 209

1.10.1 Osama Bin Laden

Osama Bin Laden lindi më 10 mars 1957 në Riad të Arabisë Saudite dhe u vra më 2 maj 2011, rreth orës 1 të natës në Abotabad në Pakistan nga forcat special amerikane “SEALS“. Njeriu më i kërkuar në botë, si terrorist ndërkombtarë në fillim të këtij shekulli ishte udhëheqësi i organizatës famëkeqe “Al- Qaeda “i quajtur Osama Bin Laden ²⁹. Ky njeri për një kohë të gjatë ishte terroristi më i kërkuar në botë, por u vra nga seals-at, si rezultat i një operacioni të organizuar shkëlqyeshëm nga shërbimi amerikan i intelgjencës dhe i cili ishte drejtuar nga vetë Presidenti Barack Obama dhe ndihmësit e tij Robert Gates dhe Hillary Clinton. Ishte pikërisht Bin Laden, i cili me paratë e tij dhe frymëzimin e marrë nga predikimet, organizoj sulmet terroriste të 11 shtatorit 2001, ku humbën jetën 3000 njerëz në Nju York, Uashington dhe Pensilvani, si dhe hapi një vrimë të madhe ndjenjës së pasigurisë së përgjithshme jo vetëm në Shtetet e Bashkuara por edhe në Evropë dhe në tërë botën.



Osama Bin Laden lindi në vitin 1957 në një familje të pasur dhe të privilegjuar të Arabisë Saudite. Ai e kaloi rininë e tij në pallatet e mbushura plot me kristale të cmuara, me statuja prej ari dhe me tepiceri italiane. Ai u bë i njohur si djal më i devotshëm dhe më i vyeshëm në mesin e 54 fëmijëve të babait të tij të pasur e me shumë gra. Thuhet se babai i Ladenit është vrarë në një aksident ajror në vitin 1976, prej nga pjesa e trashigimisë që i takonte Bin Ladenit ishte 300 milionë dollarë. Rruga e tij militante islame filloi në moshën e tij adoleshente në vitet 1970, kur u kap nga lëvizjet fundamentaliste që vepronin në Arabinë Saudite dhe të cilat më vonë u shtrinë në shumë shtete arabe. Ai ishte një lexues i pangopur i literaturës islamike dhe një vizitor dhe dëgjues i shpeshtë i predikimeve fetare në qytetin e shenjtë të Mekes.

²⁹ Donald Rumsfeld, “ A New Kind of War “, New York, September 27, 2001

Më 1972, Bin Laden besohet të ketë marrë në këtë kohë për grua një vajzë 14 vjecare të quajtur Naxhija, kur ky ishte 18 vjet. Në vitin 1979 ky largohet nga Arabia Saudite dhe i bashkohet muxhahedinëve afgane për të luftuar kundër rusëve. Në këtë kohë ky bëhet figurë më e njohur në botë për luftën e tij kundër rusëve. Ndërkohë Bin Laden e përdorë tërë pasurinë e tij personale për të krijuar qelizat e luftëtarëve nga gjithë bota muslimane kundër pushtimit sovjetik. Në këtë kohë ai formon Al-Qaeda-n (baza), për të rekrutuar, trajnuar, organizuar dhe mbledhur fonde për luftë. Kur në vitin 1990 Iraku invadon në Kuvajt dhe kur Shtetet e Bashkuara dislokohen në Arabinë Saudite me kërkesën e kësaj të fundit për të mbrojtur pusët e naftës nga irakianet. Në këtë kohë Osama Bin Laden, u përpoq të kthej vëmendjen e botës islame kundër Shteteve të Bashkuara, për të mos lejuar ushtrinë e krishterë të shkelin në tokën e Profetit Muhamet, apo aty ku kishte lindur Islami. Pas këtyre kundërshtimeve mbreti i Arabisë Saudite i hoqi atij shtetësinë e Arabisë.³⁰

Një vitë më vonë Osama dislokohet në Sudan, prej nga së bashku me pakistanezin Ramzi Ahmed Jusuf, implikohet në operacionet për vrasjen e Papës gjatë vizitës në Manila të Filipinëve, vënien e bombës në qendrën botërore tregtare në Nju York, në sulmet e organizuara me bomba në hotelet me ushtarë amerikane në Jemen dhe Somali.

Më 3 dhe 4 tetor të vitit 1993 mbështetësit e Bin Ladenit organizojnë sulmin befasues, më të ashpër dhe më të furishëm kundër trupave amerikanë në Mogadishu të Somalisë. Në betejë morën pjesë përkrahësit e Bin Ladenit dhe formacionet vendase, kundër pjestarëve elitare të ushtrisë amerikane, sic ishin “*Delta Force*”, “*Army Rangers*”, “*Navy Seals*”, “*Air Force Combat*”, etj., por që u detyruan të tërhiqen me shpejtësi (më shumë humbje) nga qyteti Mogadishu për në bazën e paqeruajtësve Malajzia-s të UN-it në këtë qytet. Amerikanët ishin aty me kërkesë të UN-it për të shpërndarë miell për popullsinë e uritur somaleze. Kjo është ngjarje e dhimbshme për të cilën është realizuar filmi i njohur i Hollivudit “*Black Hawk Down*”. Ndërkohë aktivitetet terroriste të Bin Ladenit shtohen, duke vrarë disa ushtarë amerikanë në Riad të AS, ku ky përveç që merr përgjegjësinë për këtë rast, por ju bën thirrje arabëve për dëbimin e amerikanëve prej Arabisë Saudite.

³⁰ Lauren B O’Brein “The evolution of Terrorism since 9/11” “The FBI’s Counterterrorism. Fq 89

Ndërsa në vitin 1996, i deklaroi hapur luftë Shteteve të Bashkuara, duke bombarduar fuqishëm një kullë dhe vrrarë me dhjetëra ushtarë amerikanë në Riad. Me këtë rast edhe Arabia Saudite edhe Shtetet e Bashkuara fillojnë ndjekjen e tij, me c'rast ai arratiset në qytetin lindor Xhalalabad të Afganistanit. Ky kalon në mbrojtjen e hekurt të talebanëve afganë, të cilët e vendosin atë në një bazë të vjetër ajrore ruse afër qytetit Kandahar në Afganistan. Më vonë në një kamp stërvitor, Bin Laden dhe shokët e tij “ të vijës së ashpër “, krijojnë “ Frontin Islamik Botëror “ për xhihad kundër ciferëve dhe kryeqytetarëve.³¹

Më 7 gusht të vitit 1998 ndodhën dy eksplozime binjake (në të njëjtën kohë) në ambasadat amerikane në Kenia dhe në Tanzania, ku humbën jetën me dhjetra njerëz. Mirëpo kampi i Bin Ladenit në Afganistan, këtë herë u sulmua me 70 raketa “ Tomahok “ nga një luftanije në gjirin Persik, por ai shpetoi për pak, përderisa kampi u ngrit i tëri në erë. Më vonë Bin Laden jep një intervistë për një gazetë, në të cilën thotë se: *“Ne besojmë se hajduti më i madh në këtë botë dhe terroristët më të mëdhenj janë vetë amerikanët, prandaj mënyra e vetme për ti frenuar këto sulme amerikane edhe që kundër tyre të përdorim edhe mjete të ngjajshme“*. Kjo që tha, vërtetohet pak ditë më vonë kur sulmohet destroyeri ushtarak amerikan në Jemen dhe vriten dhjetra ushtarë amerikanë. Por sic do të mësojmë në vazhdim, sulmet madhore terroriste, të organizuara nga Bin Laden sapo kanë filluar.

Më 11 shtator të vitit 2001, Shtetet e Bashkuara tronditën nga një seri sulmesh të koordinuara mirë, ku rrëmbyes të Al-Qaeda rrëmbejnë aeroplanët civilë të linjave të mbrendshme ajrore dhe godasin brutalisht, si asnjëherë më parë në historinë moderne të njerëzimit, kullat binjake apo qendrën botërore tregtare, në Nju Jork, ndërtesën e Pentagonit dhe caqet tjera.³²

³¹ Donald Rumsfeld, “ A New Kind of War “, New York, September 27, 2001 fq 89

³² Ibidem, fq 100

1.10.2 Si u vra Osama Bin Laden?

Sipas rrëfimit autentik të komandantit të parë të forcave “SEALS“, Richard Marcinko, operacioni u zhvillua në këtë menyrë:

“ Ishte një sulm që ndodhi me shpejtësi marramendëse, kishim vetëm 30 sekonda kohë të zbrisnim nga helikopteri. Nuk kishte kohë për tu menduar, trupat kishin marrë urdhër të prerë që asgjë që mund të linim prapa të mos levizte më “.

Shumë njerëz filluan të thonë se : Pasi Amerika nuk mundi që edhe pas 10 vjetësh të ngjarjeve të 11 shtatorit, të kap Osama Bin Ladenin atëherë ajo nuk do ta kap më kurrë atë. Edhe vetë Osama duhet të ketë menduar kështu, se tani më është e sigurt që Shtetet e Bashkuara dukeshin se ishin lodhur duke ndjekur terroristin më të kërkuar në botë. Bin Laden ishte zhvendosur nga mallet e humbura të Afganistanit, në një shtëpi luksoze një milion dollaresh, në një nga qytetet më piktoreske të Pakistanit të quajtur Abotabad, sipas emrit të Xhejms Abot, një britanik që e themeloi qytetin në vitin 1953.



Administrata amerikane, në tension gjatë operacionit “ Geronimo “, - Foto.

Abotabad kishte një klimë shumë të mirë dhe ishte një vend i preferuar nga shumë turistë të huaj dhe një vend ku jetojnë shumë pasanikë. Shtëpia e tij mund të shihej se çfarë kishte brenda mureve , vetëm me satelit nga orbita e Tokës. Sipas burimeve të intelegjencës amerikane, Bin Laden u kap në befasi kur u sulmua. Thuhet kur u pa herën e fundit, ai u largua në shpinën e një kali, bashkë me një person tjetër, pasi u sulmua nga trupat britanike e amerikanë në “ Tora Bora “ të Maleve të Bardha në Afganistan.³³

CIA i kishte vënë atij nofkën “ Elvis “ për ta identifikuar. Mirëpo siaps CIA-se u desht të vinte informacion “top secret“, vitin e shkuar, që Osama fshihej në Abotabad. Tetë muaj u desh që të verifikohesh ky informacion dhe kjo u bë në besueshmëri të lartë. Obama dhe shefat e tij të sigurisë donin të ishin të sigurt që do kishin sukses pas që shumë dështimesh dhe mbi të gjitha nuk e imagjinonin dot se Bin Laden ishte aq afër! Obama mori edhe prova fotografike se Bin

³³ The History of Terrorism- Gerard Chaliand and Arnaud Blin, London fq 113

Laden vërtet ndodhej aty dhe autorizoi nisjen shpejtë të operacionit për zënien e keqberësit të shumë kërkuar.

Menjëherë një grup i vogël i forcave speciale amerikane “US Navy Seals“, mori udhëzimet e detajuara: “*Kapeni Osama Bin Ladenin, të gjallë ose të vdekur*“. Sipas dëshmitarëve, operacioni i koduar me emrin “*Neptune Spear*“ (shigjeta e neptunit) nisi që mëngjesin e së dielës (s-maj-2011). Pak përpara mesnatës, katër helikopter hapën zjarr në një vile luksoze në rrethinën e qytetit Abotobad, 100 kilometra në veri të Islamabadit, ndërsa operacioni zgjati 40 minuta. Godina e cila rrethohej me mure të larta, ishte një shtëpi një milion dollaresh e ndërtuar në vitin 2005, por për cudi nuk kishte lidhje me botën, as telefon as internet. Shtëpia kishte roje në të gjitha anët, të cilët gjuajtën nga catia e shtëpisë duke rrëzuar një helikopter amerikan, i cili më vonë u dogj nga amerikanët. Seals-at hynë në shtëpi me rrëmbim në një errësirë të plotë me pamje të qartë me rreze infratëkuqe, goditën në kokë Bin Ladenin, përderisa ai po evitonte kapjen e tij të gjallë. Ndërkohë u vranë edhe tre burra tjerë dhe një grua që u përdor si mburojë njerëzore. Asnjë amerikan nuk u plagos në këtë operacion. Trupi i Bin Ladenit u mor në dorë nga Seals-at dhe u vendos në helikopter së bashku me shumë material si dëshmi të veprimeve të Bin Ladenit ndër vite.³⁴

Ky ishte një përfundim poshtërues i kryeterroistit më famëkeq në botën modern / cili ishte “shenjeza “ e ndjekjes më të madhe të bërë në historinë e njerëzimit ndaj një kriminelit të terrorizmit ndërkombtarë. Thuhet se ai u trajtua sipas riteve islame para se trupi i tij të hidhej në det të hapur, diku në oqeanin paqësor. Arsyeja se pse u hodh në det, lidhet me praktikat dhe traditat islame dhe kjo praktike kërkon që trupi i të vvarit të varroset mbrenda 24 orësh. Arsye tjetër është se shumë vështirësi mund të gjendet një vend që do pranonte të mbante trupin e njeriut më të kërkuar në botë, ku varri i të cilit më vonë mund të shëndrrohej në pelegrinazh. Arsye tjera nuk po i diskutojmë!



³⁴ Raufër.X, Kumbarët e botës, Tiranë, 2005, fq 255

1.10.2.a) Si u zbulua vendndodhja e Osama Bin Ladenit ?

Qysh në muajin gusht të vitit 2010, amerikanët kishin një informacion se ku ndodhej Bin Laden. Atë kohë nuk ndërhnë sepse deshën të ishin 100% të sigurt se vërtet ishte ai. Amerikanët ranë në gjurmë të vendndodhjes së tij prej dy korrierëve që përdorte Bin Laden. Një i burgosur pakistanez në Guantanamo ka njoftuar amerikanët para vitit 2007 se një person me emrin (të njohur për CIA-n) është një person shumë i besuar i Bin Ladenit. Amerikanët arritën që të gjejnë emrin e vëret të këtij personi dhe e përgjuan në cdo hap. Vunë re se ai së bashku me një person tjetër shkonin në një shtëpi shumë të madhe me murë shumë të larta e cila ndodhej rreth 100km larg kryeqytetit Abotabad. Amerikanëve iu bëri përshtypje se pse një shtëpi kaq e madhe e bukur dhe moderne nuk kishte telefon, celular dhe lidhje interneti.³⁵

1.10.2.b) Kush ishte “ sheiku i terrorit “?

Ka mundur të jetojë jetën si princi i një familje miliardere, por vdiq si terroristi më i kërkuar në botë. Miqtë e tij të asaj kohe përshkruajnë një të ri të devotshëm, të rezervuar, tepër i përkushtuar ndaj studimit të teksteve kryesore të vehabizmit, variant i ashpër i islamit sunit në fuqi në vendin e tij.

Pas sulmeve të “11 Shtatorit“, SHBA-ja ndërmori një operacion të gjërë për kapjen e shefit të Al-Qaeda, ndërsa fillimisht ofroi 25 milion dollarë më pas cmimi u rrit në 50 milion për cdo informacion për kapjen e tij. Bin Ladeni, që në fund të vitit 2001 i shpëtoi ndërhyrjes së trupave amerikane në Afganistan, ishte lokalizuar për herë të fundit nga dëshmitarët në Kandahar, në jug të Afganistanit. Shërbimet sekrete rajonale apo shërbimet sekrete perendimore kishin vlersuar për një kohë të gjatë se ai fshihej në zonat në kufirin mes Afganistanit dhe Pakistanit, por specialistet ushtarak shpreheshin jo publikisht se nuk kishin asnjë pistë serioze në këtë drejtim.

1.10.2.c) Pasuesit e Bin Ladenit?

Pas 11 shtatorit të vitit 2001, Shtetet e Bashkuara lëshuan një listë me liderët e dyshuar të Al-Qaeda. Që atëherë shumë prej tyre janë kapur, të tjerë janë vrarë, ndërsa të tjerë kanë rritur

³⁵ www.news.bbc.uk

prestigjin e tyre në radhët e organizatës së tyre. Pas vrasjes së liderit kryesorë Bin Laden, pesë pretendentët kryesorë për zëvendesimin e tij në krye të rrjetit terrorist janë:³⁶

- a) **Ayman al Zawahiri.** Një mjek kirurg me një sy që ndihmoi në themelimin e grupit militant “ Xhihadi Islamik Egjiptian “. Prej kohësh ai është shefi i ideologjisë së grupit dhe dyshohet nga disa eksperte se ka qenë “ truri operacional “ i sulmeve të 11 shtatorit.
- b) **Abu Yahy al Libi,** i njohur ndryshe si Hasan Qayid, i cili mendohet se ka qenë anëtarë i grupit luftarak të islamit Libian, para se të bënte aleance me Osama Bin Laden-in, thuhet se ky është teologu kryesorë i Al-Qaedas dhe si njeriu më i shfaqur nëpër video, duke lënë pas Ayman al Zawahirin.
- c) **Khalid al Habib.** Mendohet se është egjiptian ose marokan, është identifikuar për herë të parë në një video të transmetuar në nëntor të vitit 2005. Ai shfaqej si komandanti i operacioneve të terrenit në jug-lindje të Afganistanit, ndërkohë që në jug-perendim homologu i tij ishte Abd al Hadi al Iraqi.
- d) **Adnan el Shukrijumah.** Në gusht të vitit 2010, FBI tha se El Shukrijumah ka marrë drejtimin e këshillit të operacioneve të jashtme të Al-Qaedas. Pasi ka jetuar për 15 vjet në SHBA dhe është e para herë që një lider kaq i afërt me shoqërinë amerikane zgjidhet për drejtimin e seksionit për sulmet jashtë Afganistanit.
- e) **Atiyah Abd al Rahman.** Një libian që u bashkua me Osama Bin Laden në Afganistan që kur ishte adoleshent, në vitet 1980. Që atëherë ai ka fituar një reputacion të rëndësishëm në radhët e Al-Kaedes, si specialist i eksplozivit dhe një islamik i shkolluar. Lista e pretendentëve vijon me emra të tjerë si: *Saif al Adel, Mustafa Hamid, Saad Bin Laden, Hamza Al Jawfi, Matiur Rahman, Abu Khail al Madani, Midhat Mursi, Fahd Mohammed Ahmed al Quso, Addam Gadahn, Nasser Abdul Karim al Wuhayshi, Anwar al-Awlaki etj.* Sidoqoftë vrasja e liderit të Al-Qaedas, Osama Bin Laden përbën një goditje të rëndë për organizatën, por analistë të ndryshëm thonë se natyra e decentralizuar e saj bën të mendosh se organizata është në gjendje të kryejë një seri sulmesh të tjera. Filozofia e sotme e Al-Qaedas është “një njeri, një bombë “. Në ditët e sotme, gati cdo vend evropian ka një celutë të Al-Qaedas. Qindra muslimanë me pasaportë evropiane kanë urdhëruar në zonat tribale të Pakistanit për t’u stërvitur dhe më pas janë kthyer sërish në Evropë.

³⁶ www.algeria-interface.com/english/politics/index.html

Afganistani, Pakistani dhe India janë gjithashtu të rrezikuar jashtëzakonisht nga sulmet e organizuara të Al Qaedas.

1.10.2.d) Trupat që vranë Osamen- “ Navy Seals “ dhe “ Delta “

Në Seals bëjnë pjesë forcat elitare speciale amerikane , duket sikur janë shumë prej tyre, por në fakt janë vetëm dy mijë trupa në tërë Shtetet e Bashkuara . Ata janë luftëtarët më të fortë të Amerikës. Ata janë të stërvitur në të gjitha fushat e mundshme deri në nivelet më të larta të trajnimit. Të jesh anetarë i Seals, duhet të jesh nga mosha 18–28 vjec dhe për t'u zgjedhur duhet që parametrat fizike të jenë përtej normales. Forcat e Seals janë të specializuar në gjithcka që mund të ndodhë.³⁷

Forca Delta është njësia e vetme zyrtare amerikane kundër terrorizmit që i dedikohet shpëtimit të pengjëve në të gjitha rastet e mundshme. Njësia Delta menaxhohet nga ushtria dhe përzgjedhja bëhet duke u bazuar në testin fizik, që nis me ushtrime normale dhe vijon nga një vrap prej 6 kilometrash. Më pas vazhdon ngjitja në një terren malor me qindra kilometra (si xhungla e amazones), me një cantë shpine që peshon rreth 50 kilogramë, pa kompas dhe pa hartë.

1.10.2 e) Lajmi zyrtarë për asgjësimin e Bin Ladenit

Pas njoftimit për vrasjen e Osama Bin Laden, grupet e Xhihadit mallkojnë presidentin e SHBA-së, Barack Obama, duke bërë titur *“Allah, bëj që ky lajm mos të jetë i vërtetë”*. Ndërsa Presidenti i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Barak Obama, në një fjalim për kombin tha: *“ Osama bin Laden u vra “. “Drejtësia u vu në vend“. Këtë mbrëmje jam në gjendje që t'i njoftoj amerikanët dhe gjithë botën se trupat tanë kanë kryer një opercion dhe kanë vranë Osama Bin Ladenin, liderin e Al-Kaedas – u shpreh Obama*

³⁷ Nazmi Maliqi, Sistemi i Sigurisë, Shkup 2010, fq 117

1.10.2 f) Atentatet që ka udhëruar Bin Laden

Më poshtë vijon një përmbledhje e atentateve kryesorë atribuar rrjetit terrorist Al-Qaeda dhe shefit të saj, Osama Bin Laden.

- ✚ 26 shkurt 1993; SHBA – *atentat me eksploziv në Qendrën botërore të tregtisë World Trade Center*), 6 të vdekur;
- ✚ 13 nëntor 1995; Arabia Saudite – *një autobombë shpërthen në Riad. Vdesin pesë ushtarë amerikanë dhe dy indian;*
- ✚ 25 qershor 1996; Arabia Saudite – *një kamion me dy tonë eksplozive shkatërron bazën amerikane në Khobar, 19 të vdekur, të gjithë amerikanë dhe 386 të plagosur ;*
- ✚ 7 gusht 1998; Kenia/Tanzani – *dy autobomba shpërthejnë në mënyrë simultane në ambasadën amerikane në Najrobi (Kenia) dhe Dar es Salam (Tanzani), 224 të vdekur, 12 amerikanë dhe mijëra të plagosur.*
- ✚ 12 tetor 2000; Jemen – *17 marinsa amerikane vdesin në portin e Adenit pas atentatit kundër destroyerit amerikanë :” USS Cole “.*
- ✚ 11 shtator 2001; SHBA – *katër avijonë të linjës me 266 persona në bord përdoren si armë kundër World Trade Center në Nju Jork, Pentagon dhe Uashington. Avioni I katërt rrëzohet në Pensilvani. Bëhet fjalë për 3000 të vdekur dhe të zhdukur.*
- ✚ 11 prill 2002; - *Tunizi – 21 të vdekur pas atentateve në sinagogat e Ghribas në Djerba.*
- ✚ 12 tetor 2002 ; *Indonezi 202 të vdekur, shumë turistë të huaj pas një atentati në një diskotekë në Bali.*
- ✚ 12 maj 2003 ; *Arabia Saudite – 35 të vdekur, nëntë amerikanë, pas një atentati të trefishtë ndaj një kompleksi rezidencial në Riad.*
- ✚ 16 maj 2003 ; *Marok – 45 të vdekur pas katër atentateve të një pas-njëshme.*
- ✚ 15 dhe 20 nëntor ; *Turqi – 63 të vdekur pas katër atentateve kamikaze kundër dy sinagogave, konsullatës britanike dhe bankës britanike, HSBC në Stamboll.*
- ✚ 2 mars 2004 ; *Iraku me shumë se 180 të vdekur pas një sërë atentatesh në Bagdad dhe Kerbala (vend I shenjtë shiit).*
- ✚ 11 mars 2004 ; *Spanjë 191 - të vdekur dhe 2000 të plagosur pas një serie atentatesh kundër trenave në Madrid dhe periferi të tij ;*
- ✚ 7 korrik 2005 ; *Londër – 56 - të vdekur pas katër atentateve kamikaze në Londër ;*

- ✚ 23 korrik 2005 ; Egjipt – 68 - të vdekur në Sharm el-Sheikh të Egjiptit ;
- ✚ 9 nëntor 2005 ; Jordani – 60 - të vdekur pas tre atentateve kundër hoteleve në Aman ;
- ✚ 24 prill 2006 ; Egjipt – 20 - të vdekur dhe 90 të plagosur pas tre atentateve në Dahab ;
- ✚ 14 gusht 2007 ; Irak – më shumë se 400 të vdekur pas katër atentateve kundër një sekti fetar kurd në Ninive ;
- ✚ 11 dhjetor 2007 ; Algjeri – 41 të vdekur pas atentatit kamikaz në Algjer të Algjerisë ;
- ✚ 20 shtator 2008 ; Pakistan – 60 të vdekur pas një atentati kamikaz kundër një ceremonie fetare .
- ✚ 24 nëntor 2010 ; Jemen – 23 të vdekur pas një atentati kamikaz kundër në ceremonie fetare.

1.11. Al-Qaeda

Al-Qaeda apo përkthyer në shqip “ Baza “, është një organizatë militante islamike e cila është krijuar nga Osama Bin Laden në Peshavar të Pakistanit në gusht të vitit 1988. Kjo organizatë përfshin një rrjet militant shumëkombësh e cila ka krijuar një ushtri pa shtet duke thirur për një luftë globale (xhihadit) i cili do të sjellë në pushtet “ sheriatin “, një ligj të fortë islamik. Kjo organizatë është cilësuar si terroristë nga Këshilli i Sigurimit, nga Bashkimi Evropian, Shtetet e Bashkuara, Britania e Madhe, India dhe vende tjera. Al- Qaeda ka kryer shumë sulme mbi popullatën shiite (jo – sunite), jo muslimane dhe objektivat tjera të quajtura sipas saj “ kafir “, apo “ jo besimtarë “.



Harta tregon vendet ku operon organizata “ Al – Qaeda “

Al-Qaeda ka kryer me qindra aksione terroriste, duke përfshirë edhe aksionet shkatërruese nëpër ambasada dhe lokalitete civile anëmbanë botës, por sulmi më i madh i saj konsiderohet të jetë sulmi me avionet civile mbi Nju Jork, Pensilvani dhe Pentagon. Teknikat kryesore të Al-Qaedas janë sulmet vetëvrasëse, vënja e bombave dhe eksploziveve në lokalitetet me të banuara me popullatë civile. Kjo organizatë angazhohet për zhdukjen e ligjeve të krijuara nga njeriu dhe zëvendësimin e atyre të krijuara nga allahu, duke krijuar kudo në botë, një ligj të rreptë të sheriatit islam. Kjo organizatë poashtu është përgjegjëse për nxitjen e luftës sektare në botën islame, duke sulmuar ashpër sektet shiite dhe sufite, si dhe duke sulmuar xhamitë dhe tubimet e tyre sidomos në Irak dhe Siri.³⁸

Pas vrasjes spektakolare të Osama bin Laden, drejtimin e Al-Qaedas e ka marrë teologu egjiptian Ayman al-Zawahiri, i cili poashtu është në listën e terroristëve më të kërkuar në botë dhe besohet se do të ketë fajin e njejtë me të paraardhësit të tij. Prandaj në fund duhet të theksojmë se kreu i kësaj organizate për më shumë se një dekadë ishte trangu i Xhihadit Islamik në mbarë botën.³⁹



Ushtria terroriste e Al-Qaedas

³⁸ The History of Terrorism from Antiquity to Al-Qaeda, Part III, Al-Qaeda, pg 314, Philippe Migaux, fq 114

³⁹ www.algeria-interface.com/english/politics/index.html

1.12. Kundër terrorizmi

Kundër terrorizmi është një mjet me të cilin shtetet të ndryshme i përgjigjen terrorizmit si dukuri dhe organizatave terroriste në vecanti, për ti ndalur veprimet e tyre dhe për ti shpërbërë këto organizata. Të gjitha shtetet i kanë shërbimet e veta të fshehta, apo shërbimet intelegjente, me anë të cilave ata mund të identifikojnë këto organizata, por kushti kryesorë është se këta organizata duhet të jenë sycelë dhe të aftë të përballen me furinë dhe tinëzinë e organizatave terroriste. Meqenëse po flasim për fenomenin në aspekt global, atëherë duhet të themi se organizatat më të forta kundër terrorizmit në mbarë botën janë:

- 🚩 *Agjencia Qendrore e Intelegjencës Amerikane (CIA);*
- 🚩 *Byroja Federale për Investigim (FBI);*
- 🚩 *Agjencia Franceze e Intelegjencës;*
- 🚩 *Shërbimi Federal i Intelegjencës Gjermane ;*
- 🚩 *Agjencia Kombëtare e Intelegjencës Izraelite (Mossad);*
- 🚩 *Shërbimi Sekret i Intelegjencës Britanike, e shumë të tjera.*

Të gjitha këto organizata si dhe mbarë komuniteti ndërkombtarë, janë bashkuar dhe janë duke punuar kundër këtyre organizatave terroriste, sidomos në identifikimin dhe gjetjen e vendit ku ndodhën celulat e këtyre organizatave, qofshin ato mbrenda apo jashtë vendeve të tyre. Shumë vende demokratike të botës dhe vende të cilat duan lirinë dhe sigurinë kombëtare, kanë bërë një koalicion të madhë dhe kanë nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me Shtetet e Bashkuara, të cilat sot janë lider në luftën kundër terrorizmit. Dëshmi për këtë është edhe koalicioni mes aleatëve në luftën që po bëhet kundër terrorizmit në Afganistan dhe vende tjera të lindjes së mesme. Sa për dijeni, në këtë grupim bëjnë pjesë edhe formacionet speciale të Shqipërisë që i janë bashkuar koalicionit të madh kundër terrorizmit.

Me sa dihet më parë kurrë nuk ka pas një unitet kaq të madh në luftën kundër terrorizmit, sa ky që është arrit kohëve të fundit, sidomos pas ngjarjeve të 11 shtatorit, ku bota e pa se sa i vrazhdë dhe brutal mund të jetë terrorizmi. Sic po shihet, kundër terrorizmi do të jetë një çështje

globale dhe bashkëpunimi kundër kësaj të keqe nuk do të pushojë gjithmonë derisa të egzistojë terrorizmi si kërcënim ndërkombtarë.

1.13 Kidnapimet e aeroplanëve

Rrëmbimi i avionëve është një fenomen terrorist i kohës moderne i cili ka të bëjë me kidnapimin e pilotëve dhe stafit drejtues të aeroplanit apo të pasagjerëve që udhëtojnë me aeroplan. Kidnapimi është një konfiksion i paligjshëm i avionit nga një njeri apo grupe njerëzish, ku në të shumtën e rasteve, piloti detyrohet të drejtoj avionin në bazë të urdhrave të rrëmbyesit. Ndodhë që rrëmbyesit të marrin nën kontroll avionin dhe të drejtojnë vetë atë kah duan ata, por ndodh edhe tjetra që bashkëpiloti të rrëmbejë avionin nga kolegu i tij, ose vetë piloti të rrëmbejë avionin që drejton, duke vënë kushte për zyrtarë qeveritarë apo shtete të ndryshme. Shpesh rrëmbimet terroriste bëhen për qëllime parash, por ka raste edhe kur rrëmbimet bëhen për koncesione politike dhe administrative. Rasti më ekstrem i përdorimit të avionëve për qëllime terroriste është pikërisht ai për të cilin jemi duke studiuar, pra rrëmbimet e avionëve të linjave të mbrendshme amerikane më 11 shtator 2001.

Me këtë datë, 19 terroristë rrëmbyen avionët ; Airlines Flight 11, United Airlines Flight 175, American Airlines Flight 77, dhe United Airlines Flight 93, që u rrëzuan mbi kullat binjake të Qendrës Tregtare Botërore, në ndërtesën e pentagonit dhe në Stonycreek Township afër Shanksville të Pensylvani-së. Ky ishte rrëmbimi më fatal në historinë e terrorizmit ku mbetën të vrarrë 3000 njerëz.

Sot janë bërë përparime të mëdha në lidhje me sigurinë e udhëtarëve të linjave ajrore, duke filluar nga trajnimi i pilotëve për t'iu kundërpërgjigjur rrëmbyesve, e deri te siguria shumë e lartë në dyert e kabinës së pilotimit dhe në aeroport. Pas sulmeve me avionë civile mbi kullat binjake, disa vende si Polonia, Rusia, India, et., miratuan ligjet që në raste të vecanta lejojnë rrëzimin e avionëve civile të kidnapuar prej terroristëve por më vonë këto ligje u anuluan.

KAPITULLI - III

TERRORIZMI DHE SULMET E 11 SHTATORIT

2.TRENDET E EVOLUIMIT TE TERRORIZMIT DERI NE SULMET E 11 SHTATORIT

Për historinë të cilët studiojnë terrorizmin bashkëkohor, janë katër vite të cilat konsiderohen si pika kthese në organizimin e akteve terroriste: viti 1968, 1979, 1983 dhe 2001. Ne vitin 1968, kryengritësit në Amerikën Latine nisen të ashtuquajturën strategjinë e tyre guerile urbane, ndërsa në anën tjetër të globit (në lindjen e afërt) janë Palestinezët të cilët inicuan taktikat e tilla terroriste për të dhënë jehonë çështjes së tyre të pazgjedhur politike, e cila nga një lëvizje paqësore evoluoi në dhunë dhe terror të ndërsjellë mes Izraelitëve dhe Palestinezëve.

Një tjetër dyndje terroriste ishte viti 1979, kur revolucioni iranian nën udhëheqjen e Ajetollah Homeinit, shënoj “sukses” në rritjen e radikalizmit islamik shiit në rajonin, me një ndikim të drejtpërdrejt në disa organizata dhe vende të rajonit, si Hezbollahu në Liban. Kjo traditë e radikalizmit të situatave politike, vazhdoi edhe me islamistët radikale sunit të Hamasit në Palestinë dhe më vonë të Al-Qaedas në Afganistan. Ndërhyrja ruse në këtë vend u mirëprit nga Shtetet e Bashkuara si mundësi e përsosur për të kundërvënë rusëve për humbjen e shkaktuar në Vietnam, si rezultat i ndihmës ruse për vietnamezët. Amerikanët bënë të njëjtën gjë, ndihmuan afganët sidomos me paisje luftarake, ku përfshiheshin raketat me kokë elektronike “Stringer”, kundër helikopterëve dhe avionëve rus, të cilat bëjnë që rusët të dorëzohen dhe të tërhiqen me humbje nga Afganistani.

Një tjetër rast kthesë negative i cili mund të konsiderohet si pikënisje tjetër e terrorizmit ndërkombtarë është edhe viti 1983, kur në Bejrut ndodhën disa shpërthime të fuqishme vetëvrasëse të cilat i morën jetën 241 marinsave amerikane dhe 53 para-trupave franceze.

Përgjegjesinë për këto shpërthime e mori Hezbollahu, prandaj kjo ngjarje qoj ne tërheqjen e shpejtë të trupave perendimore nga Libani dhe triumfin e plotët të terrorizmit ndërkombtarë në rajon. *Thuhet se me këtë rast më i madh ka qenë dëmi nfa ndikimi psikologjik se sa nga pasojat që kishin shkaktuar eksplozimet.*

Pika e katërt e kthesës së terrorizmit ndërkombtarë është pikërisht 11 shtatori 2011, duke shënuar kështu fazën përfundimtare të paraqitjes së hapur të terrorizmit klasik, në format më eksteme të mundshme. Ky moment ju hapi sytë shumë shteteve dhe politikanëve të tyre si dhe shërbimeve të ndryshme të zbulimit dhe kundërzbulimit, që të punojnë më shumë në organizimin e operacioneve kundër terroriste në mbarë globin. Hapin me serioz në këtë drejtim e mori menjëherë pas akteve të 11 shtatorit, vetë presidenti I Shteteve të Bashkuara, Xhorxh Bush i cili i shpalli luftë terrorizmit dhe shteteve përkrahëse të tij.⁴⁰

Sipas perendimorëve, kjo luftë ishte përgjigje ndaj radikalizmit islamë që po shfaqej në rajon, ndërsa sipas arabëve, kjo ishte luftë për pushtimin e pasurive nëntoksore të shteteve arabe, apo puseve të naftës, si burimet kryesore energjetike prej të cilave varej fati i ekonomisë globale, e në vecanti i ekonomisë më të madhe, Shteteve të Bashkuara.

2.1 Cka i parapriu sulmeve të 11 Shtatorit?

Me vetë faktin se sulmet terroriste të 11 shtatorit u kryen nga organizata Al-Qaeda, e cila edhe zyrtarisht mori përgjegjësinë e kryerjes së këtyre sulmeve, lë të kuptohet se aktet terroriste të 11 shtatorit janë orkestruar si pasojë e mllefrit dhe zemërimit që kanë pas disa organizata islamike ndaj Shteteve të Bashkuara, në përgjithësi për politikën perendimore që ndiqet në lindjen e afërt dhe lindjen e mesme.

Disa politikologe këtë e quajnë luftë kryqezatash, e cila daton që në kohërat e hershme. Disa të tjerë I konsiderojnë si shkak, problemet e akumuluar që nga krijimi i shtetit hebre në lindjen e afërt, por si duket më i arsyeshëm është shkaku ekonomik i cili ka të bëjë me shfrytëzimin e rezervave natyrore të naftës, të cilat janë me bollëk në vendet e Gjirit Persik. Nëse bëjmë një kronologji këtij problemi, shohim se veprimet terroriste të organizatave nga lindja e afërt dhe lindja e mesme që kishin për objektiv shtetet perendimore, filluan që në vitin 1970, kur

⁴⁰ Sulejmanov.Z, Kriminalna Politika, Shkup, 2001.

më 6 shtatorë këtij viti, disa terroriste Palestinez, rrëmbejnë 6 aeroplane të linjave ajrore perendimore, kryesisht me pasagjerë civile nga këto vende. Pastaj rasti tjetër është edhe më i rëndë, kur një komando Palestineze, së bashku me disa shokë të tij, rrëmbejnë mbi 11 sportistë Izraelite në Olimpiadën e Munihut. Ndërkaq më 4 nëntor të vitit 1979 u krye një sulm në ambasadën amerikane në Tehran, ku u morën peng 52 vetë, të cilët u liruan pas shumë bisedimeve, më 20 janar të vitit 1981. Ndërkohë më 6 tetor të vitit 1981 vritet Presidentii Egjiptit El-Sadar, i cili kohë më parë kishte bërë marrëveshje paqësore me Izraelin, gjë të cilën organizatat ekstremiste që kontrolloheshin nga disa qeveri islamike në atë kohë nuk e pëlqenin.

Që situata rreth problemve në lindjen e afërt të eskaloje edhe më shumë, u tregua me përzierjen edhe të Libisë në aktet terroriste të asaj kohë, kur më 21 dhjetor të vitit 1988, një aeroplan udhëtarësh “ Pan-Am”, shpërtheu në ajër mbi qiellin e Lockerbie në Skoci, me c’rast mbetën të vdekur mbi 260 udhëtarë. Ky rast shtoj edhe më shumë zemërimin e perendimit ndaj organizatave terroriste dhe përkrahësve të tyre, të cilët në disa raste ishin edhe krerë të qeverive të disa shteteve arabe.

Si shkak tjetër mund të përmendim edhe zemërimin në rritje të organizatave të ndryshme në botën arabe, të cilat u shprehen me rastin e shpalljes së “ Vargjeve satanike “ të shkrimtarit Selman Ruzhdi, për të cilin Homeini shpalli urdhrin për vrasjen e tij, më 11 shkurt 1989. Kundërvënia përmes akteve terroriste ndaj shteteve perendimore nuk pati të ndalur, kështu që më 26 shkurt të vitit 1993, një bombë shpërthen në World Trade Center, 12 vjet më vonë. Kronologjia e shkaqeve vazhdon kur më 25 shkurt të vitit 1994, një kolon izraelit në qytetin Hebron, masakron 30 Palestinez, duke i vrarë nga prapa shpine, derisa ata po luteshin në një xhami, ndërkohë që më 4 nëntor një ekstremist vret kryeministrin izraelit Isak Rabin, por situata me palestinezët eskalon aq keq sa që, për disa muaj rresht Izraeli përjeton një valë vrasjesh dhe atentatesh vetëvrasëse. Sulmet ndaj Izraelit, zgjerohen me sulme edhe ndaj Shteteve të Bashkuara, të cilat atë kohë po punonin për një plan paqe mes Izraelit dhe Palestinës, por më 25 qershor të vitit 1995, shpërthen një kamion me triol pranë një grumbulli ushtarësh amerikanë në Dahar të Arabisë Saudite, ku vdesin 19 ushtarë amerikane dhe shumë të tjerë mbesin të plagosur rëndë e lehtë. Organizatatat terroriste nga bota arabe arritën të profesionohen në këtë fushë, ashtu që e zgjerojnë veprimtarinë e tyre gati në të gjitha vendet ku ka amerikanë, duke shprehur haptas se armiku i përbashkët i tyre është Izraeli, Amerika dhe disa vende perendimore. Këto grupe nuk

zgjedhin mjete dhe metoda, por caku i tyre bëhet cdo gjë perendimore që ka vlerë dhe që mund të atakohet. Në gusht të vitit 1998 bëhen një seri sulmesh terroriste në Najrobi të Kenias dhe Dar el-Salam të Tanzanisë, ku cak i këtyre sulmeve ishin ambasadat amerikane në këto vende, me c'rast pësuan 210 njerëz, prej të cilëve 11 amerikane, punëtorë të ambasadave. Dhe rasti më i fundit dhe më i paparashikuar, ishte më 11 shtator të vitit 2001, kur një grup ekstemitësh islamike, të trajnuar mirë, rrembyen disa avione amerikanë të linjave të mbrendshme amerikane dhe i përplasen ata në Kullat Binjake të Nju Jorkut dhe në ndërtesën e Pentagonit në Washington, ku humbën jetën mbi 3000 njerës dhe mijëra të tjerë të plagosur. Ky ishte sulmi më i tmerrshëm që kishte parë ndonjëherë njeriu i kohës moderne, por që zgjoi nga gjumi shumë shtete dhe qeveri, të cilat i shpallën menjëherë luftë terrorizmit islamik, luftë e cila po zgjati deri në ditët e sotme.⁴¹



⁴¹ Muslimbruderschat, Instituti i Shkencave Islame, Universiteti i Berlinit. 2004

2.2 Sulmet terroriste të 11 shtatorit

Terroristët sulmuan Shtetet e Bashkuara më 11 shtator të vitit 2001 dhe në njëjtën kohë ata i shpallën luftë SHBA-së dhe tërë botës demokratike.⁴² Shumë kohë përpara 11 shtatorit 2001, shtëpia e bardhë me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, debatonte mbi mundësinë e ndërmarrjes së një ofensive për të luftuar Al-Qaeda, për të cilën CIA kishte informacione të mjaftueshme. Madje stafi presidencial kishte edhe një plan si ta bënte këtë! Por në kohën kur u morën vendimet ishte tepër vonë sepse Al-Qaeda veproj një hap më përpara.

Amerika dhe pothuajse e gjithë bota u tronditën nga sulmet terroriste të 11 Shtatorit të vitit 2001, në Nju Jork, në Uashington dhe në Pensilvani. Mëngjesin e asaj dite të zezë të vitit 2001, terroristët islamike të Al-Qaedas rrëmbyen katër aeroplane pasagjerësh. Dy aeroplane goditën kullat binjake të “World Trade Center“ në Nju York. Një aeroplan tjetër u perplas në godinën e Pentagonit afër Uashingtonit dhe aeroplani i katërt, pasagjerët e të cilit u kacafytën me terroristët, e që besohet se kishte për objektiv Shtëpinë e Bardhë, u përplas në një fushë në Shansksvill të shtetit Pensilvania.

Sulmi terrorist i 11 shtatorit ishte më i rëndë në historinë e Amerikës duke shkaktuar pothuajse tre mijë viktima të pafajshëm nga Shtetet e Bashkuara dhe nga shumë vende të tjera të botës, përfshirë edhe tre shqiptarë. Dëshmitarët e kësaj tragjedie të paparë, thonë se këto sulme ishin shokuese dhe ishin sulmet më shkatëruese që kishte parë njeriu gjatë historisë së vet, që prej ekzistimit të tij. I tërë qyteti i Nju Jorkut por edhe tërë Amerika ishin në konfuzion të plotë dhe nuk dinin çfarë po ndodhë. Vetëm shërbimet e inteligjencës, administrata dhe qeveria e dinte se kishin të bënin me akte terroriste të Al-Qaedas. Menjëherë kur sulmet ishin proces , nga Florida në ora 9:30, populli iu drejtua Xhorxh Bush, i cili tha se vendi ishte sulmuar nga terroristët. Ndërsa në mbrëmje, presidenti Xhorxh Bush i drejtohet vendit me një fjalim edhe me të gjërë mes të cilave po citoj: *“Ne po hetojmë se kush fshihet pas këtyre akteve mizore. I kam urdhëruar të gjitha organet e rendit që të gjejnë personat përgjegjës. Ne nuk do të bëjmë dallim midis terroristëve që kryen këto akte dhe atyre që i strehojnë ata “.*

⁴² Hezbollah: The Changing Face of Terrorism Paperback – October 7, 2005

Përkundër përpjekjeve parandaluese dhe atyre për shpëtim, dy ndërtesat binjake të Qendrës Botërore të Tregtisë u shembën dhe në ora 10:28 kur u shemb ndërtesa e dytë, Nju Jorkrun e kishte përfshirë një re e madhe pluhuri, pas së cilës kullat binjake nuk dukeshin më. Ato u asgjësuan “ sa që e mbyll sytë “. Në fillim drejtuesit e pushtetit mendonin se kishte mbi 10 mijë persona të vrarë, por pastaj u kuptuan se ishin 2752 njerës nga kullat, 343 zjarfikës, 60 policë dhe 260 njerës që ndodheshin në aeroplanët që u përplasën mbi ndërtesa. Sipas ekspertëve të terrorizmit, këto sulme ishin më shkatëruese se të gjitha sulmet terroriste që kishin ndodhur deri në atë kohë.



Pas sulmit të ndërtesave në Nju York, u mor vesh se ishte sulmuar edhe Pentagoni në ora 9:40 minuta, kur një aeroplan Boeing 757 ishte përplasur mbi ndërtesën e Shtabit Qendror të Ushtrisë Amerikane. Nga kjo ndërtesë komandohet Ushtria Amerikane. Ndërkohë mësohet se një avion tjetër Boeing 757 i cili po shkonte në drejtim të San Franciskos, ishte rrëzuar në Pensilvania. Qëllimi i këtij aeroplani ishte të sulmonte Shtëpinë e Bardhë në Uashington, por si duket urdhëtarët kishin bërë luftë me terroristët brenda avionit dhe qëllimi i terroristëve nuk ishte realizuar. Për këtë rast Xhorxh Bush do të deklarohet më vonë se: *“Pasagjerët e këtij aeroplani kishin filluar betejën e parë kundër terrorizmit, ndërsa ne do ta përfundojmë këtë betejë duke i thyer ata”*.

Më vonë, rreth orës 10:25 minuta afër ndërtesës së Stejt Departamentit në Uashington, ka shpërthyer një auto-bombë, ndërsa në ora 17:20 minuta edhe një ndërtesë 47 katëshe e dëmtuar nga rrëzimi kullave në Nju York, shembet vetë dhe kështu përfundon dita më e rëndë që kishte përjetuar Amerika nga terrorizmi që prej ekzistimit të saj. Duhet të përmendim se gjatë këtyre sulmeve kishte edhe rreth 2100 të plagosur e të djegur rëndë, si dhe mbi 600 të plagosur më lehtë. Kishte edhe me mijëra të evakuuar.

Kullat binjake pak sekonda para shkatërimit-foto



Pas mbarimit të kësaj tragjedie, ky ishte top lajmi nëpër të gjitha stacionet informative në botë. Në tërë botën arabe ishte dite feste. Palestinezët kishin dalë nëpër rrugë dhe po festonin ngjarjen. Fronti për Clirimin e Palestinës, thoshte se ka marrë përgjegjësinë për këto akte, mirëpo festime të tilla po bëheshin edhe në Kabul të Afganistanit, kështu që tani për administratën amerikane nuk kishte më gjurmë.

2.3 Si u veprua pas sulmeve të 11 Shtatorit

Menjëhëre pas kryerjes së aksioneve terroriste, administrata amerikane dhe shërbimet e saj të fshehta i filluan punës. Ata filluan një varg masash të rrepta të sigurisë, të cilat edhe pse ishin të vonuara, ishin më së të domosdoshme për parandalimin e sulmeve tjera eventuale që mund të ishin plani B ose plani C i terroristëve.

Ndër masat e para të sigurisë që u ndërmorën janë këto :

- ✚ Evakuimi i të gjitha ndërtesave qeveritare, përfshirë Shtëpinë e Bardhe, Kongresin Amerikan dhe të gjitha ndërtesat në afërsi të kullave binjake dhe shumicën në Manhatan.
- ✚ Suspendimi i të gjitha fluturimeve komerciale për SHBA-në dhe prej Shteteve të Bashkuara.
- ✚ Vendosja e Gardës Nacionale në Manhatan dhe afrimi i anijeve luftarake në afërsi të Nju Jorkut.
- ✚ Dhënia e urdhërit për forcat ajrore që të rrëzojnë cdo avion të dyshimte mbi SHBA-të.

Edhe pse njëra brinje e ndërtesës së Pentagonit ishte rrafshuar për toke, Sekretari i Mbrojtjes së Shteteve të Bashkuara, Donald Ramsfeld kishte thënë atë natë në televizion se: *“Pentagoni funksionon pandërprerë dhe nesër jemi në punë”*.⁴³ Atë natë por edhe të nesërmen gati të gjitha shtetet e botës dhe qeveritë e tyre shprehen keqardhjen e tyre për ngjarjet e tilla, por vetëm në disa shtete të lindjes së afërt dhe të mesme u bë e kundërta, u festua në përkrahje të këtyre veprimeve.

2.4 Masat dhe hetimet e ndërmarra pas sulmeve

2.4.1 Masat e ndërmarra

Dita e 11 shtatorit 2001, është “dita kur ndryshoj gjithcka“, jo vetëm në pikëpamjet e qeverive për terrorizmin, por edhe në qëndrimin e popullit amerikan karshi këtyre zhvillimeve. Përvec masave që Qeveria Amerikane filloj ti ndërmarrë, kësaj iu bashkua edhe pjesa e tjetër e komunitetit ndërkombtarë dhe qeveria demokratike, duke ndërmarrë një varg veprimesh konkrete me qëllim të ndricimit të sulmeve terroriste, parandalimit të sulmeve të reja si dhe zënien, arrestimin dhe ndëshkimin e organizatorëve të këtyre sulmeve.

⁴³ Haki Demolli, “Terrorizmi“, Prishtine, September 2001, fq 201


Veprimi i parë që ndërmori qeveria amerikane ishte pastrimi i gërmadhave, zbulimi i të mbijetuarve dhe identifikimi i kufomave. Ndërkohë organet tjera të shtetit filluan hetimet e thella për ndricimin e rasteve në vecanti. Ndërkohë që paralelisht me masat emergjencës është zhvilluar edhe procesi i evakuimit të personave të lënduar, të mbijetuarve, shpëtimi i atyre që gjendeshin nën gërmadha, etj., edhe pse kjo punë ishte jashtëzakonisht e rëndë dhe e dhimbshme. Thuhet se përkundër përpjekjeve të shumta dhe personave të gjallë nga krejt gërmadhat e QBT-së dhe Pentagonit. Gjatë pastrimit të gërmadhave vetëm për dy javë janë bartë mbi 116.000 tonë mbeturina, ndërsa sipas ekspertëve të ndërtimtarisë sasia e strukturës origjinale të QBT-së, ka pasur afër 1.25 milion tonë materiale ndërtimore të llojeve të ndryshme. Për bartjen e kësaj sasive të materialit të rrënuar u shpenzuan rreth 200 milion dollare.

2.4.2 Hetimet e zhvilluara

Menjëherë pas sulmeve , shërbimet e inteligjencës amerikane kaluan në kundëroffensive. FBI (Federal bureau of investigation), filloj hetimet dhe ndjekjen më të madhe në historinë e SHBA-ve dhe të njerëzimit në përgjithësi. Në hetime u përfshinë me mijëra agjente dhe puntore tjerë përkrahës të FBI-së. Vetëm në tri ditët e para pas sulmit, FBI-ja arriti të sigurojë emrat e 19 aeroplanëve për të cilët besohej se kishin rrëmbyer aeroplanët që kryen sulmet. Menjëherë u kuptua se 4 terroriste kishin hyre në SHBA e dokumente false dhe 15 terroristët tjerë ishin shtetas të Arabisë Saudite dhe kishin dokumentet e këtij shteti.

Kështu do të duket qendra botërore e tregtisë, pas përfundimit të punimeve që janë bërë proces.

Foto.



Lidhur me teknikat e përdorura për zbulimin e akteve të tilla, një zyrtar amerikan tha se:“ do të përdorim të gjitha teknikat e ligjshme hetuese që disponon FBI-ja“, përfshirë këtu edhe teknikat satelitore për navigim të tërë hapsirës ku mendohej se fshiheshin organizatorët e këtyre

akteve terroriste. Agjencia Amerikane për Siguri Nacionale (NSA), është e njohur për shfrytëzimin të teknologjisë më të lartë; për përgjimin e telefonave, e-mail, faksit, të shifrave të koduara, të leximit të tabelave të makinave nga sateliti dhe skanimin me satelit të figurës së personave të dyshimtë. Janë gjetur edhe gjurmë që tregonin lidhjen në mes të Mohammed Atta dhe Bin Ladenit, dëshmi e së cilës ishte xhirollogaria bankare e cila dëshmonte një transfer të madhe parash të datës 8 dhe 9 shtator 2001.⁴⁴ Kjo gjurmë ishte vërtetimi i parë i lidhjes së Al-Qaedas me rrëmbyesit e avionëve.

Dëshmi tjetër ishte edhe deklarata e Bin Ladenit se kishte njohuri për sulmet dhe se sulmet e 11 shtatorit i kishin kaluar parashikimet e tij, pasi që kam ditur për një aksion martirizmi që do të ndodhte, por nuk kam ditur se kur do të zhvillohet operacioni.

Një kontribut të madhë në hetimin e rasteve kanë dhënë edhe kutitë e zeza të avionëve që ranë në Pensilvani dhe Pentagon, për shkak se kutitë nga BBT ishin zhdukur, sepse ato nuk mund ti përballojnë temperaturave të larta më tepër se 30 minuta. Kutia e zezë është e ndërtuar nga materiali i Titaniumit dhe janë të izoluar jashtëzakonisht mirë. Ato vërtetuan se 30 persona tjerë ndihmonin nga toka sulmet që po kryenin rrëmbyesit. Njëri prej terroristëve më të rrezikshëm që sulmoj Pentagonin ishte Khalid al-Madhar, identitetin e të cilit e vërtetoj kutia e zezë. Disa hetime kanë treguar se Osama Bin Laden nuk kishte pasur dijeni për sulmet, por sipas tij *“Sulmi ishte ndëshkim i Allahut për Shtetet e Bashkuara”*.

2.4.3. Bashkëpunimi ndërkombtarë kundër terrorizmit.

11 Shtatori i ndryshoj rrënjësisht rrjedhat politike dhe ekonomike si në Amerikë ashtu edhe në mbarë botën. Kjo ngjarje i tregoj botës se duhen tejkaluar kufijtë kombëtarë dhe të luftohet në nivelin global për sigurinë e përgjithshme nga aktet e tilla terroriste. Prandaj filluan bisedimet për krijimin e një halke zingjirore të bashkëpunimit ndërkombtare në luftën kundër terrorizmit.⁴⁵

Pakti I NATO-s kishte reaguar menjëherë në përkrahje të SHBA-ve dhe kishte treguar se është e gatshme për çfardo sfide në këtë drejtim. Atë botë Xhorxhe Tenet, drejtor i CIA-s, kishte firmuar shumë vende aleate për të krijuar një shërbim inteligjent të përbashkët. Shumë shtete iu

⁴⁴ The History of Terrorism from Antiquity to Al-Qaeda, Gerard Chaliand and Arnaud Blin. Fq 60

⁴⁵ Kolë Krasniqi – Terrorizmi Ndërkombëtar, botimi i dytë, Prishtinë 2010, fq 358

bashkuan SHBA-së në këtë luftë, por kishte shtete që deklarativisht e përkrahinin Amerikën, por praktikisht nuk guxonin ta bënin këtë gjë nga frika e hakmarrjes prej organizatave të mundshme terroriste. Edhe Rusia që është mike e disa vendeve terroriste dhe jodemokratike, kishte vendosur të bashkëpunojë me NATO-n, në luftë kundër terrorizmit. Edhe Bashkimi Evropian, në dhjetor të vitit 2001 ndërmerr një “ pako antiterroriste :, duke përpiluar listën e terroristëve më të kërkuar, dhe krijon një fond për të ndihmuar luftën kundër kësaj të keqe. Ndërkohë miratohet një marrëveshje që ju mohon strehimin e organizatave dhe grupeve të terrorizmit në vendet e Bashkimit Evropian. BE-ja kishte ratifikuar edhe një marrëveshje policore të përbashkët e cila mundëson ndërkëmbjen dhe arrestimin e çfarëdo terroristi që përpiqet të kalojë nga njëri shtet në tjetrin brenda BE-së. Por BE-ja kishte aprovuar një udhëzim sipas të cilit çdo terrorist që kryen krim do të dënohet jo më pak se 20 vjet burg.

Në anën tjetër, shërbimi i fshehtë Izraelit, kishte zbuluar se: organizatorët e ngjarjeve të 11 shtatorit, me siguri ishin financuar dhe përkrahur nga Iraku dhe qeveria e Sadam Hysein-it. Kjo ishte e mjaftueshme për presidentin amerikan Xhorxh Bush, që të hartojë planin për të sulmuar Afganistanin e më vonë edhe Irakun.

2.4.4. Masat për forcimin e sigurisë globale.

Menjëherë pas sulmeve të 11 shtatorit, Presidenti Amerikan Xhorxh Bush deklaroi “Luftën kundër Terrorizmit”, e cila kishte për qëllim final sjelljen e Osama Bin Ladenit para drejtësisë dhe shkatërimin e të gjitha organizatave terroriste anekënd botës, në mënyrë që në të ardhmen, bota të mos ketë pasiguri dhe akte të tilla. Shumë shtete demokratike e konsideronin veten të fyer nga veprimet e tilla terroriste, bile Kancelari i atëhershëm Gjerman, Gerhard Schroder i përshkruajti sulmet si:“ shpallje e luftës ndaj botës së qytetëruar nga elemente të pacivilizuara“.⁴⁶ Edhe Këshilli i Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, vetëm 24 orë pas sulmeve, përmes rezolutës 1368 i dënoj ashpër sulmet dhe u shpreh I gatshëm të ndërmarrë të gjitha masat për të luftuar terrorizmin, kudo që ai paraqitet. Ndërsa në tetor të vitit 2001 Shtetet e Bashkuara së bashku me Britaninë e Madhe dhe disa aleatë të NATO-s pushtuan Afganistanin në luftën që zyrtarisht u quajt “Lufta Globale kundër Terrorizmit“.

⁴⁶ Donald Rumsfeld, “ A New Kind of War “, New York, September 27, 2001 fq 88

Në një fazë tjetër të mëvonshme, në vitin tjetër 2002 Shteti i Bashkuara po bënin përpjekje për të bindur Këshillin e Sigurimit se Iraku, posedonte armë të shkatërrimit masiv dhe po persekutonte popullin e tij, sidomos Kurdët në veriperendim të vendit. Por pasi që Këshilli i Sigurimit krijonte “veto“ ndaj cdo propozimi të SHBA-se, kjo e fundit ndërhyri përsëri pa leje të Këshillit të Sigurimit dhe me ndihmën e disa aleatëve për të rrezuar Sadam Husein-in nga pushteti dhe për të liruar popullin Irakian nga ky diktator. Si duket ky vendim i njëanshëm i kushtoj Shteteve të Bashkuara, ku sic do të shohim më vonë ky veprim u kundërshtua nga disa aleatë perendimorë të SHBA-së, si: Franca, Gjermania, Belgjika dhe vendet tjera si Rusia dhe Kina, të cilat si kundërmasë filluan bashkëpunimin ekonomik me vendet e Azi-Paqësorit dhe konkretisht me Kinën e cila për shkak të këtij bashkëpunimi mori hov në zhvillimin ekonomik, ndërsa bashkëpunimi me SHBA-në u zvogëlua në intensitet. Kjo bëri që ekonomia amerikane të shkoj drejt një recesioni, sa për shkak të ngecjes ekonomike po aq edhe për shkak të shpenzimeve të mëdha dhe kolosale që po bënte ushtria amerikane gjatë angazhimeve në luftën e rajonit të Lindjes së Mesme. Shpenzimet ushtarake po arrinin vlerën e triliarda dollarë amerikanë, gjë të cilën ekonomia amerikane nuk po e përballonte dot. Si do të shohim, kjo më vonë do të sjell edhe krizën e madhe ekonomike që “e lodhe amerikën“. Ndërsa presidenti i ri Barak Obama do të tërheqë trupat nga Iraku dhe do ti pakësoj ato në Afganistan. Por objektivat e Shteteve të Bashkuara në përgjithësi ishin realizuar.

Shumë vende që janë përballur me sulmet terroriste, janë munduar që të mos i qajnë shumë pasojat nga sulmet e kryera por kanë ndërmarrë masat e duhura për t’iu kundërvënë organizatave që kanë kryer aktet e tilla, si dhe kanë bërë përpjekje tjera në drejtim të përforcimit të sigurisë së popullit të vet, shtetit dhe interesave të tij. Një ndër këto masa është edhe sigurimi i aeroporteve me anë të kamerave, skenareve, nihatjen e agjenteve biologjike dhe formave më bashkohore të identifikimit të personave përmes gishtrinjeve dhe skanimit të syve (iridës së syrit). Përvec kësaj SHBA-të kanë paraparë që cdo aeroplan i cili fluturon do të ketë edhe personelin e sigurisë të pajisur me armatimet e duhura. Megjithatë këto masa nuk janë zgjidhje e problemit, nëse nuk gjendet ndonjë zgjidhje tjetër për problemin e terrorizmit ndërkombtarë. Kjo gjendje e përditshme e frikës ndaj terroristëve “ e lëndon jetën e qytetarëve “, sepse i bën njerëzit shumë të varur nga sistemet e sigurisë, të mjerë të friksuar dhe të pa sigurt.⁴⁷

⁴⁷ The Roots of Islamic Radicalism, by Philippe Migaux, fq 124

Mendojmë se një zgjidhje politike paqësore e problemeve ndërkombtare do të ishte më e mirë se një formë e tillë e jetesës. Prandaj kërkohet që njerëzit kompetentë të gjejnë mënyrën e eliminimit të shkaqeve që po sjellin sulme të tilla terroriste.

2.5. Shkaqet e sulmeve bashkëkohore terroriste

Cdo terroristë apo organizatë terroriste ka nevojë që të arsyetojë dhe justifikojë në popull, veprimet e tij terroriste dhe përdorimin e taktikave terroriste si kundër edhe për viktimat që janë pasojë e këtyre akteve terroriste. Nga pikëpamja e tyre, terroristët nuk e konsiderojnë veten “njerëz të cmendur apo psikopatë“, por përkundrazi veprimet e tyre i konsiderojnë të nevojshme për arritjen e qëllimeve të tyre, si dhe kërkojnë që edhe bota të arsyetojë veprimet e tyre terroriste, duke i konsideruar aktet e tyre si revansh ndaj sjelljeve të pushteteve, politikave dhe ideologjive.

Natyrisht, që vala e re e terrorizmit modern i cili i filloj në gjysmën e dytë të shekullit të kaluar, i ka edhe rrënjët e veta në disa specifika politike, ekonomike dhe sociale të rajoneve të ndryshme. Për shembull vala kryesore terroriste nis në lindjen e mesme, pikërisht lidhur me konfliktin arabo-izraelit. Disa nga aktet më të dhunshme terroriste në botë janë kryer në emër të këtij konflikti ekzistues.

Pikërisht, krijimi i shtetit izraelit në vitin 1948, ishte një “mollë sherri“ për botën arabe dhe shkak i lindjes së një terrorizmi me përmasa globale. Ishin autoritetet britanike të cilat i premtuan hebrenjëve se do të formonin një shtet Izraelit në tokën Palestineze dhe kjo ndodhi. Arabët refuzuan këtë plan edhe pse shteti izraelit u njoh nga disa vende të botës, arabët u përpoqën disa herë të asgjësojnë këtë shtet, bile edhe me mjete ushtarake por nuk i arritën, prandaj Palestinezëve nuk ju mbeti asgjë tjetër, vetëm se të kërkojnë rrugë tjera për të luftuar Izraelin dhe kjo ishte përmes akteve terroriste, si e vetmja zgjidhje.⁴⁸ Sidoqoftë si kundër përgjigje, Palestinezët në vitin 1964 formuan një organizatë të cilën e quajtën “*Organizata për çlirimin e Palestinës*“ (OCP), nën udhëheqjen e Jaser Arafatit. Misioni i kësaj organizate ishte zhdukja e shtetit izraelit dhe krijimi aty i një shteti të pavarur Palestinez.

Terrori u shkallëzua në nivel rajonal dhe global, kur prej 5 deri me 10 qeshor të vitit 1967 Izraeli hyri në luftën me të gjitha shtetet arabe fqinje, luftë e cila zgjati 6 ditë dhe njihet si “Six

⁴⁸ Donald Rumsfeld, “A New Kind of War“, New York, September 27, 2001, fq 126

Day War“ apo “*Lufta gjashtë ditore*“ të cilën Izraeli e fitoj, duke shkatëruar forcat egjiptiane, jordaneze, siriane dhe zgjerorj edhe më shumë sipërfaqen e tokave të pushtuara arabe.

Sipas disa autorëve , njëri prej shkaqeve kryesore të sulmeve bashkëkohore terroriste, është edhe pozita dhe roli udhëheqës i SHBA-së në botë. Sipas tyre, gjatë dekadave të fundit, një numër shumë i madhe i sulmeve terroriste, është i drejtuar kundër interesave të SHBA-së. Këto sulme “argumentohen“ me faktin se SHBA-të kanë rol dominues në konfliktin Arabo-Izraelit dhe po ndihmojnë Izraelin të mbajë të pushtuar Palestinën. Përveç këtyre shkaqeve, disa terroristë bashkëkohore sulmojnë interesat e ndryshme perendimore edhe nga frustrimet e krijuara si për rolin gjithënjë e më të fuqishëm dhe udhëheqës të SHBA-së në botë, ashtu edhe për bindjet e krijuara se popujt e tyre të privuar nga përfitimet që sjell rendi i ri botëror dhe globalizmi, si dhe nga eksploatimi enorm i pasurive energjetike të rajonit.⁴⁹

2.6. SHBA-të dhe lufta kundër terrorizmit.

Pse po e shkruajmë një kapitull special për luftën e Shteteve të Bashkuara të Amerikës kundër terrorizmit? Duke ditur se shumë shtete evropiane, si Franca, Britania e Madhe, etj, janë konfrontuar qysh më herët me akte terroriste si dhe kërcënimi nga terrorizmi ka qenë edhe më konstant. Mirëpo qysh prej datës 11 shtator të vitit 2001, Shtetet e Bashkuara, kanë qenë epiqendra e aksioneve terroriste dhe e veprimeve kundër terroriste në tërë botën.

Ushtarët amerikan në Irak, gjeten Sadam Husein-in të struktur në një vrim, e arrestuan atë dhe e nxorën para gjyqit. Ai u dënua me vdekje dhe u var. Më vonë u zbulua edhe vendstrehimi i krye-terroristit më të kërkuar në botë Osama Bin Laden, i cili i u vra në aksion e sipër dhe më pastaj trupi i tij u hodh në det. Në këtë mënyrë Shtetet e Bashkuara po kthenin krenarinë e humbur gjatë sulmeve të 11 shtatorit, kështu që apeli për luftë të shenjtë kundër perendimit filloj të vënitej në mesin e organizatave terroriste, të cilave nuk ju kishte mbetur kund vend për të futur kokën. Por, fitorja në të ashtuquajturën “ luftë kundër terrorizmit “ mbetet disi e turbullt. Zinxhiri i ngjarjeve që pësuan tragjedinë, është larg fundit të kënaqshëm të zgjidhjes së problemeve.

Në nëntor të vitit 2001, Shtetet e Bashkuara me sulme të furishme, larguan lëvizjen talibane nga pushteti në Afganistan, por ajo duhet të jetë ringjallur përsëri. Qeveria e presidentit Hamid Karzai–e formuar me ndihmën amerikane në fillim të vitit 2002–sot ka filluar bisedimet

⁴⁹ Kolë Krasniqi, “Terrorizmi Ndërkombëtar “ Botimi i dytë, Prishtinë 2010, fq 294

për ndarjen e pushtetit me guerilet e Mullah Omarit, një udhëheqës Taleban në Afganistan. Dikur në Irak, ndërhyrja e Shteteve të Bashkuara rrëzoi Huseinin, por atje një luftë civile që po kërcënon përcarjen e vendit është duke u zhvilluar akoma. Pra, qeveria e qëndrueshme dhe sigura për të gjithë qytetarët e vendit, mbeten ende objektiva të largëta për popullin irakian.

Sot shumë amerikanë janë të mendimit se qeveria e tyre ka shpërqëndruar vëmendjen e saj nga problemet e brendshme dhe prioritet që ka vendi në aspektin ekonomik dhe po harxhon para në këtë luftë të pafund kundër terrorizmit. Pikërisht sterzgjatja e luftës kundër terrorizmit dhe kostoja e lartë, do të sjellë më vonë Shtetet e Bashkuara në krizën më të madhe ekonomike që kishte njohur ky vend ndonjëherë. Disa ekspert thonë se në vitet pas 11 shtatorit, ka parë rënie të ndikimit global të Shteteve të Bashkuara në botë dhe rritje të ndikimit të shteteve tjera. Të tjerët vënë në dukje se SHBA-të mburren si ekonomia më e madhe në botë, edhe pas krizës financiare të 2008-es. Sipas disa të dhënave vetëm gjatë dekadës së fundit, qeveria e Shteteve të Bashkuara ka shpenzuar rreth 7 trilionë dollarë për mbrojtjen kombëtare, sigurinë e vendit dhe shërbimet e inteligjencës së vetë.

2.6.1. Organizatat terroriste

Për fat të keq sot në botë ekzistojnë dhe veprojnë shumë organizata terroriste, por disa më të njohura sipas CIA-së, janë këto: *Abu Nidal (babai i luftës) Al Qaeda (baza), Hezbollah (partia e Allahut), Mujahedine Khalaq, Hamasi (entuziazmi), Japonese Red Army, Al-Jiahd (lufta), etj.*



2.6.2. Terroristët më të kërkuar në botë

Hartimi i një liste për të përcaktuar se cilët janë terroristët më të kërkuar apo më të rrezikshëm në planetin tonë, është përcjellë me polemika dhe debate të pafund. Për shumë Izraelitë, udhëheqësi i organizatës Hezbollah Hasan Nasrallah, është terroristi më i kërkuar në botë. Për njerëzit që jetojnë në Filipine, njeriu më i kërkuar është Abu Sajaf. Për Rusët më i kërkuar është udhëheqësi islamik Cecen Dou Umarov. Për Shtetet e Bashkuara, pas vrasjes së Osama Bin Ladenit, njeriu më i kërkuar në botë mbetet Ayman al Zawahiri dhe Saif al Adel, që të dy udhëheqës të lartë të Al-Qaedas.

Sidoqoftë ne po japim në vazhdim një listë të emrave të përcjellë me fotografitë e njerëzve, që nga shërbimi I intelligence amerikane dhe FBI-ja, konsiderohen, si terroristët më të kërkuar në botë.⁵⁰



Ayman al Zawahiri është kreu i al Kaedas. Nga SHBA është ofruar një shpërblim prej 25.000.000\$ për info, që tregon koordinatat e tij.



Nasir al Wuhaysh, lider i Al Kaedas, në ishullin e Arabisë Saudite e njohur si AQAP. Për të zënë këtë, ofrohen 20.000.000\$



Ibrahim al Asiri, i njohur si shefi i bombave apo eksperti i ndërtimit dhe i kurdisjes së bombave në AQAP. Oferta është 5 milion dollarë.



Moktar Belmoktar, është një figure e njohur ushëheqës e Al-Qaedas në Maghreb. SHBA-të kanë ofruar 5 milion dollarë.



Doku Umarov, është udhëheqës i Emirateve të Bashkuara Kaukaziane. Për të ofrohen 5 milion dollarë nga SHBA dhe shumë më tepër nga Rusia.



Saif al Adel, udhëheqës i Xhihadit Islamik në Egjipt dhe anëtar i organizatave Al-Qaeda. Për kapjen e tij, SHBA ofron 25 milion dollarë amerikane.

Pra, më herët u bë e qartë se rëndtija në listë e terroristëve bëhet për nga rrezikshmëria dhe dëmtimet gjatë akteve terroriste që janë kryer, por duhet theksuar se numri i terroristëve është më i madhë si dhe rrezikshmëria e tyre është çështje për tu diskutuar nga shërbimet që janë

⁵⁰ Raufur X, Quere, La Crime Organise, Paris, Janar 2000, fq 202

kompetentë. Ka edhe terroristë që emri i tyre nuk dihet, apo të tillë që kanë emra të rrejshëm dhe që ndërrojnë identitetin në intervale të caktuara kohore.

Padyshim se për shumë kohë të gjatë kryeterroristi më i kërkuar në botë ishte Osama Bin Laden, i cili i asgjësua pas një operacioni mjaft të suksesshëm dhe të paparë deri më tani në luftën kundër terrorizmit.

2.6.3. Armatimi i terroristëve

Terroristët kanë nevoje për armatime të ndryshme për të kryer veprimet e tyre apo aksionet e tyre. Ata i marrin armët nga vendet të cilat nuk qëndrojnë mirë politikisht me vendin që synojnë të godasin. Armët e përdorura zakonisht janë bomba, eksplozive shpërthyesë dhe armatim tjetër ndihmës. Zakonisht ky armatim blihet me para të pista, nga shitja e drogës dhe krimet të organizuar apo edhe nga donacionet që marrin nga familje të pasura (sidomos me para nga nafta dhe gazi) që duan të godasin shtetet për shkak të bindjes të ndryshme. Ka edhe shtete që japin para dhe ndihmojnë organizatat terroriste për ti shkaktuar sa më shumë dëme shteteve me të cilat janë në konflikt permanentë.

Në kuadër të paisjeve eksplozive që përdorin terroristët hyjnë: bombat e fabrikuara, paisjet e improvizuara eksplozive, minat për rrugë dhe ura, bombat molotov, bombat cilindrike dhe bombat barometrike, që eksplodojnë kur në avion arrihet shtypja e komanduar nga toka. Ndërsa në kuadër të armëve të zjarrit që përdorin terroristët, janë: revolet, kallashnikovët AK-47, granatat raketore me reaksion RPG-7, minahedhësit SA-7 dhe raketat stringër që përdoren kundër helikopterëve etj.

2.7. Lufta kundër terrorizmit pas 11 shtatorit 2001

Sulmet terroriste të 11 shtatorit 2001 çuan deri në ndryshimin e politikave botërore dhe i hapën sytë njerëzimit për një luftë të re sapo kishte kanosur globin. Terrorizmi i 11 shtatorit transformoi politikën botërore dhe konfirmoi se bota s'do të jetë më e njëjtë si pasojë e rritjes së terrorizmit, që sipas disa analistëve është i frymëzuar nga feja. Ajo që bëri 11 shtatorin një moment vendimtar e simbolik, është se ai mishëroi një forcë të re të terrorizmit duke qenë se rritja e tij është e lidhur me globalizmin e politikave botërore.⁵¹

⁵¹ Qendra Izraelite për Studime Antiteroriste, <http://www.ict.org.il>

Ngjarjet tragjike të 11 shtatorit 2001 në Nju Jork dhe në Uashington hapën nismën e sfidës terroriste. Mund të thuhet se nga ajo kohë nuk ka më vend të sigurt në botë dhe se dukuria e terrorizmit ka prishur çdo vatër qetësie e sigurisë në glob dhe strukturat e sigurisë kombëtare apo ndërkombëtare, do të duhej të angazhoheshin seriozisht përballë një armiku tinëzar, të rrezikshëm dhe shumë të sofistikuar. Analiza e ngjarjeve të 11 shtatorit 2001 dhe veprimtarisë së shumë organizatave terroriste nxjerr në pah implikimin edhe të shteteve apo regjimeve diktatoriale në përkrahjen ndaj tyre. Ka shtete të Lindjes së Mesme, në mënyrë të vecantë Irani, Siria, Jemeni, Libia, Sudani, etj, që jo vetëm kanë lejuar instalimin e këtyre organizatave në territorin e tyre, por edhe i kanë financuar ato, sikundër që edhe kanë pas përfitime prej tyre. Nga ana tjetër, këto shtete po ngrënë struktura terroriste për destabilitet permanent me fqinjët e tyre, sidomos në Irak dhe në Liban.

Në Lindjen e Mesme egzistojnë shumë organizata terroriste, të cilat cuan në prodhimin e terrorizmit ndërkombtarë, si një prej sfidave më të mëdha të sigurisë globale. Kriza e 11 shtatorit 2001 që ndodhi në SHBA, shpalosi për herë të parë ndërkombtarisht terrorizmin ndërkombtarë si elementi më kërcënues për demokracitë dhe “rendin e ri botëror“ që synon më shumë paqe, siguri, drejtësi dhe prosperitet ekonomik për të gjithë.

Ngjarja e 11 shtatorit 2001 në Nju York, demonstroi saktësisht parashikimet e disa liderëve të demokracive perendimore se në kohët tona ekzistojnë mjaft kërcënime që kanë për synim goditjen e vlerave dhe arritjen e demokracive perendimore. Ngjarja e 11 shtatorit 2001, tregoi se nuk ka zonë të sigurt në botë dhe se askush nuk mund të jetë imun nga rreziqet që mund të vijnë prej faktorëve të ndryshëm dhe se terrorizmi dhe krimi i organizuar janë shndërruar në kërcënim real për paqen, sigurinë, demokracinë dhe prosperitetin e vendeve dhe popujve në mbarë botën. Shumë eksperte politike dhe ushtarake, mendojnë se prania dhe kontributi i SHBA-ve në rajonin e Lindjes së Mesme është një domosdoshmëri historike për rajonin. Pikërisht tërheqja e amerikanëve nga Iraku, vite më parë dhe dorëzimi i sigurisë dhe pushtetit në duart e irakianëve, tregoj se sa brishtë është demokracia në këtë vend. Jemi dëshmitarë se ky vend gati sa nuk është luftë qytetare sikurse edhe vendi fqinj, Siria e cila po përballet me një luftë të pistë qytetare e cila po zgjatë me vite.

SHBA është përpjekur të shërbejë dhe po shërben akoma për ardhmërinë e këtij rajoni, për paqen e stabilitetin në botë, për prestigjin e fuqisë më të madhe demokratike të kohës, për

ruajtjen e ekuilibrave të qëndrueshme në menaxhimin e tregut energjetik ndërkombtarë, për prespektivën e demokracisë dhe për fizionominë e rendit të ri botëror. Jemi dëshmitare edhe të ndryshimeve të shumta apo përpjekjeve për të realizuar këto ndryshime në disa vende arabe, në një proces transformimi revolucionarë të njohur si *“Pranvera Arabe”*. Pranvera Arabe ka qenë zhvillimi më i rëndësishëm në këtë drejtim dhe shumë vende me demokraci të konsoliduar në perëndim, edhe pse hezitues në fillim, përqafuan drejtimin në Libi dhe Egjipt. Megjithatë ndikimi amerikan në rajon është zbehur për shkak të ndërhyrjeve në Afganistan dhe Irak dhe disa gabimeve në kontrollin e ushtarëve në terren, SHBA vazhdon të ketë atë që quhet: *“soft power”*, influenca kulturore nëpërmejet paraqitjes së një modeli që është tërheqës për miliona të rinj të Lindjes së Mesme, sic janë filmat, teknologjia dhe interneti.

Sulmet terroriste të 11 shtatorit të vitit 2001 mbi kullat binjake dhe në Pentagon, si dhe sulmi i mundshëm i një avioni tjetër mbi Shtepinë e Bardhë ose *“Camp David”*, bënë që politika amerikane të orientohet shumë drejt luftës kundër terrorizmit. Pas 11 shtatorit 2001 filloi lufta e organizuar kundër terrorizmit. SHBA vite me radhë kishin ashpërsuar operacionet ushtarake, presionin ekonomik dhe atë politik mbi grupet që akuzoheshin si terroriste, si dhe mbi shtetet që akuzoheshin se i kishin mbështetur ata. Mirëpo kohëve të fundit, sidomos pas ardhjes në pushtet të Barak Obamas, vërehet një zbutje e veprimeve të ashpra ndaj grupeve të tilla dhe kalimi në forma tjera me të buta por më efikase në luftën kundër terrorizmit. U mbyll edhe kampi i shumë përfolur për sjellje jo të mira ndaj të burgosurve në burgun Guantanamo të Kubës. Mirëpo efekti i këtij ndryshimi u vërejt kur u kap i shumë kërkuari Osama Bin Laden, sulm i cili ishte spektakolar. Terrorizmi në Lindjen e Mesme po merr ngjyra fetare të radikalizmit islamik. Synimet e tij janë si më poshtë: de-stabilizimi i rendit ndërkombtarë dhe de-legjitimimi i vlerave dhe kulturës perëndimore. Për rrjedhojë terrorizmi në Lindjen e Mesme kërkon t’i transferojë problemet e rajonit në të gjithë botën sipas parimit, *“kur ne kemi problem, atëherë këto probleme janë për të gjithë nejrëzimin”*. Terrorizmi në Lindjen e Mesme duket se ka evoluar në drejtim të organizatave fundamentaliste islamike si All Kaeda, Hamas, Hezbollah-u etj. Shumica e terroristëve që realizuan 11 shtatorin në shumicën e tyre ishin nga Lindja e Mesme çfarë tregon se rajoni mbetet akoma vatra kryesore e terrorizmit ndërkombtar.

2.8. Aktet terroriste

Dihet se aktet terroriste kryhen në mënyra të ndryshme dhe terroristët kudo që veprojnë janë mjaft të shkathtë sepse ata pas çdo veprimi terrorist, ndryshojnë mënyrën e ardhshme të veprimit dhe këtë e bëjnë në mënyrë të vazhdueshme. Terroristët sot po avancojnë me veprimet e tyre, duke përdorur teknologjinë e fundit luftarake dhe të telekomandimit për të qenë sa më të saktë, goditës dhe konfidencial në fshehjen e gjurmëve të krimit. Mirëpo sot edhe teknologjia tjetër e kundërzbulimit të akteve terroriste, ka përparuar mjaft shumë. Sot kemi ekspertë të metodikës kriminalistikë të cilët studiojnë format dhe mënyrat e kryerjes së veprave penale dhe të krimeve apo akteve të gjitha format. Ekspertët e kundër-terrorizmit duhet të kenë njohuri edhe për format e akteve terroriste :

- ✓ Mënyrat dhe mjetet e kryerjes së akteve terroriste ;
- ✓ Përpunimin kriminalistik të akteve terroriste ;
- ✓ Hetimin dhe ndricimin e shpejtë të akteve terroriste ;
- ✓ Marrjen në pyetje të pandehurve në aktet terroriste dhe të dëshmitarëve tjerë.

2.8.1. Format e akteve terroriste

Terroristët janë shumë të organizuar para se të kryejnë aktet e planifikuara terroriste. Ata për realizimin e qëllimeve të veta përdorin të gjitha mjetet dhe metodat për të goditur kundërshtarin në pikat e tij më të dobëta. Format e akteve terroriste ndryshojnë për shkakun se kuptohet mënyra e aktit terrorist dhe terroristët kanë frikë se mos kapen dhe e dyta ngase disa akte terroriste zbatohen më lehtë e disa më vështire. Prandaj format kryesore dhe më të shpeshta të akteve terroriste janë:

- ✚ Marrja dhe mbajtja e pengjëve ;
- ✚ Rrëmbimi i mjeteve të udhëtimit masiv, aeroplanëve, anijeve, autobusëve, makinave, trenave, etj. ;
- ✚ Torturimi dhe vrasja e kundërshtarëve politike, përfshirë zhdukjen e tyre;
- ✚ Vënia e eksploziveve;
- ✚ Bombardimi i vendeve me civile;
- ✚ Përdorimi i armëve të shkatrrimit masiv, armëve nukleare, kimike dhe biologjike;
- ✚ Vrasja e civilëve, etj.


2.8.1.a Marrja dhe mbajtja e pengjeve

Koheve të fundit, marrja dhe mbajtja e pengjëve është bërë praktikë e shumë organizatave terroriste. Shënjestër e akteve të tilla kanë qenë qytetarë të shtresave të ndryshme, ku terroristët për lirim të tyre kanë kërkuar koncesione të ndryshme nga shtetet dhe biznesmenë të ndryshëm.

Zakonisht, pengjët mbahen rob për një kohë të caktuar dhe mesatarja shkon deri në 12 ditë edhe pse ka raste kur ata lëshohen shpejt, apo mbahen deri në tre muaj, por ka raste kur edhe pengjët vriten brutalisht duke nxjerrë aktet e ekzekutimit të tyre edhe në internet (youtube). Në përgjithësi shumica e rrëmbimeve kanë mbaruar me njëren prej këtyre epilogëve, si në vazhdim :

- ✚ Me përmbushjen e pjesshme apo të plotë të kërkesave të terroristëve dhe lirim të pengjëve;
- ✚ Me arritjen e kompromisit dhe lëshimin e të dy palëve, terroristëve dhe pushtetit, ku terroristët nuk vriten as nuk burgosen, por lirohen pas një procedure;
- ✚ Me thyerjen e plotë të terroristëve, vrasjen apo likuidimin e tyre të plotë, burgosjen apo arrestimin e tyre dhe lirim të pengjëve me intevenim të sukseshëm policor;
- ✚ Me mos përmbushjen e kërkesave të terroristëve dhe vrasjen e pengjëve, etj.

Sipas një studiuesi të quajtur Clive Aston, mjetet (vendet) prej nga merren më shumë pengjet janë dhënë në përqindje, shih grafikun e mëposhtëm.



2.8.1.b Rrëmbimi i mjeteve të udhëtimit masiv

Kjo formë e akteve terroriste është e ngjajshme me rrëmbimet apo pengj-marrjet por dallimi qëndron në atë se pengjet e rrëmbyera janë pasagjerë udhëtimesh me autobus, aeroplan, anije, trena etj. Karakteristikë e këtyre akteve terroriste është se mjetet e rrëmbyera të udhëtimit janë të mbushura me pasagjerë dhe ndodhen në lëvizjen brenda një hapsire e cila është lehtë të mbahet nën kontroll.

Pasagjerët dhe organet shtetërore njoftohen se në mjet është vënë eksplozivi, prandaj frika nga ndonjë katastrofë është e madhe, kështu terroristët arrijnë qëllimin e tyre më lehtë. Më së lehti për terroristët është rrëmbimi i aeroplanëve sepse këta zhvendosen më lehtë prej një vendi në tjetrin dhe rreziku nga shpërthimi në ajër është më i madh (*PanAmFlight 103 i cili shpërtheu në ajër më 21 dhjetor 1988 në Lockerbie të Skocisë dhe ku u vranë 243 pasagjerë dhe 16 anetarë të ekuipazhi*).

2.8.1.c Eksplozivët, shpërthimet dhe zjarrët

Forma më e theksuar e akteve terroriste është përdorimi i eksplozivëve, shpërthimeve dhe shkaktimi i zjarrëve të ndryshme. Sipas një studimi në SHBA, shumica e akteve terroriste janë kryer me eksploziv (108), me zjarr (2), rrëmbime pengjesh (8) dhe sulme me armë (5).⁵² Zakonisht terroristët përdorin eksplozivët si mjete më shkatruese për të realizuar sa më shumë viktima në njerëz dhe këtë e vendosin pikërisht aty ku ka qarkullim më të madh të njerëzve psh: në stacione treni, në stadione, në grumbullime festash, parqe, ku pushojnë njerëz, qendra biznesi, qendra tregtare, shtëpi mallrash, aeroporte, institucione shkollore, etj.

Terroristët i vendosin bombat dhe mjetet eksplozive në makina, në valixhe, në kontejnerë të mbeturinave, në kamionë, autobuse, aeroplan, në trupin e personit vetëvrasës apo edhe në hapsirat e vendeve që përmendëm më lartë dhe të cilat frekuentohen më shumë nga popullata civile. Zakonisht numri i viktimave gjatë këtyre akteve ndryshon. Kur veprimet e tilla kryhen natën ka më pak viktima, kurse nëse kryhen ditën, numri i viktimave është shumë më i madhë. Bombat të cilat përdoren janë nga disa kilograme TNT, e deri në disa tonë TNT (trinitrotoluol).⁵³

⁵² US Department of State; Patterns of Global Terrorism 1997. www.terrorism.com/analysis/index.html

⁵³ Vodinelic, Kriminalistika, Beograd 1996, fq 60

2.8.1 d Sulmet vetëvrasëse

Një sulm është vetëvrasës atëherë kur një sulmues ka për qëllim të vrasë të tjerët, duke ditur se gjatë veprimit të tij me siguri mund të vdesë edhe vetë. Që nga viti 1981 e deri ne vitin 2006 në mbarë botën janë kryer mbi 1200 sulme vetëvrasëse, e cila përbën vetëm 4% të sulmeve terroriste në mbarë botën, por që mori jetën e 32% te njerëzve nga sulmet terroriste apo 14.599 njerëz. Thuhet se 90% e sulmeve vetëvrasëse janë kryer në Irak, Izrael, Pakistan, Afganistan dhe Shrilanka .

Vetëvrasja dhe vrasja e tjerëve (civilëve) në këtë është një veprim i pakuptueshëm por që konsiderohet si metodë e *“terrorizmit modern“* për të shkaktërruar objektivat e paarmatosura civile, zakonisht njerëzit nëpër tregje, shkolla apo institucione fetare. Raste të veprimeve të tilla terroriste janë përdorur në Liban me vrasjen e 300 ushtarëve amerikane dhe francez, pastaj në Izrael nga Hamasi , në Shrilanka nga Tigrat Tamil dhe së fundmi në Irak e Afganistan nga grupet e atjeshme terroriste. Sidoqoftë vetëvrasja dhe terrorizmi i shkaktuar nga sulmet vetëvrasëse, është mjaft i vështirë për tu përkufizuar, por Këshilli i Sigurimit në mars të vitit 2005 i definoj këto veprime si *“akte terroriste që kanë për qëllim plagosjen e rëndë dhe vrasjen e civilëve me qëllim friksimin e popullatës tjetër“*.

2.9. Shërbimet informative

2.9.1 CIA (*Central Intelligence Agency*)

CIA është agjencia kryesore e inteligjencës në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Selia e saj është në Langley të Virginias pak kilometra në perendim të Uashington DC. Punonjësit e CIA-s janë të angazhuar jo vetëm brenda vendit por edhe jashtë tij, posaqërisht në ambasadat amerikane kudo në botë. Kjo agjenci i raporton drejtpërdrejt drejtorit të Intelegjencës Kombetare i cili është nën kontrollin e presidentit të Shteteve të Bashkuara.

CIA i ka tri aktivitete kryesore tradicionale, e para të sigurojë informacione në lidhje me qeveritë e huaja, korporatat dhe individët, duke analizuar informacionet dhe kështu bën vlersimin e intelegjencës së sigurisë së Shteteve të Bashkuara dhe aletëve të saj. Për këtë shërbim qeveria e Shteteve të Bashkuara ndan në buxhet prej rreth 53 miliard dollarë në vit. Thuhet se në vitet pas sulmeve të 11 shtatorit CIA kishte shpenzuar para 28% më shumë (ose 14.7 miliard dollarë) se sa në periudhën para sulmeve. CIA aktualisht ka disa prioritete:

1. Luftën e vazhdueshme globale kundër terrorizmit;
2. Mospërhapjen e armëve bërthamore dhe atyre të shkatërrimit në masë;
3. I njofton udhëheqësit amerikane për ngjarjet jashtë shtetit dhe përpjekjet e organizatave të ndryshme për të rrezikuar Shtetet e Bashkuara;
4. Zbulimin dhe kundërzbulimin;
5. Intelegjencën kibernetike , etj.

CIA ka edhe një sektor të posacëm i cili merret me luftën ndërkombëtare kundër terrorizmit. Kjo agjenci u krijua në vitin 1947 nga Harry Truman. Aktualisht drejtor i CIA-s është John Brennan. CIA I ka 21. 575 të punësuar.

2.9.2 FBI (Zyra Federale e Hetimeve)

Byroja Federale e Hetimeve (FBI) është një agjenci e cila i përket Departamentit Amerikan të Drejtësisë. Ky është një trup federal hetues I krimit dhe një agjenci e mbrendshme e inteligjencës dhe e kundërzbulimit. Kjo zyre është themeluar në vitin 1908, ku në fillim ajo nuk ishte emër, por policët quheshin thjesht “ agjent të forcës speciale “ . Më vonë zyra mori emrin “Byroja e Hetimit“, pastaj në vitin 1935 u ndryshuan në “Byroja Federale e Hetimit“ (FBI). Selia e saj ndodhet në Uashington DC.⁵⁴ Misioni i kësaj byroje është që të mbrojë Shtetet e Bashkuara nga kërcënimet e cdo lloji të inteligjencës terroriste, që mund të vijnë nga jashtë apo nga brenda tij. Prioritet e FBI-së janë: siguria kombëtare, zbatimi i ligjit dhe përdorimi i inteligjencës për të mbrojtur kombin nga kërcënimet globale apo shkelja e ligjit prej qytetarëve amerikanë. Prioriteti FBI-së është:

- ❖ Mbrojtja e Shteteve të Bashkuara nga sulmet terroriste ;
- ❖ Mbrojtja e Shteteve të Bshkuara nga operacionet e huaja te zbulimit dhe spiunazhi ;
- ❖ Mbrojtja e SHBA-së prej sulmeve kibernetike dhe të teknologjisë së lartë ;
- ❖ Lufta kundër korrupsionit publik në të gjitha nivelet ;
- ❖ Mbrojtja e të drejtave civile të qytetarëve amerikanë.

Azhurimi i teknologjisë me fjalën e fundit të saj , për të kryer me sukses misionet, etj. FBI ka 35.244 të punsuar, prej tyre 13.598 agjentë special dhe 21.746 staf tjetër për përkrahje profesionale të llojeve të ndryshme. Buxheti vjetor i FBI-së është mjaft i madhë dhe shkon deri në 8.3 miliardë dollarë

⁵⁴ Lauren B. O’Brein “The Evolution of Terrorism Since 9/11 “, The FBI-s Counterterrorism Analysis Section.

KAPITULLI - IV

NDIKIMI I TERRORIZMIT NE

POLITIKAT E BE-së

3.1 NDIKIMI I TERRORIZMIT NE POLITIKAT E BE-së

Reagimi i Bashkimit Evropian dhe i shteteve anëtare të saj në raport me ngjarjet e 11 shtatorit të vitit 2001 ishin të shpejta dhe të menjëherëshme. Linjat kryesore të veprimtarisë së BE-së ndaj këtyre ngjarjeve ishin të përcaktuara në konkluzionet e Këshillit të Jashtëzakonshëm Evropian i cili u mbledh në shpejtësi për të analizuar situatën e krijuar pas ngjarjeve të 11 shtatorit. Pjesa më e madhe e pikave të veprimit të BE-së, si përgjigje ndaj ngjarjeve të 11 shtatorit, kishin të bënin me bashkëpunimin për rastet kriminale dhe veprimet e ndërmara mbulonin rastet e:⁵⁵

- ❖ Kornizës vendimmarrëse për mandat arresti;
- ❖ Kornizës vendimmarrëse për luftim të terrorizmit; dhe
Masat tjera të nevojshme si;
- ❖ Rritja e rolit të Europolit dhe Interpolit;
- ❖ Krijimi i Drejtësisë Evropiane;
- ❖ Parandalimi dhe ndërprerja e financimit të terrorizmit dhe masat tjera.

Veprimet tjera që BE kishte ndërmarrë për të parandaluar veprimet e mundshme terroriste në territorin e saj, janë: përgatitja e masave tjera sulmeve të mundshme bakterilogjike, kimike , radiologjike, bërthamore dhe masave tjera në fushën e sigurisë së komunikacionit ajror dhe formave tjera të komunikacionit, si dhe masave tjera në fushën civile dhe shëndetësore të komunitetit, përfshirë masat ndaj sëmundjeve të mundshme ngjitëse dhe epidemiologjike.

⁵⁵ Sulejmanov Z, Kriminalna Politika, Shkup 2001, fq 86

Në fund, duhet të themi se pas 11 shtatorit 2001, BE-ja ka reaguar me mjaft shpejtësi në implementimin e një numri të madhë masash dhe politikash të sigurisë. Ajo ka bërë një përparim të madhë në fushën e bashkëpunimit ndërshtetëror brenda BE-së por edhe në realicionin BE-SHBA, në fushën e zbatimit të ligjit dhe bashkëpunimit policor dhe juridik. Sidoqoftë edhe pse është bërë punë e madhe në këtë drejtim, mbetet akoma edhe më shumë punë për tu bërë, që terrorizmi të mos gjejë vend në hapsirën e Unionit Evropian, si dhe të jetë i pasigurtë kudo që vepron në tërë globin.

3.2. Strategjia e BE-se kunder terrorizmit

Strategjia Evropiane kundër terrorizmit është miratuar nga Këshilli i Evropës në dhjetor të vitit 2005. Kjo strategji reflekton qëllimin e formimit të një rrjeti të politikave të jashtme dhe të mbrendshme të shteteve anëtare të BE-së në luftën kundër terrorizmit. Plani i veprimit i përmban 160 masa të vecanta në gjithë hapat strategjike të punës së BE-së, që janë: parandalimi, mbrojtja, ndjekja dhe përgjigje ndaj të gjitha formave të ekspozimeve terroriste në kontinentin tonë.

Strategjia kundër terrorizmit është një forcë mjaft e rëndësishme në ndërtimin e një rrjeti evropian të komunikimit në luftë kundër terrorizmit. Kanë lindur edhe disa ide të reja të cilat po studiohen me kujdes, për krijimin e një Shërbimi Intelgjent Evropian analog me CIA-n Amerikane, një Drejtori Gjeneral për sigurinë kombëtare, një Prokurori e Përgjithshme dhe se fundmi një Gjykatë Evropiane për krime.⁵⁶

Sic theksuam më sipër, strategjia e Bashkimit Evropian kundër terrorizmit është parandalimi, mbrojtja, ndjekja dhe përgjigja ndaj akteve të mundshme terroriste. Prandaj themi se të gjitha shtetet e Unionit Evropian por edhe ato që pretendojnë të anëtarësohen në këtë organizëm të luftojnë pa hezitim terrorizmin e çfardo forme dhe prej çfardo vendi që vjen. Është qëndrimi i BE-së së terrorizmi është kërcënim për të gjithë evropianët, për të gjitha shtetet tona dhe popujt tanë. Ai është kërcënim serioz për demokracinë evropiane dhe vlerat tona që kemi në këtë kontinent. Terrorizmi është një veprim kriminal dhe i pa justifikueshëm në çfarëdo kushtesh dh rrethanash.

⁵⁶ Charret.S "The modern identity Changer",Paladin Press Book, Boulde, Colorado US, 1997 fq 77

Bashkimi evropian është një vend i lirë dhe vend i vlerave prej të cilave ka përfituar i tërë globi, prandaj ne nuk duhet të lejojmë që përmes veprimeve terroriste të kufizohet liria e lëvizjes, lëvizja e lirë e ideve, teknologjive dhe burimeve njerëzore e materiale. Grupet e ndryshme terroriste janë të padëshiruara në familjen e demokracive evropiane, posaçërisht organizatat terroriste si Al Qaeda , etj. , veprimet terroriste të së cilës nuk mund të justifikohen , prandaj nuk do të ketë fjalë për asnjë akt të mundshëm terrorist që mund të kryejë kushdo në hapsirën e Unionit Evropian.

3.2. Bashkëpunimi SHBA – BE kundër terrorizmit

Bashkëpunimi ndërkombëtarë në luftën kundër terrorizmit është i fokusuar në fushën e ligjit penal, të bashkëpunimit gjyqësorë dhe policor dhe padyshim që nuk është i kufizuar vetëm në nivel shtetesh por në nivel global. Bashkëpunimi më i madhë në këtë drejtim është krijuar në mes të Bashkimit Evropian dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Në kuadër të përpjekjeve të Bashkimit Evropian për të ndihmuar Shtetet e Bashkuara në luftë kundër terrorizmit, pas ngjarjeve të 11 shtatorit 2001, filloj miratimi dhe zbatimi i menjëhershëm e disa ligjeve kundër terrorizmit, si dhe filloj një bashkëpunim i theksuar me shërbimet amerikane të sigurisë. Edhe departamenti i shtetit Amerikan dhe vetë Presidenti Xhorxh Bush, ishin shumë të kënaqur me këtë bashkëpunim dhe konsideronin se ky qëndrim do ti ndihmojë shumë në zbulimin dhe asgjësimin e celulave të organizatave terroriste që ndodheshin në Evropë.

Rritja e bashkëpunimit SHBA–BE , ishin në përputhje me rekomandimet e komisionit 9/11, i cili lejonte Shtetet e Bashkuara që të krijojnë një koalicion gjithëpërfshirës në luftën kundër terrorizmit kudo që ai gjendet në globin tokësor, e sidomos fillimin e një luftë kundër terrorizmit islamik në rajonin arabik.⁵⁷

Në qeshor të vitit 2010, Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi Evropian, miratuan një “deklarate mbi antiterrorizmin“ e cila i thelloi edhe më shumë marrëdhëniet mes SHBA-së dhe BE-s në luftën kundër terrorizmit. Kjo marrëveshje përfshinte lidhje me të ngushta të shërbimeve SHBA–BE dhe forcimit të ligjeve kundër terrorizmit. Ndërkohë parashihej edhe fshehja dhe bllokimi i financimit të organizatave terroriste, këmbimi i informacioneve dhe mbrojtja e të

⁵⁷ Willikson Paul: Political Terrorism, Macmillan Press, London 1974

dhënave për terroristët dhe grupet e tyre, ruajtja dhe incizimi i ermrave të pasagjerëve dhe rezervimeve të biletave të tyre në relacionet transatlantike. Me këtë marrëveshje u thellua edhe bashkëpunimi në lidhje me forcimin e kontrollit kufitar të sigurisë në transportin tokësore, të sigurisë së transportit ajror dhe aviacionit civil , sigurinë e transportit detar, sigurinë e vizave, etj.,

3.4 Interpoli dhe Europoli

3.4.1 Interpoli

Interpoli është një organizatë ndërkombtare e policisë kriminale, e cila me funksionimin e vetë lehtëson shumë bashkëpunimin ndërkombtarë policor. Roli kryesor i kësaj organizatë është që ti mundësoj policisë në mbarë botën të punojnë së bashku dhe të bëjnë botën një vend më të sigurt. Interpoli ka një infrastrukturë të lartë të teknologjisë më moderne që disponon njerëzimi dhe ka krujuar një mekanizëm të mbështetjes së plotë operacionale dhe teknike e cila ndihmon vendet anetare që ti përmbushin sfidat në luftimin e krimit të organizuar dhe të terrorizmit si fenomene negative të shoqërisë njerëzore.⁵⁸

Interpoli është themeluar për herë të parë në Monako, në kongresin ndërkombtar të policisë kriminale që u mbajt në vitin 1914 për tu transferuar në vitin 1923 në komision policor dhe në vitin 1956 në një organizatë me emrin aktual “Interpol“.Kjo organizatë sot ka një buxhet vjetor prej 70 milion eurove e siguruar nga anetarësia e saj prej 190 shteteve të saj anetare. Shtabi kryesorë i Interpolit është në Lion të Francës . Sekretariati i përgjithshëm i Interpolit ka nje staf prej 703 të punësuar që vijnë nga 98 vende anetare të kësaj organizate. Shef aktual i Interpolit është amerikani Ronald Noble. Interpoli ka një politike neutrale për veprimet e kryera duke mbështetur në kushtetutën e saj dhe duke mos kryer asnjë veprim me prapavijë ushtarake, politike, fetare apo raciale. Thjesht është një mekanizëm profesional dhe i paanshëm

Puna kryesore e Interpolit është luftimi i terrorizmit, krimit të organizuar, krimeve kundër njerzimit, krimit ndaj mjedisit, gjenocidit, krimeve të luftës, piratërisë, trafikut të paligjshëm të veprave të artit, trafikimit të drogës dhe prodhimit të saj, trafikimit të armëve, trafikimit të qenieve njerëzore, pastrimit të parave, pornografisë me femijë, krimit kompjuterik , korrupsionit shtetëror, apo krimeve me motive financiare dhe që kanë lidhje me mashtrimet biznesore, etj.

⁵⁸ Office of information and pres Nato, Doracak, Bruksel, 2001 dhe 2006 fq 93

Pas ngjarjeve të 11 shtatorit shumë institucione të policisë të shteteve të ndryshme në gjithë globin janë organizuar dhe kanë zgjeruar edhe me shumë bashkëpunimin ndërkombtarë, si dhe kanë modifikuar strategjitë e tyre në luftë kundër terrorizmit . Pikerisht Interpoli iu ka dhënë shumë instruksione të policisë së shteteve anëtare të saj, duke i trajnuar ata në luftimin e të gjitha formave të paraqitjes së terrorizmit në vendet e tyre.

3.4.2 Europoli

Për krijimin e Europolit është rënë dakord në Traktatin e Mاستrihtit të vitit 1992, kur edhe u formua Unioni Evropian. Mirëpo Europoli filloj të bëhet plotësisht operacional nga 1 korriku i vitit 1999. Drejtor aktual i Europolit është Rob Wainwright nga Mbretëria e Bashkuar.

Në një udhëzim të dhënë nga Interpoli, sqarohen përpjekjet e fundit në luftën kundër terrorizmit dhe formave tjera të krimit ndërkombtarë. Europoli është polici e Unionit Evropian apo ndryshe quhet Zyra Evropiane e Policisë dhe patjetër që ka një dallim prej Interpolit, mirëpo meqenëse të dy këto organizata i kanë selite në Evropë, bashkëpunimi i tyre është më i lehtë. Europoli e ka selinë në Hagë. ⁵⁹

⁵⁹ www.interpol.int

3.4.3. Shtetet dhe qeveritë që përkrahin terrorizmin

Janë të njohura botërisht disa shtete të cilat në mënyra të ndryshme e përkrahin terrorizmin në përmasa të ndryshme. Aktualisht shtetet më problematike në këtë drejtim ndodhen në lindjen e mesme. Me Iranin filluan problemet e perëndimit me botën arabe dhe me Iranin janë duke vazhduar akoma të njejtat probleme. Si duket vetëm Irani është shteti më i paparashikueshëm i formave të luftës në botën arabe. Prandaj studiues dhe analistë të ndryshëm të situatës në lindjen e mesme thonë se Irani është tani për tani vendi i vetëm “i patheshëm“ në botën arabe.

Sipas shërbimeve inteligjente perendimore, sot në botë janë disa shtete dhe qeveri të cilat janë të njohura si përkrahëse dhe financuese të terrorizmit ndërkombtarë. Këto shtete janë: Irani, Siria, Korea e Veriut, Sudani e në masë pak më të butë edhe Iraku, Afganistani, Libia, Kuba, Jemeni, Somalia , Etiopia , Alergjia, etj. Disa shtete si Pakistan , Libia, Iraku, Afganistani etj, edhe pse kanë qeveri të brishtë të zgjedhura në mënyrë pjesërisht demokratike ka në mbendinë e tyre elemente shtetërore të cilat janë të lidhura me organizatat terroriste.



Zakonisht vendet që sponsorizojnë terrorizmin, iu mundësojnë atyre mënyrë të sigurtë për të jetuar dhe vepruar, për të mbledhur para dhe për të përgatitur sulme ndaj qytetarëve të pafajshëm të një vendi që ata duan ta ndëshkojnë. Janë vetëm Shtetet e Bashkuara dhe disa vende evropiane, ato të cilat janë duke luftuar kundër terrorizmit dhe kanë vënë masa të shumta shtrenguese, përfshirë këtu edhe sanksione të ndryshme ekonomike dhe politike ndaj këtyre shteteve.⁶⁰ Mirëpo është me rëndësi të thuhet se pas intervenimit të Shteteve të Bashkuara dhe disa shteteve aleate në Irak dhe Afganistan dhe në forma tjera edhe në disa vende tjera të lindjes së mesme, terrorizmi në ato vende është goditur fuqishëm dhe kjo ka bërë të mundur që intensiteti i akteve terroriste që vinte nga këto vende të bie në këto pesë vitet e fundit. Por edhe

⁶⁰ Klaus – Dieter Borchard, Edrejta e komunitetit European, Doracaku, Bruksel 1999, fq 119

disa vende tjera që kohëve të fundit, vetë kanë ndryshuar sistemet e tyre politike, kanë bërë përparime domethënëse në drejtim të luftimit të terrorizmit. Ka përparime të dukshme edhe në politikat e disa shteteve të njohura në sponsorimin e terrorizmit, të cilat më nuk e bëjnë një gjë të tillë dhe bëjnë të kundërtën duke ju mohuar prezencën e organizatave terroriste në vendet e tyre.

4.2. Shtetet që janë cak i terrorizmit

Terrorizmi ndërkombtarë me veprimet dhe aktet e kryera terroriste ka treguar se nuk njih kufij. Mirëpo ne dimë se disa shtete janë të ekspozuara më shumë ndaj akteve terroriste, disa prej të cilave janë shënjestrim i përhershëm i tyre.

Zëdhënësi i Al-Qaeda Sulaiman bu Ghaith, në një deklaratë për shtyp tha se (fillim citati): *Ne akoma jemi në fillim të rrugës, sepse amerikanët nuk kanë vuajtur prej nesh ende atë që kemi vuajtur ne prej tyre. Shtetet e Bashkuara kanë vlarë me mijëra njerëz tanë në Irak, Afganistan, territorët Palestineze, Filipine, Sudan, Bosnjë dhe Kashmir. Pra sipas llogarive tona ne kemi të drejtë të vrasim katër milionë amerikanë, prej tyre një milion femijë, të zhvendosur dyfishin e tyre dhe të plagosim e dëmtojmë qindra e mijëra të tjerë. Ne kemi të drejtë të luftojmë kundër tyre me armë kimike dhe biologjike për aq sa na shkaktuan ata sëmundje me armët e tyre që përdoren në trojet tona* (mbarim citati). Prandaj nga kjo deklaratë kuptojmë se shteti i cili më së shumti përballet me terrorizmin dhe i cili është cak i përhershëm i veprimeve terroriste është SHBA .

Përvec Shteteve të Bashkuara edhe aleatët e saj evropian janë cak i përhershëm i terrorizmit, posacërisht: Franca , Britania e Madhe, Gjermania, Kanadaja dhe vendet tjera. Por në shënjestrën e organizatave terroriste janë disa shtete arabe të cilat edhe pse janë vendburim i grupeve më të rrezikshme terroriste, ato së pari veprojnë në rajonin e tyre dhe caku i tyre janë të huajt dhe bizneset e tyre në rajon. Me kalimin e kohës terrorizmi ndërkombtarë po ndërron formën e veprimit të tij dhe aktualisht në luftë siriane po kryhen akte monstruoze terroriste në një luftë civile me konotacione të sekteve fetare dhe kjo po e vërteton thënien se terrorizmi nuk njih as kufij nacional as shtetëror as religjioz.

4.3. Reflektimi i ngjarjeve të 11 shtatorit në terrorizmin global

Atë ditë u mor vesh se trupi i Osama Bin Ladenit u varros në det të hapur, shumë analistë politikë, vëzhgues dhe gazetarë , mendonin se bashkë me Bin Ladenin u varros edhe terrorizmi ndërkombtarë, Sic e dimë epoka e terrorizmit ndërkombtarë e arriti kulmin e vetë me mizoritë e shkaktuara me goditjen e kullave binjake më 11 shtator 2001 , Gjatë viteve të fundit struktura e grupeve terroriste ka evoluar pjesërisht për shkak të politikave amerikane dhe evropiane në rajonin e Lindjes së Meseme e pjesërisht për të teknologjive të reja të cilat kanë hapur një model të ri të terrorizmit modern. Tani interneti ka shtuar edhe më shumë rreziqet nga terrorizmi , por edhe ka bërë më të lehtë identifikimin e organizatave terroriste dhe zbardhjen e pikëpamjeve të përkrahësve të tyre të cilët mund të ndodhën kudo.

Si duket planet e Al-Qaedas dhe vetë Osama Bin Ladenit nuk u realizuan ashtu si mendonin ata, për shkak se ushtria e tyre e përbërë nga besimtarë fanatikë dhe ithtarë të devotshëm të kauzës së tyre u shpartallua turpshëm gjatë du lufrave që Shtetet e Bashkuara dhe aleatët bënë kundër tyre. Ata nuk kishin se ku fshiheshin as ku të fusnin kokën nga bombardimet e pareshtuara të kampeve të tyre stërvitore. Ata po përgjoheshin dhe vëzhgoheshin me një teknologji tejet të sofistikuar dhe mandej goditjet ndaj tyre ishin të kobshme dhe shfarosëse. Prandaj mund të themi se Shtetet e Bashkuara patën një sukses të pakontestueshëm në goditjen fatale ndaj terrorizmit , duke eliminuar strehimin e tyre kudo që ata ishin dhe duke asgjësuar një nga një udhëheqësit kryesorë të tyre .

Sipas John Brennan , shef i Shtëpisë së Bardhë për luftën kundër terrorizmit, SHBA këto vitet e fundit e kishte goditur për vdekje Al Qaedan dhe kishte dobësuar celulat e saj deri në minimum. Sipas tij kjo organizatë , tani varet nga filialet e saj në Jemen, Algjeri, Irak dhe disa celula në malet e Pakistanit në kufi me Afganistanin . Edhe këto pozicione të Al-Qaedas nuk janë të sigurt, pasi që bombardohen pandërprerë nga avion pa pilot të cilët godasin caqet e grupeve terroriste në këto vende. ⁶¹

Sipas disa dëshmitarëve të afërt me Al Qaedan, tani edhe liderët e saj janë përcarë për shkak të humbjeve të mëdha që kanë pas kohëve të fundit dhe likuidimit të udhëheqësve të saj. Sidoqoftë decentralizimi i organizatës nuk kupton edhe shuarjen e saj, prandaj Shtetet e

⁶¹ Klaus – Dieter Borchard, Edrejta e komunitetit European, Doracaku, Bruksel 1999, fq 201

Bashkuara duhet të jenë një hap para kësaj organizate, nëse dëshiron të ketë nën kontroll sigurinë e vetë kombëtarë dhe të shteteve të saj aleate.

Një nga elementet më të rrezikshme të politikës që ndjek Al Qaeda është natyra transnacionale e terrorizmit. Bin Laden dhe përkrahësit e tij kritikojnë shtetet arabe, sidomos Arabinë Saudite dhe Egjiptin, të cilat bashkëpunonin me Shtetet e Bashkuara dhe vendet tjera perendimore, duke i akuzuar për mosbesim. Përkundër kësaj Al-Qaeda dëshironte që duke sulmuar Shtetet e Bashkuara dhe aleatët perendimore, do të dobësonte ato dhe kështu do ta kishte më lehtë të merte pushtetin në Egjipt dhe Arabi Saudite dhe disa vende tjera arabe.

Në fakt, nëse analizojmë ngjarjet e fundit në disa shtete arabe edhe mund të themi se elementet e kësaj organizate edhe aktualisht janë duke vepruar në këto shtete, në një formë apo në formën tjetër. Jemi dëshmitarë të paqëndrueshmërisë së pushtetit në Egjipt, luftës civile në Siri, infiltrimëve të Hezbollahit dhe organizatave tjera në këtë luftë, veprimeve ekstremiste në Irak dhe Jemen, luftës guerile në Mali, në Sudan , etj. Kjo po vërehet me frikën që ka pushteti në Afganistan prej talebanëve për të punuar vazhdimin mëtejme të prezencës së trupave amerikanë në këtë vend.

Një tjetër fakt, është se shumë organizata të lidhura me Al Qaedën nuk po rekrutojnë me njerëz në këtë organizatë, si Talebanet, Hamas, Hezbollah, etj, të cilat janë të organizuar në luftërat e tyre nacionale e jo transnacionale. Ndoshta veprimet e tyre akoma mund të jenë të njëjta me Al Qaedën por qëllimet e tyre zbatohen vetëm në vendet e tyre .

Sot politika amerikane e presidentit Obama , ka zbutur pak qëndrimin ndaj rajonit duke u orientuar më shumë në zgjidhjen e problemeve brenda vendit se ato jashtë tij. Kështu që vendimi i Obamas për tërheqjen e trupave amerikanë edhe nga Afganistani këtë vit, si duket i ka trimëruar grupet ekstremiste , talebane dhe ato të Al Qaedës që të kërcënojnë presidentin Afgan , Karzai që të refuzojë praninë e mëtejme të trupave amerikanë në Afganistan. Por SHBA i ka realizuar objektivat e veta në rajon, duke shkatërruar organizatat famëkeqe terroriste, duke vrarë lideret e tyre dhe duke themeluar dy qeveri demokratike përafërsisht të afta për të drejtuar vendet e tyre të cilat ishin bastione të organizatave më të egra terroriste që ka njohur bota. Sot Shtetet e Bashkuara nuk janë më të kërcënuara si më parë, por edhe sikur të ishte kështu, siguria është në nivel shumë të lartë dhe katastrofat si ato të 11 shtatorit 2001 nuk janë më të mundshme.

SHBA-të mund të preken nga sulme të vogla terroriste individuale por jo më të përmasave të 11 shtatorit. Si duket qëndrimi i fortë dhe i palëkundur i SHBA-ve në luftën kundër terrorizmit, bëri që kjo dukuri të bie në intensitet dhe bota dhe qytetarët e saj të jenë më të sigurtë. Sidoqoftë njerëzimi duhet të jetë përherë sycelë dhe të jetë në gjendje që kurdo herë të përballet me të gjitha format e terrorizmit por gjëja më e mirë është parandalimi i tij. Strategjia kundër terrorizmit duhet të zhvillohet krahas formave të reja të paraqitjes së tij, prandaj lufta kundër tij nuk duhet të pushoje deri në mosekzistimin e terrorizmit si fenomen njerëzor.

4.4. Qasjet e reja ndaj terrorizmit pas ngjarjeve të 11 shtatorit

Pas ngjarjeve të 11 shtatorit 2001, në opinionin ndërkombtarë u shfaq një zemërim i paparë ndaj veprimeve terroriste dhe organizatorëve të tyre, sa që i tërë komuniteti ndërkombtarë iu bashkua si fizikisht ashtu edhe moralisht aleancës për luftimin e terrorizmit ndërkombtarë . Mirëpo pas aksioneve të shpejta dhe shumë të rrepta që ndërmori SHBA dhe disa vende perendimore, disa prej aksioneve edhe pa miratimin e Këshillit të Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, situata ndryshoj dhe shumë shtete nuk ishin të pajtimit (në parim) për ndërhyrje të tilla të cilat e kishin konsensusin e OKB-së. Kundër ndërhyrjeve në Afganistan dhe Irak , ishin anëtarët e përhershëm të Këshillit të Sigurimit: Kina dhe Rusia por edhe disa shtete të zgjedhura të saj. Ndërkohë që pas disa aferave (vrasjeve të civilëve) të ushtrisë amerikane në Irak dhe Afganistan, reputacioni i ushtrisë që po luftonte terrorizmin, filloj të bie dhe kundërshtimet ndaj luftes atje filluan të rriten. Shumë shtete aleate të SHBA-ve në luftën ndaj terrorizmit filluan ti tërheqin ushtritë e tyre nga lindja e mesme, kështu që SHBA u detyrua të barte barrën kryesore të luftës ndaj terrorizmit.

Pakënaqësia për prezencën perendimore në rajon, nuk ishte përhapur vetëm në popullatën vendase por edhe në shumë shtete evropiane dhe të vendeve tjera të botës, që kërkonin tërheqjen e trupave amerikane nga këto dy vende arabe.

Pas kapjes së Sadam Huseinit dhe vrasjes së Osama Bin Ladenit, Shtetet e Bashkuara ishin më të lehtësuara se kishin asgjësuar kokën e terrorizmit më të egër ndërkombtarë dhe filluan përgatitjet për tërheqje. Kjo filloj të ndodhë pas ardhjes në pushtet të Barak Obamas, i cili filloj të udhëheq një politikë më të butë dhe paqësorë në rajon, duke filluar tërheqjen e trupave amerikane nga Iraku në korrik të vitit 2009, për tu tërheqë plotësisht nga ky vend në dhjetor të

vitit 2011. Këtyre ditëve të fundit është në proces edhe tërheqja e ushtrisë amerikane nga Afganistani e cila sipas State Departament-it amerikane do të bëhet deri në fund të vitit (2014). Edhe vetë presidenti i vendit ku kishte gjetur strehim Al Qaeda, z.Hamid Karazi, kishte bërë thirrje për një qasje të re në luftën ndaj terrorizmit, duke thënë se “ *strategjia e luftës që po përdoret kundër popullit afgan, është në kundërshtim me realitetin në terren*“ , ai më tej tha se: “ *fshatrat afganë nuk janë vendlindja e terrorizmit apo terren ushqyes për terroristë , por ata janë njerëz të pafajshëm dhe nuk duhet të bëhen viktima të një lufte kundër terrorizmit*“ .

Në anën tjetër presidenti “ paqësor “ amerikan Barak Obama , në një tubim përkujtues të viktimave të 11 shtatorit tha se: “*Ne si Amerikanë, nuk jemi por as kemi qenë kurrë në luftë me Islamin por me një grup njerëzish të këqij sic janë Al Qaeda të cilët me veprimet e tyre terroriste po mundohen të prapësojnë rrugën paqësore të Islamit*“ .⁶²

Sido që të jetë veprimet terroriste të 11 shtatorit ngjallen një zemërim dhe urrejtje të paparë ndaj terrorizmit dhe organizatës Al Qaedas, e cila në pamundësi për t’iu kundërvënë drejtpërdrejt fuqisë ushtarake amerikane, iku dhe u fsheh në malet Tora Bora, në kufirin Afgano-Pakistanez dhe kush e pësoj, ishte populli afgan I cili u përdor si mburojë e këtyre terroristëve në aksionet e tyre ndaj ushtrisë më të fortë në botë. Por edhe kjo ushtri në fund u detyrua të lë terrirotrin e huaj dhe të kthehet në shtëpi të vetë , me shpresë se terrorizmi kishte marrë mësimet e duhura se cdo veprim si ai 11 shtatorit kushton shumë për të dy palët.

⁶² The History of Terrorism from Antiquity to Al-Qaeda, Gerard Chaliand and Arnaud Blin, 2007 fq 314

METODOLOGJIA E HULUMTIMIT TE TEMES SE MAGJISTRATURES

Sqarimi metodologjik: Eshtë shumë vështirë që të hulumtohet nje problematik ose një ngjarje sic është ngjarja e “11 shtatorit”, pasi kjo ngjarje lidhet me terrorizmin që ndodhë kudo në botë. Kjo është e vështirë pasi kemi të bëjmë me “terrorizëm”, pikërisht kur flasim për këtë kemi të bëjmë me një problematik të gjërë dhe pa fund. Për të vërtetuar disa dilema dhe probleme për të ardhur deri te disa karakteristika dhe të dhëna vendosa që të bëj anketim me 100 persona për këtë çështje të ndjeshme. Nga të gjithë këto persona të anketuar kam arritur të fitoj edhe mendimet e tyre lidhur me çështjen e terrorizmit.

Vendi i hulumtimit: Pjesa kërkimore e punimit të magjistraturës përfshinë anketimin e personave të Tetovës dhe rrethinës Në këtë anketim janë të përfshirë 100 persona të moshave, gjinive dhe të fakulteteve të ndryshme.

Gjinia: Në këtë hulumtim gjithashtu janë anketuar 100 persona të gjinive të ndryshme, 40 të anketuar janë të gjinisë mashkullore dhe 60 persona të anketuar janë të gjinisë femrore.

Subjekti i hulumtimit: Me hulumtimin e bërë arrita të mar mendimet e të anketuarve për ta arritur qëllimin kryesorë dhe të fitoj mendimet e tyre lidhur me terrorizmin në përgjithësi e vecanarisht në këtë rast që lidhet me ngjarjen e 11 shtatorit.

Numri i pyetjeve në fletën anketuese: Në këtë hulumtim janë përfshirë 19 pyetje, të gjitha ato që lidhen me terrorizmin modern dhe me ngjarjen e 11 shtatorit.

Koha e hulumtimit: Hulumtimi është kryer në janar-shkurt të vitit 2016, nga persona të fakulteteve të ndryshme dhe të cikleve të ndryshëm.

Pjesa e parë: Pjesa e parë e pyetsorit të formuluar përbëhet nga pyetjet ne lidhje me terrorizmin në përgjithësi si kërcënim global, me ngjarjen e 11 shtatorit, si dhe karakteristikat e ndryshme që përfshinë ngjarja e 11 shtatorit dhe se sa ka ndikim ajo në paraqitjen e terrorizmit


në ditët e sotme e cila vazhdon të jetë kërcënim në mbarë rruzullin tokzorë duke u paraqitur me forma dhe metoda të ndryshme.

Pjesa e dytë: Pjesa e dytë e pyetsorit të formuluar ndaj personave të anketuar përfshinë pyetje me karakteristika të ndryshme, në këtë rast përfshinë fenë, ideologjitë, interesin dhe disa faktorë të tjerë se sa ato ndikojnë në paraqitjen e terrorizmit dhe vecanarisht në këtë rast në ngjarjen e 11 shtatorit.

Pjesa e tretë: Pjesa e tretë e pyetsorit përfshinë pyetje në lidhje me frigën, panikun dhe mosbesimin e njerëzve në vendet ku ato jetojnë, gjithashtu përfshinë shqetsimin e tyre që mos të jenë viktimë e sulmeve në të ardhmen, sa ato janë ose ndjehen të sigurtë në vendbanimet e tyre dhe më gjërë, dhe janë të dhëna edhe idetë e tyre se deri kur do të egzistojë terrorizmi i tillë dhe a ka mënyrë se si të ndalohet ajo.

GJINIA


Mashkullor	40 persona
Femrore	60 persona



Kjo është numri i personave të anketuar, sa i përket gjinisë. Nga rezultatet e paraqitura më lartë vërejm se kemi 60 persona janë meshkuj dhe 40 të tjerë të gjinisë femrore.

MOSHA


a) 18-25 vjet	68 persona
b) 25-30 vjet	13 persona
c) 30-40 vjet	13 persona
d) Mbi 40 vjet	6 persona



Nga grafiku i paraqitur më lartë tregohet mosha e personave të anketuar, që shihet se numri më i madhë është të personave prej 18 – 25 vjet. Janë persona të moshës më të re, por nuk mungon edhe ajo e modhës madhore e më lartë.

SHKOLLIMI


a) Fillor	/
b) Mesëm	15 persona
c) Student	43 persona
d) Fakultet	7 persona
e) Magistër	35 persona



Në bazë të tabelës të paraqitur më lartë, kemi të shënuar numrin e personave të anketuar të përcaktuar në bazë shkallës së shkollimit të tyre. Numri më madhë i të anketuarëve, në bazë të shkallës së arsimit janë student dhe magistër të fakulteteve të ndryshme.

1. Mendoni se terrorizmi ka egzistuar edhe para ngjarjes së “11 shtatorit”?


a) Po	95 persona
b) Jo	5 persona



Sic shihet më larte, nga pyetja e parë e parashtuar, numri më i madhë i personave (95 persona) janë të mendimit se terrorizmi ka egzistuar edhe para ngjarjes së “11 shtatorit” dhe se nuk është ajo shkak i paraqitjes së terrorizmit, e cila vazhdon të jetë prezente kudo në Europë dhe tek shtetet e SHBA-së. Ndërsa një numër i shumël i vogël i të anketuarëve (5 persona), janë të mendimit se terrorizmi nuk ka egzistuar ose nuk ka qenë prezent para “11 shtatorit”.

2. Mendoni se terrorizmi lindi pikërisht më datën “11 shtator 2001”?


a) Po	6 persona
b) Jo	94 persona



Nga personat e anketuar, vërejm edhe përgjigjet e tyre të dhëna, ku shumica e personave (94 persona), janë të mendimit se terrorizmi nuk lindi më datën “11 shtator 2001”, por ajo ka egzistuar edhe më parë, dhe një numër shumë i vogël i pesonave të anketuar (6 persona), janë të mendimit se terrorizmi lindi pikërisht më datën “11 shtator 2001” .

3. A është terrorizmi faktori që cdo herë e kërcënon rruzullin toksorë?


a) Po	32 persona
b) Jo	16 persona
c) Ndoshta	52 persona



Nga tabela e paraqitur më lartë, në pyetjen e parashtruar se: a është terrorizmi faktori që cdo herë e kërcënon rruzullin toksorë?, kemi edhe numrin e personave të cilët kanë dhënë mendimet e ndryshme të tyre. Numri më i madhë i të anketuarëve (52 persona), janë përgjigjur se “ndoshta” është terrorizmi faktori që cdo herë e kërcënon rruzullin toksor, një numër më i vogël i personave (32 persona) janë përgjigjur se “Po” dhe një numër i vogël i personave(16 persona) janë të mendimit ose janë përgjigjur “Jo”.

4. Ngjarja e “11 shtatorit” a është reflektim i kërcënimit global?


a) Po	22 persona
b) Jo	29 persona
c) Ndoshta	49 persona



Në bazë të tabelës të paraqitur më lartë, kemi numrin caktuar të personave të anketuar të cilët kanë dhënë idet dhe mendimet e tyre në lidhje me pyetjen e parashtruar. Sic e vërejm, shumica e personave janë të mendimit se “ndoshta” është terrorizmi faktori që cdo herë e kërcënon globin, dhe një numër më i vogël i të anketuarve kanë mendime të ndryshme si “po” ose “jo”.

5. A është e vërtetë se terrorizmi islamik është kërcënim global?


a) Po	11 persona
b) Jo	77 persona
c) Ndoshta	12 persona



Nga të dhënat e shënuara më lartë, kemi të qartë edhe numrin dhe përgjigjet e mara nga personat e anketuar. Në bazë të numrit të fituar nga personat e anketuar vërejm qartë se shumicia e personave apo 80% prej tyre janë të mendimi se terrorizmi islamik nuk ka të bëjë me kërcënimin global, dhe numër i vogël prej tyre ose vetëm 10% nga gjithë numri i të anketuarve janë të mendimit se “po” ose “ndoshta” mund të jetë.

6. Faktor për paraqitjen e terrorizmit është?


a) Cështje politike	57 persona
b) Interes	27 persona
c) Fetar	7 persona
d) Ekonomik	6 persona
e) Faktor të tjerë	3 persona



Në bazë të personave të anketuar kemi paraqitur tableat me të dhënat e caktuara. Sic vërejm, numri më i madhë i personave të anketuar kanë dhënë përgjigje ose janë të mendimit se faktorë për paraqitjen e terrorizmit është “cështje politike”, pra mendojnë se politika është ajo që sjellë deri tek ngjarjet e ndryshme terroriste, dhe një numër i vogël prej tyre kanë mendime të ndryshme se terrorizmi paraqitet si faktorë interesi, fetar, ekonomik ose faktorë të ndryshëm të tjerë.

7. A është e vërtetë se shtetet islamike janë ato që e kërcënojnë globin?


a) Po	6 persona
b) Jo	84 persona
c) Ndoshta	10 persona



Në tablën e paraqitur më lartë kemi të caktuar numrin e personave të anketuar në bazë të përgjigjeve të marra nga ato. Numri më i madhë i personave të anketuar janë të mendimit se nuk janë shtetet islamike ato që e kërcënojnë globin, pra nuk ka të bëjë me shtetet islamike, dhe një numër shumë i vogël janë përgjigjur ose janë të mendimit se “po” ose “ndoshta” ka të bëjë terrorizmi me shtetet islamike.

8. A mendoni se është prezente islamo-fobia tek shtetet evropiane dhe te SHBA-të?


a) Po	66 persona
b) Jo	34 persona



Në bazë të të dhënave të shënuara më lartë dhe mendimet e dhëna nga persona të moshave të ndryshme, numri më i madhë prej tyre janë të mendimit se egziston islamo-fobia tek shtetet Evropiane dhe tek SHBA-të, pra me një fjalë egziston friga se shtetet islamike janë ato që sjellin deri tek menyrat e ndryshme të paraqitjes së terrorizmit.

9. Cfar ideologji ka sot terrorizmi?


a) Politik	38 persona
b) Fetar	23 persona
c) Interes	39 persona



Në tabelën e shënuar më lartë kemi të caktuar numrin e përgjigjeve të mara nga personat e anketuar. Në këtë rast vërejm mendime të ndryshme të dhënë nga personat anketuar, ku një numër më i madh (39 persona) prej tyre mendojnë se ideologjia e terrorizmit është interes, pra gjithcka ndosh si rezultat i ndonjë interesi, një numër tjetër i konsiderueshëm (38 persona) janë të mendimit se ideologjia e terrorizmit ka të bëjë me politikën, dhe një numër i vogël janë përgjigjur se ideologjia ka të bëjë me çështje fetare.

10. A ka ndikim feja apo religjioni në organizimin e akteve terroriste?

a) Po	25 persona
b) Jo	75 persona



Sic shihet më lartë, nga personat e anketuar kemi marrë edhe përgjigjet e tyre ku një numër më i madhë prej tyre (75 persona) kanë dhënë përgjigje ose mendimet e tyre se feja apo religjioni nuk ka ndikim në paraqitjen ose organizimin e akteve të ndryshme terroriste. Ndërsa një numër i vogël kanë dhënë përgjigje se “po” ka ndikim feja apo religjioni ne aktet e organizuara terroriste.

11. A ka ndonjë mënyrë se si mund të ndalohet terrorizmi?

a) Sigurim i lartë	7 persona
b) Vetëdijësim i njerzimit	80 persona
c) Ska mënyrë	13 persona





Tabela e shënuar më lartë tregon qartë përgjigjet e dhëna nga personat e anketuar në lidhje me pyetjen e parashtruar. Në bazë të asaj se si janë përgjigjur ato vërejm se numri më i madhë prej tyre kanë mendim se njerzimi në përgjithësi duhet të vetëdijësohet që mos vij deri tek aktet e ndryshme të organizimit të sulmeve terroriste. Një numër më i vogël i personave të anketuar janë të mendimit se sigurimi i lartë mund të jetë pozitiv në ndalimin e akteve terrosite dhe një numër të tjetër mendojnë se ska mënyrë se si të ndalohet ajo.

12. Mendoni se terrorizmi do të egzistojë deri sa të egzistojë njerzimi?


a) Po	70 persona
b) Jo	9 persona
c) Cështje kalimtare	21 persona



Sic shihet më lartë, kemi të paraqitur tabelën me të dhënat ose përgjigjet e dhëna nga personat e përfshirë në anketë. Një numër më i madhë i personave të anketuar janë të mendimit se terrorizmi do të egzistojë cdo herë deri sa të egzistojë edhe vetë njerzimi, ndërsa një numër më i vogël prej tyre (21 persona) mendojnë se paraqitja e terrorizmit është cështje kalimtare dhe se nuk do të egzistojë cdo herë.

13. Sa të shqetsuar jeni ju personalisht për ju, shokët ose një të afërm që mund të jetë viktimë i një sulmi terrorist?


a) Shumë i shqetësuar	51 persona
b) Pak i shqetësuar	39 persona
c) aspak	10 persona



Në tabelën e paraqitur më lartë, kemi të shënuara përgjigjet e fituara nga personat e përfshirë në këtë anketë. Lidhur me pyetjen e parashtruar më lartë, kemi të mara edhe përgjigjet dhe mendimet e ndryshme nga ato. Një numër më i madh prej tyre (51 persona) janë të shqetsuar për të ardhmen e tyre që mos përfshihen nga sulmet e ndryshme terroriste, një numër tjetër (39 persona) ndjehen më pak të shqetsuar, dhe kemi një numër më të vogël (10 persona) ku nuk janë aspak të shqetsuar.

14. Sa të shqetsuar jeni ju të ketë sulm terrorist në rajon në të ardhmen ?

a) Jam i shqetsuar	65 persona
b) Nuk jam i shqetsuar	25 persona
c) Aspak	10 persona



Sic shihet më lartë kemi pytjen e radhës të parashtuar disa personave të përfshirë në këtë anketë. Në tabelën e paraqitur më lartë janë edhe përgjigjet dhe idetë e dhëna, ku një numër më i madhë i personave vërejm se janë të shqetsuar në lidhje me sulmet terroriste që mos të ndodhë edhe në rajon në të ardhmen. Ndërsa një numër më i vogël nga të anketuarit nuk ndjehen të shqetsuar.

15. Sa të shqetsuar jeni ju që mund të ketë sulm terrorist në të ardhmen në europë?

a) Shumë të shqetsuar	29 persona
b) Pak të shqetsuar	31 persona
c) Shpresoj nuk do të ndodhë	40 persona





Tabela në këtë rast tregon se kemi mendime të ndryshme në lidhje me pyetjen e parashtruar më lartë. Numri i përgjigjeve të dhëna nga personat e anketuar pothuajse se është i ngjajshëm, por një numër më i madhë (40 persona) prej tyre shpresojn se nuk do të ndodhë ose nuk do të ketë sulme të reja terroriste në europë, një numër tjetër (31 persona) janë pak të shqetsuar në lidhje me sulmet e ndryshme që ndodhin në europë, dhe një numër më i vogël (29 persona) janë më shumë të shqetsuar me ngjarjet terroriste.

16. Sa të shqetsuar jeni ju që mund të ketë sulm terrorist në botë në të ardhmen?

a) I shqetsuar	64 persona
b) Jo i shqetsuar	18 persona
c) Nuk do të ndodhë	18 persona



Në tablën e paraqitur më lartë, kemi të shënuara numrin e përgjigjeve të mara nga personat e anketuar. Vërejm se një numër më i madhë prej tyre janë të shqetsuar me sulmet e ndryshme që ndodhin kudo në botë, dhe një numër tjetër më i vogël janë më pak ose shpresojn se nuk do të ketë më sulme të tjera në botë.

PËRFUNDIMI

Terrorizmi është një fenomen negativ shoqëror që ka filluar të përhapet në gjithë botën. Data e 11 shtatorit të cdo viti është ditë përkujtimore në të gjitha qendrat pro-amerikane të botës. Kjo ditë na përkujton ndodhite e vitit 2001 kur në SHBA nje grup i vogël terroristesh arritën të godasin SHBA-të, në zemrën e fuqisë së tyre ekonomike, në kullat binjake të Manhatanit. Vendi ku njëherë qendronin kullat binjake, tashmë ka marrë përmasat e një tempulli mitik për popullin amerikan. Vendi “*ground zero*“, sulmi i vitit 2001 por edhe veprimet e mëparshme terroriste, i kanë shërbyer SHBA-ve dhe aleatëve të tij, si arsytim për të nisur luftën e tyre globale kundër terrorizmit.

Me gjithë aktet e shëmtuara që ndërmorën terroristët kundër SHBA-ve me 11 shtator 2001, dhe të drejtën që SHBA-të kanë për të mbrojtur vendin e tyre, çështja e luftës kundër terrorizmit, sipas disa analistëve perendimore, “në disa raste“ ka kaluar caqet e përgjigjes amerikane ndaj kërcënimeve mbi sigurinë e saj kombëtare. Edhe pse lufta amerikane kundër Afganistanit dhe Irakut, ku një ish-bashkëpunori I CIA-s amerikane Osama Bin Laden, kishte ndërtuar bazat e tija dhe kërcënonte hapur fuqinë amerikane, u justifikua dhe mori aprovimin e heshtur të komunitetit ndërkombtare, disa akte tjera të qeverisë amerikane në luftën globale kundër terrorizmit kanë marrë kritika të ashpra nga komuniteti ndërkombtarë .

Aktet terroriste kundër Shteteve të Bashkuara të Amerikës me 11 shtator 2001, ishin një tregues i qartë sesa e pasigurt është bota jonë në ditët e sotme. Sulmet tjera terroriste që kanë ndodhur në Bali dhe Xhakarta të Indonezisë, në Arabinë Saudite, Marok , Spanje, në Turqi, et., kanë treguar se bota në të cilën jetojmë sot është kryer në një vend të frikshëm dhe të paparashikueshëm. Terroristët sot godasin jo vetëm SHBA-të dhe të krishterët amerikanë por edhe vetë vendet Muslimane.

Para se të vritej, Bin Ladeni konsideronte veten “ *god father* “ i terrorizmit në përmasa globale, dhe bota e sotme do të dukej ashtu si e mendonte ai, pra një botë ku konfliktet zgjidhen me forcën e terrorit. Por civilizimi njerëzorë është më i fortë se cdo lloj terrorizmi, prandaj data e 11 shtatorit, përveç përkujtimit të saj, për humanitetin e botës përmban një simbolikë më të madhe. Në këtë ditë, njerëzit e paqes në botë kujtojnë jo vetëm të vvarët në kullat binjake në 11

shtator 2001, por edhe ata mijëra individë të pafajshëm që kanë humbur jetën në Lindjen e Mesme, Indonezi, Filipine, Rusi dhe Kaukaz, Spanjë dhe Amerikën Latine, si dhe përpjekjet që duhet të bëjë njeriu për të arritur paqen të qëndrueshme mes popujve, kulturave dhe religjioneve në tërë planetin tonë.

Në bazë të hulumtimit ose analizës të bërë me personat e anketuar erdhëm në përfundimit se terrorizmi ka egzistuar çdo herë, nuk është shkak ngjarja e “11 shtatorit” ajo që e reflekton terrorizmin edhe sot. Mirëpo nga ana tjetër terrorizmi është faktori që mendohet se e kërcënon rruzullin toksor kudo në botë.

Paraqitja e terrorizmit si faktorë në këtë rastë në bazë të hulumtimit, nuk ka të bëjë me fenë, kombin apo religjionin por ajo edhe më tej ngel si “çështje politike”, mirëpo në shumicën e rasteve të paraqitjes së terrorizmit tek shtetet evropiane islamo-fobia është prezente dhe mendohet se çdo herë lidhet terrorizmi me fenë, edhe pse ky mendim në bazë të hulumtimit dhe analizës nuk është i saktë. Në bazë të hulumtimit të bërë me personat e anketuar erdhëm në një përfundim se mënyra më e mirë që të ndalohet terrorizmi është që vet njerzimi të vetëdijësohet me ngjarjet e ndryshme terroriste që ndodhin, pra ta kuptojnë të vërteten dhe shkakun e paraqitjes së saj. Por edhe më tej terrorizmi ngel si “panik” numër 1 tek njerzimi dhe mendohet se terrorizmi do të egzistojë deri sa të egzistojë edhe vet njerzimi.

Përfundimi i arritur nga hulumtimi i bërë tregon qartë se njerzimi ndjehet i shqetsuar nga ngjarjet terroriste, nuk e ndjen veten e sigurtë dhe mendon se terrorizmi ka egzistuar dhe do të egzistojë deri sa të egzistojë edhe vetë njerzimi.

KONKLUZIONET

Në bazë të hulumtimeve të bëra dhe aritjes së përfundimit të temë, arrita në konkluzion se politikat e jashtëme poashtu edhe të mbrendshmet nuk kuptohen vetem me një pikpamje, sa më shumë të hulumtosha më shumë përfiton njohuri se çfarë po ndodh në marrëdhëniet ndërkombëtare mes shteteve me fuqi botërore.

Në bazë të asaj që kam shkruar unë në lidhje me atë se sa ndikon terrorizmi në marrëdhëniet ndërkombëtare, mund të them se tani më kur disa shtete duan të prishin marrëdhëniet ndërkombëtare tash më e kanë në menyrë tjetër, mjafton një sulm terrorist dhe ti hedhet fajti shtetit të caktuar dhe ai sulm jo vetëm se prish marrëdhëniet mes tyre si shtet por edhe ka ndikim në urejtje fetare. Kam përmendur shembullin e sulmit të 11 shtatorit ku u fajtua se ishte “ sulm terrorist islamik “ kurse nga ana tjetër disa media nga vet shteti amerikan reportuan se ishte montim nga ana e vet shtetit për çështje politike, por ajo çka ngeli është se nga ajo ditë ngeli si njollë në fenë islame se janë në gjendje të kryejnë ashtu sulme terroriste.

Tanimë dëgjohen shpesh sulmet nëpër xhamia të muslimanëve dhe sot njihen apo shqiptohen vetë si sulm i cmendur , apo sulm terrorist apo sulm urejtje por nuk i shtrohet prapashtesa fetare (sulm krishter, apo sulm jehudist etj.) sic u shkruante në sulmet tjera me prapashtesën “ islamike “

REKOMANDIMET

Për rekomandime unë mund vetëm të them se, politika ndërmjet shteteve të mëdha dhe me fuqi botërore është shumë e ndërlikuar sa që të bën të besosh në një tregim të thurur nga vetë ato. Mund të them se, për të prishur marrëdhëniet mbrenda disa shteteve në fuqi gjithmonë montohen raste terroriste mbrenda shtetit apo edhe jashtë saj vetëm e vetëm me qëllim që të prishën marrëdhëniet ndërkombëtare mes shteteve në fuqi apo edhe për çështje interesi.

Sic e dimë edhe më herët gjitha luftrat ndërkombëtare që janë kryer , ka qenë në pamje të parë interesi politik , territorial apo material. E njejtja gje tani përsëritet por në një gjuhë pak më moderne “ sulme terroriste “ , të montuara nga vet shteti ose joo, ajo mjafton që të prishë marrëdhëniet ndërkombëtare mes shteteve të caktuara.

Më e rëndësishmja ajo që rekomandoj për shoqirënë tonë të rethit ku jetojmë, asnjër nuk duhet të jemi pre e provokimeve që bëhen në vendin tonë dhe t’ju besojmë se gjitha sulmet kanë të bëjnë me fenë, dhe asnjëher të mos e lejojmë që politika të përzihet edhe me religjionin, sepse në cilindo religjion thuhet se: “ Terrorizmi nuk ka fe “

BIBLIOGRAFIA

- Bounding the Global War on Terrorism, Jeffery Record, December 2003.
- Office of information and pres Nato, Doracak, Bruksel, 2001 dhe 2006.
- Donald Rumsfeld, “ A New Kind of War “, New York Times, September 27, 2001 .
- Global Terrorism : An Overview and Analysis : Monty G. Marshall, Draft 09/11/02/ .
- Nazmi Maliqi, Sistemi i Sigurisë, Shkup 2010.
- Sulejmanov Z , Kriminalna Politika, Shkup 2001.
- Haki Demolli, Terrorizmi, Prishtinë , 2002.
- Haki Demolli, “ Terrorizmi “, Prishtine, fq. 213, marre nga artikulli “US shocked by attacks “, BBC, London , September 2001 .
- Vesel Latifi “ Kriminalistika “ Prishtinë 2011
- Cituar sipas L. J. Macfarlane, Political Disobedience, London 1971
- Politische Kriminalitat, Meyers Enzyklopadisches Lexikon, Band 14, Wien 1987
- Brogan Patric, Die Unruhe der Welt, Darmstadt 1990
- Raufer.X, Kumbarët e botës, Tiranë, 2005
- Raufer X, Quere, La Crime Organise, Paris, Janar 2000
- Vodinelic, Kriminalistika, Beograd 1996
- Klaus – Dieter Borchard, Edrejta e komunitetit Europian, Doracak, Bruksel 1999
- Hezbollah: The Changing Face of Terrorism Paperback – October 7, 2005
- Inside Terrorism, Bruce Hoffman , Columbia University , 1998.
- Qendra Izraelite për Studime Antiterroriste, <http://www.ict.org.il>
- Willikson Paul: Political Terrorism, Macmillan Press, London 1974
- www.algeria-interface.com/english/politics/index.html
- www.interpol.int
- www.news.bbc.uk
- Islam and Terrorism (Revised and Updated Edition) – M Gabriel.
- Kolë Krasniqi, Terrorizmi Ndërkombëtar, Prishtinë 2010 .
- Kolë Krasniqi , Terrorizmi Ndërkombëtar (Botimi i Dytë) Prishtinë 2010.

- Lauren B. O’Brein “ The Evolution of Terrorism Since 9/11 “ , The FBI’s Analysis Section .
- Lauren B. O’Brein “ The Evolution of Terrorism Since 9/11 “ , The FBI’s Counterterrorism
- Martin A. Miller – The Foundations of Modern Terrorism (2013).
- NATO-s Secret Armies – Operation Gladio and Terrorism in West.
- Raport i Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB), dt.15.12.1997
- Terror and Terrorism : There Is a Difference : Forte , David , Ohio N.U.L., Rev. 39 (1986).
- Terrorism and Exclusion from Refugee Status in the UK (2015).
- The History of Terrorism- Edited by Gerard Chaliand and Arnaud Blin , University of California Press in Berkeley , Los Angeles , London .
- The History of Terrorism from Antiquity to Al-Qaeda, Part III by Philippe Migaux.
- The Oxford History of Islam, John L. Esposito (2004).
- The History of Terrorism from Antiquity to Al-Qaeda, Gerard Chaliand and Arnaud Blin,
- US Department of State ; Patterns of Global Terrorism 1997 www.state.gov, fq 86.